

RAPORTI VJETOR
2016

01 | MESAZH NGA
DREJTORI I
PËRGJITHSHËM
DHE KRYETARI
I KËSHILLIT
DREJTUES

02 | NJË VËSHTRIM
MBI ECURINË E
CREDINS BANK
NË 2016

PËRMBAJTJA

03 PËRGJEGJËSIA
SOCIALE

04 RRJETI I
DEGËVE DHE
AGJENCIVE

05 PASQYRAT
FINANCIARE
DHE RAPORTI I
AUDITUESVE TË
PAVARUR



MALTIN KORKUTI
Drejtör i Përgjithshëm

MESAZH NGA DREJTORI I PËRGJITHSHËM DHE KËSHILLI DREJTUES

Të nderuar Klientë dhe Aksionerë të Credins bank,

Credins bank e mbylli vitin 2016 duke shënuar një moment të rëndësishëm historik në rrugëtimin e saj në këto katërmëdhjetë vite ekzistencë duke u renditur si banka e tretë më e madhe në vend. Kjo arritje na bën jo vetëm krenarë por dhe më të përgjegjshëm për sfidat që na vihen përpara. Rritja jonë në depozita dhe asete dëshmon për besimin e madh që klientët tanë, individë dhe biznesë kanë tek Banka. Ndërkohë që portofoli ynë i shëndetshëm i kredive, i diversifikuar në të gjithë segmentet dhe sektorët e ekonomisë është prova më e mirë e aftësisë sonë për të mirëmenaxhuar financat dhe për të investuar në mënyrë të suksesshme. Mjedisi ekonomik dhe financiar, si ai Shqiptar apo ndërkombëtar, vazhduan dhe në 2016 të jenë problematikë. Por, përtej vështirësive makroekonomike, plani strategjik i bankës u përmbush me sukses duke respektuar kërkesat rregullatore për kapitalin.

Në fushën e kredive, banka i qëndroi besnikë angazhimit të saj për reduktimin gradual të ekspozimit në kreditë korporatë dhe rritjes graduale dhe të qëndrueshme në fushën e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, në sektorin agro, mikro dhe individë. Kjo strategji rezultoi e suksesshme dhe gjeneroi disbursimin e 25,500 kredive gjatë vitit 2016, nga ku 87% kanë rezultuar në segmentin individë. Gjatë 2016 vazhdoi zgjerimi me dy degë të reja, dhe nisi një proces në shkallë të gjërë për rivitalizimin e degëve. Po në 2016, selia qëndrore e bankës u vendos në godinën e re prestigjioze në rrugën Vaso Pasha, nr. 8 sëbashku me një degë pa shërbime cash, që do të shërbejë si model për shtimin e shërbimeve me teknologji të avancuar në dobi të klientëve. Mund të themi me bindje se gama e produkteve dhe shërbimeve që ofrohen sot në Credins bank, plotëson çdo nevojë të individit apo biznesit, duke përfshirë jo vetëm produktet bankare, por duke mundësuar dhe aksesin në fonde pensioni, investimi, produkte sigurimesh, leasing etj. Viti 2016 u mbyll me hedhjen në treg të Mastercard, pjesë e përpjekjeve të bankës për të rritur shërbimet digjitale. Kjo kartë me teknologjinë e avancuar Contactless plotëson nevojën e klientëve tanë individë dhe biznes, për një kartë në monedhë të huaj. Me kartën VISA, në 2016 Credins bank mbulon 13,8 % të tregut në sistemin bankar shqiptar me 103,180 përdorues. Në fushën e përgjegjësisë sociale, kontributi i bankës në 2016 ka qënë në rradhë të parë në aspektin e shërbimeve financiare ku në bashkëpunim me institucionet shqiptare si Posta Shqiptare apo Instituti i Sigurimeve Shoqërore është punuar intensivisht për të finalizuar dhe implementuar marrëveshje që shtojnë hapësirat e pagesave elektronike për qytetarët, duke reduktuar sasinë e parasë cash dhe lehtësimin e procedurave. Banka në një shkallë po aq të rëndësishme ka kontribuar në mbështetje të komunitetit dhe në këtë fushë janë realizuar rreth 57 projekte për përmirësime në infrastrukturë, financim pajisjesh, gjelbërim, lehtësim aksesit në arsim, kulturë, shëndetësi, etj dhurime për reduktimin e varfërisë me qëllimin që të sigurohet një impakt pozitiv në mjedis dhe jetën e komunitetit.

Rezultatet e arritura, janë siguruar falë punës së një stafi të motivuar për t'i shërbyer sa më mirë klientëve tanë. Në rolin e një punëdhënësi të përgjegjshëm, ne besojmë se stafi është një kapital i çmuar prandaj dhe gjatë 2016, banka ka pasur një paketë kompesimi konkurruese dhe ka siguruar rritjen e vazhdueshme profesionale të stafit përmes formateve ambicioze të trajnimit. Kjo strategji i shërben plotësimit të kërkesave në rritje të klientëve për profesionalizëm, ekspertizë, asistencë financiare dhe konsulencë bankare.

Këshilli Drejtues ka qënë mbështetës dhe i angazhuar për të siguruar që rritja jonë të jetë organike, e mbështetur në zgjidhje strategjike afatgjatë, duke respektuar kontekstin rregullator, etikën e biznesit dhe parametrat e riskut.

Suksesi ynë e ka bazën tek besimi, integriteti, ndershmëria dhe përkujdesja. Këto parime do vazhdojnë të na udhëheqin dhe në të ardhmen. Falë besimit tuaj, jemi një ekip fitimtar.

Sinqerisht,

Maltin Korkuti,
Drejtore i Përgjithshëm

Saimir Sallaku
Kryetari i Këshillit Drejtues i Credins Bank



JONAS HASSELROT
Anëtar

MALTIN KORKUTI
Anëtar

MONIKA MILO
Anëtare

SAJMIR SALLAKU
Kryetar

KËSHILLI DREJTUES



CLIVE MOODY
Anëtar

RAIMONDA DUKA
Anëtare

ELTON TORO
Anëtar

NJË VËSHTRIM MBI ECURINË E CREDINS BANK NË 2016

KORPORATAT DHE BIZNESI I MESËM

Gjatë vitit 2016, Departamenti i Korporatave dhe Biznesit të Mesëm vijoi të punojë me fokus në manaxhimin e portofolit aktual të kredisë, në përputhje me strategjinë e bankës për të ulur më tej peshën specifike të kreditimit të biznesit të madh, duke diversifikuar marrëdhënien me klientët korporata në produktet jo kredi.

Pesha e portofolit të Departamentit është ulur në 73,2% nga 74% që ishte në 2015. Segmenti i korporatave, i cili është ulur në 56,8 % nga 63,4 % që ishte në 2015, dhe portofoli i tij rezulton në vlerën 62,2 miliardë Lekë në fund të vitit 2016. Ndërkohë që puna e bërë për diversifikim e marrëdhënies dhe shtrirjen e saj në produktet jo kredi ka shënuar gjatë vitit 2016 një rritje të volumit mesatar me rreth 20%. Kjo strategji për korporatat do të vazhdojë edhe përgjatë vitit 2017, me një përqaasje të kujdesshme duke ruajtur cilësinë e portofolit.

Puna intensive e këtij Departamenti ka çuar në rritjen e numrit të pagatorëve të cilët për segmentet korporatë dhe Biznesi i Mesëm u rritën me 2,456 punonjës ose 78% më shumë se viti 2015. Rritje u shënuar edhe në portofolin e garancive me 22% në krahasim me vitin 2016, 3.7 miliardë Lekë/ 3.1 miliardë që ishte më parë, dhe përbëjnë 80% të peshës së garancive totale të bankës.

Puna e Departamentit të Korporatave ka synuar përtej rritjes së cilësisë së shërbimit, ofrimin e paketave të produkteve e shërbimeve konkurruese në raport me tregun. Financimi i sektorëve të hidro-energjisë, infrastrukturës rrugore dhe telekomunikacioneve është i vlerësuar si më prioritar brenda kontekstit të ruajtjes së një peshe në rënie të portofolit të kredive korporative.

Në mbështetje të rritjes së efektivitetit të punës së këtij

Departamenti, gjatë vitit 2016 banka ka përfshirë këtë njësi në programin e trajnimit nga ekspertë të huaj me objekt “Efektivitetin e Forcës Shitëse” SFE (Sales Force Effectiveness) dhe synohet që të aplikohet gjatë vitit 2017. Programi do të jetë një mjet i rëndësishëm për të konsoliduar dhe standartizuar më tej punën e stafit të këtij Departamenti.

Ne tashmë jemi garantues seriozë i investimeve të klientëve tanë.

SELIA QENDRORE E CREDINS BANK

NË RRUGËN VASO PASHA, NR.8, TIRANË

STRUKTURE DINAMIKE DHE VOLUM

Një godinë e plazmuar tërësisht nga francezët brenda parametreve të arkitekturës bashkëkohore, sipas një tipologjie internacionale. Lartësia e moderuar në raport me mjedisin urban dhe linjat e pastra, por mjaft dinamike e bëjnë atë një nga objektet më të arrira në Tiranë. Objekti në plan është gjeneruar nga logoja e vetë bankës, si ndërthurje e dy trekëndëshave. Godina është konceptuar mjaft mirë nga ana volumetrike duke kombinuar një sinergji bashkëpunuese mjaft positive.

RESORTI DIAMMA

Turizmi ende vazhdon të mbetet një prej sektorëve më të rëndësishëm dhe strategjik në vendin tonë prej disa vitesh. E krijuar në Korrik 2016, e shtrirë në vijën bregdetare të detit Adriatik në afërsi të Golemit, DIAMMA Resort është një nga investimet më të mëdha të kësaj zonë në favor të sektorit të turizmit. Ky kompleks i bukur me 25 vila, i finalizuar falë investimit të Credins bank po bëhet një nga destinacionet kryesore të turistëve nga Sllovakia, Çekia, Polonia dhe Norvegjia. Resorti ofron përveç akomodimit dhe mjedise të këndshme me restorante, bare, pishinë, kënd lojrash për fëmijë si dhe infrastrukturë mbështetëse për konferenca.

Administratorët e resortit e kanë konceptuar këtë resort si një strukturë që funksionon gjatë gjithë vitit, duke ofruar mundësi për organizim trajnimesh për korporata jashtë sezonit dhe një kompleks plotësisht funksional për argëtim dhe pushim gjatë sezonit të verës.

Nuk ka qenë e lehtë të hedhësh gjithçka në letër për të përgatitur një plan realist biznesi, të qëndrueshëm dhe afatgjatë shprehet z. Luadhi, administratori i resortit. Bashkëshortët Luadhi, kanë punuar dhe janë konsultuar gjatë, për të trokitur më pas në dyert e Credins bank. Ekspertiza, vëmendja, analizat e përfaqësuesve të bankës, kanë qenë padyshim një ndihmë e madhe për të ndërtuar një projekt realist i cili më pas u miratua dhe siguroi financimin e nevojshme për ta shndërruar projektin ambicioz në letër në një realitet të bukur, duke e transformuar DIAMMA në një nga resortet më të rëndësishëm të zonës Durrës-Golem.

Vendndodhja e resortit mundëson një qetësi absolute dhe aktivitete të shumëllojshme për të gjitha grupmoshat. Z. Luadhi shprehet se investimi në këtë sektor do të ketë një sukses absolut pasi turizmi në Shqipëri po kthehet në një nga destinacionet kryesore të pushuesve nga jashtë vendit. Në këtë projekt Credins Bank ishte mbështetja jonë e pare dhe e vetme e cila na u gjend pranë duke na financuar.





‘
 KY KOMPLEKS I
 BUKUR ME 25 VILA,
 I FINALIZUAR FALË
 INVESTIMIT TË
 CREDINS BANK PO
 BËHET NJË NGA
 DESTINACIONET
 KRYESORE TË
 TURISTËVE
 ’

DEPARTAMENTI I SHITJES DHE SUPORTIT TË KREDISË S.I.M.A

Stafi i shitjes së kredisë, i koordinuar nga Departamenti i shitjes dhe suportit të kredisë S.I.M.A. synon zhvillimin e biznesit të bankës, nëpërmjet rritjes së qëndrueshme dhe cilësore të portofolit të kredisë për biznesin e vogël, kredisë për individë, kredisë mikro dhe kredisë agro si dhe mbështetjen për rritje dhe qëndrueshmëri në këto segmente. Përgjegjshmëria dhe profesionalizmi i treguar në marrëdhënie me klientët ka rezultuar me tregues mjaft pozitivë për vitin 2016. Rritja e portofolit të kredisë është realizuar në masën 159% të objektivave, duke kontribuar në masën 45% të totalit të rritjes së portofolit të bankës.


Rritja e biznesit të bankës në segmentin SIMA ka ardhur si pasojë e një sërë masash strategjike dhe njëkohësisht përkushtimit të një stafi profesional dhe cilësisë së portofolit të orientuar drejt rezultatit. Komunikimi me transparencë të plotë me klientët ka bërë që ata të jenë më vigjilentë për kushtet e punës së produkteve që përfitojnë. Zhvillimi i marrëdhënieve me klientët është përkthyer në rritje të volumit të disbursimeve të kredisë me 36.8% si dhe rritje të peshës së segmentit SIMA në portofolin e bankës në 26.3%. Rritjen më të lartë të volumit të disbursimeve e ka paraqitur segmenti SE dhe segmenti Individë. Rezultatet e rritjes së kredisë janë arritur në sajë të një

planifikimi të kujdesshëm të rritjes së portofolit të kredisë, disbursimeve dhe produkteve në fokus për segmentet e veçanta.

Mbi 25,500 kredi janë disbursuar gjatë vitit 2016, nga ku 87% kanë rezultuar në segmentin individë. Numri i kredive S.I.M.A. në bankë është rritur me 5.4%.

Konsolidimi i mëtejshëm i strukturës të shitjes së kredisë (krijuar në vitin 2015), dinamizmi dhe profesionalizmi i stafit është shoqëruar me zhvillimin e produkteve të kredisë, përshtatjen e politikave dhe procedurave të kredidhënies, duke i bërë edhe më atraktive për target grupet e synuara. Gjithashtu, forcës shitëse i është bashkuar edhe staf me eksperiencë dhe energji të reja për zhvillimin e biznesit të bankës në sektorë të veçantë. Bashkëpunimi i ngushtë me strukturat e tjera të kredisë ka ndikuar pozitivisht në arritjen e objektivave të vendosura dhe tërheqjen e klientëve të rinj. Struktura e shitjes dhe suportit të kredisë

S.I.M.A. ka vijuar mbështetjen e ngritjes së kapaciteteve të analistëve në degë, orientimin dhe bashkëpunimin në trajtimin e rasteve, zhvillimin e marrëdhënieve me partnerë për të nxitur kreditimin, me qëllim final rritjen e biznesit të bankës duke mbështetur segmente strategjike të ekonomisë dhe ofrimit të shërbimit cilësor.





SËBASHKU ZHVILLOJMË AGROBIZNESIN

Ne kemi ëndrra të ndryshme por kemi një të përbashkët

Credins bank, një bankë që kupton veçantinë tonë dhe është gjithmonë e gatshme të na japë këshilla dhe zgjidhje të personalizuar. Pavarësisht veçantive tona, ne kemi një bankë që flet gjuhën tonë.


LEASING

Në fund të vitit 2015 u finalizua Projekti, “Bashkimi me Përthithje Bank – Credins Leasing”. Me realizimin e këtij projekti Credins bank iu shtua një Departament i ri “Departamenti i Shitjes dhe Suportit të Qirasë Financiare”, stafi i së cilës vinte i kualifikuar për shitjen e këtij produkti. Objektivi i këtij Departamenti ishte së pari përfshirja në strukturën e bankës duke përshtatur rregulloret e procedurat si dhe krijimi i kushteve për shtrirjen e produktit leasing edhe në rrjetin e degëve të Credins Bank.

Gjatë vitit 2016, përtej kontekstit rregullator, u realizua trajnimi për produktet leasing me analistët SME të 14 degëve të cilët u vlerësuan si stafi që ka njohuritë profesionale të domosdoshme për ta prezantuar dhe shitur këtë produkt.

Portofoli Leasing në Dhjetor të vitit 2016 u rrit me 18% krahasuar me vitin 2015, duke patur një total disbursimesh në vlerën 5,150,000 Euro, ku vlera mesatare e protofolit është 15,000 Euro për kontratë. Në vitin 2016, Credins Bank ruan vendin e dytë në tregun leasing dhe përfaqëson 14% të këtij tregu.

Portofoli Leasing rezultoi me cilësi shumë të lartë me vetëm 4.59% të vonesave me mbi 90 ditë.



E RE, E BUKUR, E PËRSOSUR!
LEHTËSISHT E JUAJA!



LEASING

**Jepi fund dyshimit
“e re apo e përdorur”!**

Gjithçka është gati për ta bërë më të lehtë
dhe më komode zgjedhjen tuaj!



FOKUSI KRYESOR RRITJA E CILËSISË DUKE PËRMIRËSUAR MODELET E ANALIZAVE TË RISKUT



RISKU

Divizioni i Administrimit të Riskut, gjatë vitit 2016, ka vazhduar të ketë fokus kryesor rritjen e cilësisë. Kjo e fundit është përqëndruar në të gjithë aspektet, duke filluar nga rritja e treguesve cilësorë të portofolit të kredisë e duke vazhduar me përmirësimin e analizës që i bëhet klientit, me përmirësimin e modeleve bazë që përdoren për analizat e riskut, me përmirësimin dhe përshtatjen me ndryshimet e tregut të akteve që rregullojnë marrëdhënien me klientin dhe e fundit por jo më pak e rëndësishme, përmirësimi në ndjekjen e klientit problematik. Baza e këtij objektivi nuk ka qenë vetëm automatizimi i shumë proceseve në mënyrë që të shmangej një pjesë e konsiderueshme e gabimeve njerëzore por edhe rritja e përgjegjësisë dhe metodave të monitorimit. Orientimi drejt efijencës në komunikim dhe në raportim ishte fokus i vitit 2016.



“PAGA IME” – MË SHUMË ËSHTË ME SHUMË !

Ne kemi nevoja të ndryshme, por kemi një të përbashkët

Credins bank, një bankë që kupton veçantinë tonë dhe është gjithmonë e gatshme të na japë këshilla dhe zgjidhje të personalizuara. Pavarësisht veçantive tona, ne kemi një bankë që flet gjuhën tonë.

RRJETI I DEGËVE

Aktiviteti i Rrjetit të Degëve në Credins Bank gjatë vitit 2016 pati rritje dhe zhvillim sasior dhe cilësor: në numër degësh, asete, të ardhura dhe burime njerëzore. Kjo rritje u pasqyrua dhe në pozicionimin e bankës si banka e tretë më e fuqishme në vend.

Gjatë 2016 Rrjeti i Degëve u zgjerua me dy njësi të reja: Dega Tiranë Qendër dhe Dega Vau i Dejës, duke rritur kështu impaktin dhe shtrirjen në vend në synim të përmbushjes së nevojave dhe kërkesave të klientëve tanë aty ku ato ndodhen. Gjatë vitit 2016 filloi gjithashtu projekti për rivitalizimin e degëve ekzistuese duke aplikuar një standard të ri. Dega Vlorë dhe Dega Tirana 1 ishin dy degët e para në këtë proces rivitalizimi e standardizimi dhe do të vijnë investime të tjera në zhvillim të kanalit më të madh të shitjeve Credins: Rrjetit të Degëve.

Portofoli i depozitave në fund të 2016 kapi vlerën e 106,874 Miliardë Lekë, me një rritje neto të profolit gjatë vitit 2016 në vlerën 9.16 miliardë Lekë, ose 9.4% në vit.

Rritja e shitjeve të produkteve jo kredi vazhdoi të ishte fokus në punën e përditshme të degëve të rrjetit Credins. Kështu gjatë 2016 produktet e kartave kapën shifrën 103,180 karta të diversifikuara në karta debiti, krediti dhe të parapaguara, që përfaqësojnë 13,8% të tregut të kartave në vend. Gjatë 2016 kemi mbi 15,500 përdorues të rinj të platformës e-Banking dhe pikave të shitjes së Credins Bank, me një portofol me rreth 500 terminale në tregun shqiptar, ose 7% të këtij tregu.

Rrjeti i Degëve po punon aktivisht në përmirësimin e cilësisë së të dhënave të klientëve, duke mundësuar kështu krijimin e një baze të saktë të dhënash që shërben si bazë për të ndërtuar strategjinë e shitjeve dhe për të përmbushur raportime sa më të sakta, për t'iu përgjigjur kërkesave në rritje të strukturave të kontrollit apo autoriteteve rregullatore.



Viti 2016



Viti 2016



ZGJIDHJE PËR BIZNESIN E VOGËL

Ne kemi shije të ndryshme, por kemi një të përbashkët

Credins bank, një bankë që kupton veçantinë tonë dhe është gjithmonë e gatshme të na japë këshilla dhe zgjidhje të personalizuar. Pavarësisht veçantive tona, ne kemi një bankë që flet gjuhën tonë.

OPERACIONET

Departamenti Operacional, si strukturë qëndrore në mbështetje të procesimit korrekt dhe në kohë të të gjithë veprimeve në rrjetin e Bankës, vazhdoi dhe në 2016 të përmbushë me profesionalizëm dhe efektivitet rolin e saj, duke kontribuar në rritjen e vazhdueshme të volumeve të transaksioneve të pagesave dhe instrumentave të Trade Finance.

Credins Bank, përgjatë vitit 2016 ka procesuar në kohë reale nëpërmjet sistemeve: AIPS dhe AECH, një fluks të konsiderueshëm të pagesave në nisje, të barazvlefshme në volum me 96.33 miliardë Lekë, krahasuar me 83.6 miliardë Lekë, të lëvruara gjatë 2015, pra me një rritje prej 15% në vlerë, dhe 52% në numër transaksionesh. Pagesat në mbërritje kapin vlerën prej 158.4 miliardë Lekë, krahasuar me 138.9 miliardë Lekë, të lëvruara gjatë 2015, pra me një rritje prej 14%, dhe 12% në numër transaksionesh. Po ashtu transfertat në monedhë të huaj, shënuan një rritje të konsiderueshme, duke reflektuar vlerat si më poshtë. Kështu pagesat në nisje monedhë të huaj, në kundër-vlerën prej 79 miliardë Lekë, krahasuar me 69.7 miliardë Lekë, të lëvruara gjatë 2015 shënuan një tregues me një rritje prej 13% në vlerë, dhe 19% në numër transaksionesh; ndërkohë që pagesat në mbërritje në valutë, në ekuivalentin e tyre në monedhën lokale ishin 59.48 miliardë Lekë, krahasuar me 50.22 miliardë Lekë, të lëvruara gjatë 2015, pra me një rritje prej 18% në vlerë, dhe 21% në numër transaksionesh. Si rrjedhojë e këtyre volumeve, komisionet nga shërbimi i pagesave dhe transfertave shënuan një rritje prej rreth 16%.



PAGESAT
ELEKTRONIKE
PËRGJATË VITIT
2016 SHËNUAN NJË
RRITJE PREJ 13% NË
NUMËR, DHE 10%
NË VLERË.




Në fushën e instrumentave të Trade Finance, letër-kreditë e importit, garancitë me jashtë dhe incaso-t patën një rritje të ndjeshme në vlerë prej 83% në volum krahasuar me fundin e vitit 2015 dhe 12% në numër krahasuar me vitin 2015 .

Një ecuri e kënaqshme u vu re gjatë 2016 dhe në fushën e pagesave elektronike të cilat përgjatë 2016 shënuan një rritje prej 13% në numër, 10% në vlerë. Kontributi i tyre në të ardhurat nga komisionet u rrit me 15% krahasuar me vitin 2015.

Në vazhdim të përpjekjeve për të rritur transaksionet mbi bazë komisioni, tregues të kënaqshëm janë shënuar në fushën e pagesave utilitare me një rritje prej 13% në vlerë, dhe 10% në numër, krahasuar me vitin 2015, pagesat e tatimeve dhe doganave përgjatë vitit 2016 patën një rritje prej 19% në vlerë, dhe 14% në numër, krahasuar me vitin 2015.

Credins bank është një nga bankat kryesore në vend për shërbimin e procesimit të pagave për kompanitë dhe institucionet shtetërore. Përgjatë 2016 ky shërbim vijoi të shënojë një rritje prej 10% krahasuar me vitin 2015.



CREDINS ONLINE

Banka në dorën tuaj!

Me Credins Online ju mund të kryeni të gjitha shërbimet bankare që ju nevojiten. Aksesoni llogarinë 24/7 nga celulari, laptopi, kompjuteri juaj.

THESARI

Menaxhimi efektiv i likuiditetit, fleksibiliteti, kosto e ulët, shpejtësia në veprime, tregtimi 24 orë i monedhave dhe transparencja janë ndër vetitë dominuese të Departamentit të Thesarit, të cilat edhe për vitin 2016 çuan në rritjen e fitimeve jo vetëm për Credins Bank por edhe për klientët.

Ndekja e ecurisë së tregjeve financiare nga një staf i kualifikuar dhe ofrimi i mundësive më të mira klientëve në lidhje me investimet, kanë qenë dhe mbeten, një sfidë e vazhdueshme për Departamentin e Thesarit.

Të ardhurat nga investimet në Tregun e Parasë u rritën me 10% në krahasim me vitin e kaluar. Gjatë vitit 2016, portofoli i letrave me vlerë u rrit me 11,26% në krahasim me vitin e kaluar.


Një ndër objektivat e Departamentit të Thesarit është ofrimi i investimeve alternative në tregjet financiare për klientët e bankës, sidomos gjatë kësaj periudhe që përfitimet nga interesat e depozitave kanë qëndruar në nivele të ulta.

Viti 2016, ishte gjithashtu një vit i suksesshëm në emetimin e obligacioneve të Credins bank, i cili u reflektua në rritjen e numrit të pjesëmarrësve në obligacionet 7-vjeçare të emetuara nëpërmjet ofertës private. Klientët e shikojnë këtë produkt të Credins bank si një alternativë shumë të mirë investimi.

Volumi i transaksioneve valutore gjatë vitit 2016 u dyfishua në krahasim me vitin 2015. Volumet e këmbimeve valutore sidomos në monedhat dytësore AUD, CAD, JPY janë rritur ndjeshëm përgjatë vitit 2016, duke i kthyer këto monedha ndër më të preferuarat për investorët Shqiptarë dhe duke u familjarizuar me monedha që deri më sot nuk përdorehin në Shqipëri. Në këtë kuadër, një ndër objektivat e Departamentit të Thesarit është mundësia e kryerjes së këmbimeve apo pagesave në monedhën kineze, për ato kompani/ individ që kryejnë transaksione me Kinën. Gjatë vitit 2016 u mundësua hapja e llogarive në monedhën kineze për klientët korporata.

INVESTIME ALTERNATIVE NË TREGJET FINANCIARE PËR KLIENTËT E BANKËS

DYFISHUAR





BANKA AKOMA ME PRANË!

Credins Bank dhe Posta Shqiptare më pranë jush me shërbime të reja.

Tani ju mund të shfrytëzoni 100 filialet e Postës Shqiptare në të gjithë Shqipërinë për të depozituar para në llogarinë tuaj si dhe të paguani kështu koston e kredisë.

KARTAT

Viti 2016, ishte viti i sfidave të reja për Departamentin e Kartave. Në 2016 u finalizua me sukses projekti për lëshimin dhe pranimin e kartave Mastercard. Të ndërgjegjshëm për komoditetin, sigurinë, shpejtësinë dhe efikasitetin që ofrojnë pagesat elektronike përkundrejt formave të tjera të pagesave, Credins bank vazhdon të synojë implementimin e teknologjive të reja në këtë fushë. Në këtë kuadër ishte dhe hedhja në treg e Mastercard Contacless, në të gjitha formatet: kartë debiti, krediti dhe e parapaguar.

Për të mbështetur biznesin dhe për t'ju përgjigjur kërkesave gjithmonë në rritje të klientëve, në 2016 Credins bank ka qenë prezente në tregun bankar me një portofol të plotë biznesit të kartave, duke ofruar karta Visa dhe Mastercard debiti dhe krediti për individë dhe biznese, në monedhën vendase dhe të huaj. Credins bank është më pranë, dhe jo vetëm për klientët, por edhe për ata që nuk janë klientë të bankës, për veprime në cash, për blerje në POS si dhe blerje të sigurta online.

Sipas raportit të Visa International, Credins bank ka performuar mbi mesataren e tregut dhe krahasuar me 2015, duket qartë tendenca në rritje e të gjithë treguesve që lidhen me aktivitetin e kartave, jo vetëm si lëshues, por edhe si pranues të transaksioneve me kartë. Ajo që bie në sy është përmirësimi i dukshëm i treguesve cilësorë të përdorimit të kartave dhe terminaleve Credins bank, kjo krahasuar me një vit më parë, por edhe në raport me tregun bankar. Sipas raportit të Visa-s, Credins bank zë rreth 13% të

volumit të pagesave me karta në treg për individët, dhe rreth 45% të pagesave me kartat e biznesit.

Vazhdojnë të jenë të lartë të gjithë treguesit e lëshimit dhe përdorimit të kartave Visa të Parapaguara. Këto karta vazhdojnë të kërkojnë dhe të përdoren gjerësisht nga klientët. Kartat e parapaguara rezultuan në një risi të suksesshme, duke tejkaluar të gjitha pritshmëritë.

Edhe treguesit si Acquiring (transaksionet në терминалет tona), kanë shënuar rritje, veçanërisht në pikëpamje cilësore (volum transaksionesh), nga 22% që është rritja e tregut, në 62% që është rritja për Credins bank (gjithmonë sipas statistikave të Visa-s për performancën e bankave në tregun bankar shqiptar).

Treguesit cilësorë që lidhen me efikasitetin e përdorimit të kartës janë më të larta krahasuar me tregun. Gjithashtu edhe treguesi i kartave aktive në raport me kartat në total është përmirësuar krahasuar me vitin 2015. Me finalizimin e projektit të Mastercard, është mundësuar lëshimi i kartave contacless, dhe vazhdon implementimi dhe instalimi i terminaleve POS contacless, që përbëjnë risi në tregun bankar Shqiptar. Mastercard do të ofrohet në një gamë të gjerë, duke përfshirë produkte që kanë në fokus çdo segment të klientelës; karta debiti dhe krediti për individë dhe biznese, karta krediti Mastercard Gold, kartë Mastercard të parapaguar, si dhe për herë të parë në treg kartat Mastercard World Debiti dhe Krediti nëpërmjet të cilave klienti bëhet pjesë e disa përfitimeve falas

dhe në mënyrë automatike, si siguracion, shërbimin e zëvendësimit të kartës në rast emergjence, një sistem përfitimi në cash ose në pikë, etj.

Më poshtë, disa nga treguesit kryesorë të aktivitetit të kartave dhe shifrat e rritjes së tyre në vitin 2016 krahasuar me një vit më parë:

- Rritje me 10% e volumit të transaksioneve me kartat e debitit Visa Electron.
- Rritje me 24% e volumit të transaksioneve me kartat e kreditit Visa Classic.
- Rritje me 21% e volumit të transaksioneve me kartat e parapaguara.
- Rritje me 35% e volumit të transaksioneve me kartat e kreditit Visa Business.
- Merchant Acquiring: Rritje me 48% e volumit të transaksioneve.
- Rritje me 119 % e aktivitetit të terminaleve E-Commerce.

Në fokus për vitin 2017 do të vazhdojë të mbetet rritja dhe përmirësimi i vazhdueshëm i të gjithë treguesve të aktivitetit të kartave, në numër dhe volum transaksionesh edhe si lëshues, edhe si pranues të kartave Visa dhe Mastercard. Shtimi i një brandi të ri prestigjioz si Mastercard dhe pranimi i valutës Euro nga терминалет Credins bank, parashikohet të sjellë rritje të kërkesës nga ana e tregtarëve për pajisjen me to.

**Blerje te zakonshëme
me shpejtësi të
jashtëzakonshme !**



Mastercard contactless.

Tap & Go™

Është e shpejtë dhe e thjeshtë. Mjafton një "tap" në POS me kartën tuaj dhe nuk keni nevojë ta kaloni kartën në POS. Për blerje mbi 20 Euro, duhet të vendosni kodin tuaj PIN për më shumë siguri



AKTIVITETI NË FUSHËN E TEKNOLOGJISË INFORMATIVE

Strategjia e bankës për të qenë në pararojë të tendencave të tregut në fushën teknologjike, ka qenë udhërrëfyese i biznesit dhe zhvillimit të produkteve të reja inovative.


Gjatë 2016, departamenti i IT vazhdoi të mbështesë operacionet në rritje të bankës duke siguruar funksionimin e sistemeve në mënyrë normale dhe pa ndërprerje. Hapja e selisë qendrore dhe përqëndrimi i të gjithë divizioneve dhe departamenteve të bankës në këtë godinë, ishte sfidë e rëndësishme e fillimit të vitit që u përmbush në kohë rekord dhe me cilësi të lartë. Ky moment u shfrytëzua gjithashtu për të bërë kalimin nga centrali telefonik analog në central virtual voip, një sistem i avancuar teknologjik që i siguron bankës jo vetëm një komunikim cilësor por dhe një racionalizim të shpenzimeve për zërin e komunikimit. Gjatë vitit 2016 u integrua sistemi i Leasing në infrastrukturën e bankës dhe u përfundua një përditësim i serverave dhe infrastrukturës së IT.

“DATAWAREHOUSE” DHE “BUSINESS INTELLIGENCE”

Gjatë vitit 2016 u realizua faza pilot e “DataWarehouse” dhe u përzgjedh kompania fituese IN2. Ky projekt do të mundësojë një sistem automatik të gjenerimit të raporteve në dobi të biznesit, duke mundësuar analiza dhe monitorim më të mirë të segmenteve të ndryshme të bankës. Për të siguruar një platformë sa më efektive, analiza u krye on-site nëpërmjet katër workshop-e me pjesëmarrjen e IT, MIS, njësi të tjera të interesuara brenda Bankës sipas rastit dhe kompanisë IN2. Brenda 2017, pritet të fillojë gjenerimi i raporteve të para në përputhje me nevojat e identifikuara gjatë analizës.

Gjatë vitit 2016 u siguroi krijimi i një ndërfaqe midis mjeteve të SFE dhe BankUP. Të dhënat e shitjes së produkteve kalohen në databazën e SFE. Programi është duke u kollaudoar.

Gjithashtu është punuar në një numër të madh projektesh lidhur me mjaftueshmërinë e kapitalit, pastrimin e të dhënave, kodifikimin e produkteve, Swift Sanction Screening, identifikimi i llogarive dormant, pilotimin e ndërfaqes Jeniux në dy degë, automatizimin e komisioneve për e-Banking, testimet dhe përditësimet lidhur me Mastercard, ndryshimi i programit të ASD duke përfshirë depozitat e kompanive në sistemin e raportimit. Puna e departamentit në 2016 ka rezultuar në plotësimin e 113 kërkesave për raporte. Nga Departamenti IT janë kryer 88 trajnime. Disponueshmëria e komunikimit me degët ka qenë 98.986%. Disponueshmëria e ATM-ve ka qenë 98.863%. Komunikimi për raportimin e problemeve apo prezantimin e kërkesave është kryer ndërmjet mjeteve të dedikuara për helpdesk duke shërbyer 9,478 kërkesa.



PROJEKTET

Gjatë vitit 2016 Departamenti i Projekteve ka qenë i angazhuar në shumë aktivitete, një pjesë e të cilave janë menaxhuar prej tij dhe pjesa tjetër janë suportuar. Kështu nga projektet në fokus të menaxhuar nga Departamenti i Projekteve ishte Data Cleaning (Pastrimi i të Dhënave) dhe ndjekja e monitorimi i llogarive debitore të klientëve.

Ndërkohë ka vazhduar puna për koordinimin e aktiviteteve për marrëdhënien midis dy institucioneve Credins bank – Credins Invest, si dhe Credins – Posta Shqiptare.

Në shtator 2016, nisi projekti “Përmirësimi i menaxhimit të proceseve në front office”. Ky projekt do të synojë rritjen e efikasitetit të operacioneve në front office me qëllim rritjen e kohës së dedikuar marrëdhënies me klientët dhe shitjes së produkteve dhe shërbimeve të Bankës. Përmirësimi i proceseve në front office, është

në lidhje të ngushtë me iniciativat strategjike të bankës, si rritja e efektivitetit të forcës shitëse dhe rritjen e efektivitetit të vetë procesit të shitjes.

Projekti është planifikuar të zgjasë një vit dhe momentalisht është në fundin e fazës së parë.

Draftimi i biznes planit të bankës 2017 dhe prezantimi për aprovim pranë Këshillit Drejtues ishte një tjetër projekt i rëndësishëm i realizuar me kontributin e njësive të biznesit dhe departamenteve të tjera në bankë.

Credins bank ka marrëdhënie me palët e treta (IFC, EBRD, DFE, KFË, BSTDB, ICD, METSZH, AZHBR, MADA) dhe pjesë e detyrimeve kontraktuale në këto marrëdhënie është monitorimi dhe raportimi i aktiviteteve, pjesë e aktivitetit të Departamentit të Projekteve.

MONIKA MILO
Zëvendës Drejtore e Përgjithshme



Gjatë vitit 2016 u implementua me sukses një ndër projektet me ambicioze të bankës që lidhet drejtpërdrejtë me shërbimin e klientëve tanë të rinj dhe të vjetër. Fokus i këtij projekti ishte rritja e efektivitetit të forcës shitëse në 49 degët e bankës. Impulsi për implementimin e një projekti me përmasa të tilla erdhi pikërisht atëherë kur rritja e bankës si biznes dhe sofistikimi i klientelës së saj, kërkonin të trajtoheshim me standarde të një niveli tjetër që jo vetëm do të rrisin ndjeshmërinë ndaj nevojave të klientelës por dhe do t'i japin nxitje shtesë rritjes së biznesit të bankës. Këto standarde janë bërë tashmë pjesë e vlerave korporative të Institucionit duke e pozicionuar bankën në një nivel superior shërbimi ndaj klientit, cilësisht dhe profesionalisht.



DEPARTAMENTI I BURIMEVE NJERËZORE


Numri total i stafit Janar 2016

739 

Numri total i stafit deri në 31 Dhjetor 2016

800  8.2%

2. Ndarja gjinore:



3. Kualifikimi i Stafit



4. Gjatë vitit 2016 janë zhvilluar në total 35,828 orë trajnimi nga të cilat:



Trajnime të punonjësve të brendshëm që janë promovuar në pozicione të reja.



Trajnime të punonjësve të brendshëm



Trajnime të punonjësve të rinj të rekrutuar nga jashtë banke

5. Janë rekrutuar gjithsej 134 punonjës nga jashtë banke, prej tyre 13 janë praktikantë të projektit të Zyrës së Punës nga të cilët 9 janë emëruar dhe janë promovuar në pozicione të reja 92 punonjës të brendshëm.

6. Mosha mesatare e stafit 36 vjeç.

7. Statistikat mesatare lidhur me trajnimet për vitin 2016.





KARRIERA

Njerëzit tanë janë çelësi i suksesit!

Punonjësit tanë janë avantazhi kryesor konkurrues. Bashkëpunimi i brendshëm, aftësitë profesionale dhe integriteti moral janë në thelb të kulturës sonë.

PËRGJEGJËSIA SOCIALE

PËRGJEGJËSISË SOCIALE E CREDINS BANK NË PËRPUTHJE ME 17 OBJEKTIVAT PËR ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM

OBJEKTIVI #1:



Pa varfëri - fund varfërisë në çdo formë dhe kudo, promovimi i agrokulturës dhe mbështetja ndaj fermerëve të vegjël. Eliminimi i varfërisë në të gjitha format kudo!

Credins Bank, gjatë vitit 2016, në kuadër të politikave të saj ka mbështetur Dhomën Britanike të Tregtisë dhe Industrisë së Shqipërisë dhe Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit. Mbështetja financiare prej 5,731,550 Lekë pati si qëllim krijimin e një platforme për inkurajimin e prodhuesve të Agrobiznesit duke vendosur si prioritet zhvillimin e biznesit

dhe mënyrën se si ti shtojnë vlerë produktit të tyre në kërkim për tregje të reja. Banka ofroi gjithashtu zgjidhje financiare dhe paketa sigurimi për bizneset pjesëmarrëse.

OBJEKTIVI # 2:



Zero uri - Eliminimi i urisë, arritja e sigurisë ushqimore dhe përmirësimit të ushqyerjes dhe nxitja e bujqësisë së qëndrueshme!

“Credins Bank DHURON”, ishte iniciativa e ndërmarrë nga vetë punonjësit e 57 degëve të bankës dhe punonjësit e Drejtorisë Qëndrore për tu organizuar në

dhurimin e veshjeve dhe lodrave për fëmijët në nevojë. Kjo iniciativë u shpërnda në shumë institucione, ku mund të përmendim “Qendrën Kombëtare të Emergjencave” dhe institucione të tjera me karakter komunitar. Një tjetër organizim vullnetar nga banka iu bashkua thirrjes së Club FM radio në maratonën live 48 orëshe si dhe Fundjavës Ndryshe në ndihmë të disa familjeve në nevojë. Një vëmendje e veçantë iu kushtua aktiviteteve në mbështetje të Fshatit SOS dhe Sindromës Down duke treguar një përkujdesje dhe një rritje të ndërgjegjësimit ndaj këtij komuniteti.

OBJEKTIVI #3:



Shëndet i mirë dhe mirëqenie - Sigurimi i jetës së shëndetshme dhe nxitja e mirëqënies për të gjithë njerëzit e çdo moshe!

Credins Bank, si çdo vit tjetër, luajti një rol të rëndësishëm në iniciativat e ndërmarra në përkrahje të sistemit shëndetsor, ku një kontribut me mjaft vlerë ka qenë partneriteti me disa Spitale Rajonale të vendit për rritjen e përmirësimit të kushteve spitalore dhe ofrimin e një shërbimi sa më cilësor, në mbështetje të iniciativave që nxisin përmirësimin e Infrastrukturës shëndetësore dhe sensibilizimin e popullsisë për një mirëqenie e shëndet të mirë.

Gjatë vitit 2016 janë mbështetur me një total prej 8,347,371 Lekë disa spitale dhe qendra shëndetsore në të gjithë vendin. Banka ka bashkëpunuar për organizimin e fushatave sensibilizuese si Organizata Shqiptare e dhuruesve vullnetarë të gjakut, në kuadër kjo, të nxitjes dhe përhapjes në Shqipëri të praktikës së dhurimit të gjakut në mënyrë vullnetare.

OBJEKTIVI #4:



Arsim Cilësor - Sigurimi i arsimit cilësor gjithëpërfshirës dhe të drejtë dhe nxitja e mundësive për mësim gjatë gjithë jetës për të gjithë!

Kultura dhe arsimi mbeten

në fokus të politikave të përgjegjësive sociale të Credins Bank si një kontribut i çmuar në dobi të komunitetit. Kontributi i bankës për vitin 2016 ka qenë 1,509,394 Lekë, në kuadër të organizimit të promovimit të disa librave të autorëve të shquar shqiptarë, si dhe ka realizuar organizimin e një konkursi kombëtar në disa universitete.

OBJEKTIVI #5:



Arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i të gjitha grave dhe vajzave!

Credins Bank beson në rritjen dhe fuqizimin e vlerave të grave. Ky parim është konsideruar thelbësor dhe ka qenë në qendër të politikave të burimeve njerëzore të bankës, referuar shanseve të punësimit e promovimit të grave dhe vajzave. Banka promovon parime biznesi që mundësojnë aplikimin e grave në biznes. Për më tej me politikën e saj të sponsorizimit, banka ka ofruar një kontribut prej 200,000 Lekë për aktivitete sociale dhe kulturore që promovojnë rolin e gruas në shoqëri.

OBJEKTIVI #8:



Punë dinjitoze dhe rritje ekonomike: - Nxitja e rritjes ekonomike të vazhdueshme, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme, punësim të plotë dhe produktiv dhe punë të denjë për të gjithë!

Credins Bank ka bashkëpunuar gjatë 2016 me institucione të ndryshme qëndrore dhe lokale në Tiranë, Fier, Korçë, në projekte të ndryshme për përmirësimin e kushteve të punës që mundësojnë rritje ekonomike. Totali i këtij kontributi ka qenë 1,141,520 Lekë.

OBJEKTIVI #9:



Industri, Inovacion dhe Infrastrukturë - investim në infrastrukturë dhe studime shkencore - Ndërtimi i infrastrukturave rezistuese, nxitja e industrializimit gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm dhe nxitja e inovacionit!

Gjatë vitit 2016, në përputhje me këtë objektiv, Credins Bank, ka investuar dhe zhvilluar politika

për mbështetjen me financim të projekteve të qëndrueshme në fushën e industrisë dhe inovacionit. Për më tej, në kuadër të përgjegjësisë sociale, banka ka kontribuar me financim institucione si bashki, qendra shëndetësore dhe shoqata me një total prej 5,148,830 Lekë duke mundësuar pajisje, sisteme e programe kompjuterike dhe sinjalistika në përmirësimin e infrastrukturës së këtyre institucioneve.

OBJEKTIVI #11:



Qytete dhe komunitete të qëndrueshme - Kthimi i qyteteve dhe vendbanimeve gjithëpërfshirës, të parrezikshëm, elastik dhe të qëndrueshëm!

Credins Bank është një aktor i rëndësishëm në kontributin e saj për të pasur një komunitet aktiv dhe qytete me zhvillim të qëndrueshëm që ofrojnë hapësira gjithëpërfshirëse dhe përmirësojnë jetën e qytetarëve. Për këtë arsye gjatë vitit 2016 janë mbështetur institucione dhe organizata duke përfshirë këtu 4 bashki dhe investime në aktivitete kulturore duke ndihmuar në konsolidimin e një shoqërie të qëndrueshme. Totali i kontributit të bankës me qëllim përmbushjen e këtij objekti për të gjitha projektet sëbashku është 3,060,000 Lekë.

OBJEKTIVI #15:



Mbrojtja, restaurimi dhe nxitja e përdorimit të qëndrueshëm të ekosistemeve tokësore, administrimi i qëndrueshëm i pyjeve, lufta kundër kthimit të hapësirave në shkretëtirë dhe ndalimi dhe kthimi pas i procesit të degradimit të tokës dhe ndalimi i humbjes së biodiversitetit.

Credins Bank në kuadër të përmirësimit të urbanistikës dhe në mbështetje të komunitetit për zhvillimin e parqeve dhe gjelbërimit, ka luajtur një rol kyç në mbështetjen prej 500,000 Lekë të Bashkisë së Tiranës, për mbjelljen e 1000 rrënjëve Olenader.

OBJEKTIVI # 16:



Nxitja e shoqërive paqësore dhe gjithëpërfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, ofrimi i mundësisë për drejtësi për të gjithë dhe institucioneve të efektshme, llogaridhënëse dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet.


Gjatë vitit 2016, fusha e sportit dhe artit kanë zënë një pjesë të rëndësishme të politikave mbështetëse të bankës të cilat kanë ndikuar në përmirësimin e infrastrukturës për klube sportive dhe zhvillimin e aktiviteteve të artit si një domosdoshmëri për të patur institucione sa më të efektshme. Në këto dy sektorë banka ka bashkëpunuar dhe ka ofruar mbështetje një me financim prej 3,603,448 Lekë.

KONTEKSTI RREGULLATOR

Gjatë vitit 2016, pati ndryshime të shumta rregullatore të cilat impaktuan sektorë të ndryshëm të bankës dhe u reflektuan në modifikime në rregullore e procedura të brendshme. Total i ndryshimeve i kalon 170 me një ndarje si më poshtë:

Departamenti i Burimeve Njerëzore	15
Departamenti Financës	23
Divizioni i Riskut	38
Departamenti Operacional	2
Departamenti Audit	1
Departamenti Juridik	36
Departamenti Kartave	2
Drejtoria e Prokurimeve dhe Mirëmbajtje	11
Departamenti i Teknologjisë së Informacionit	3
Drejtoria Ligjore e Riskut të Kredisë	3
PPP (Parandalimi i Pastrimit të Parave)	8
Departamenti Marketing	1
Departamenti Thesarit	6
Drejtoria e Sigurisë	6
Kredia	2
Menaxhimi i Aseteve	1
Përputhshmëria	2
Rrjeti i Degëve	6
Protokolli	1
Shitja	3

RRJETI I DEGËVE



RAJONET NË TIRANË DHE NUMRI I PUNONJËSVE

RAJONI 1

DEGA QENDRORE
LAPRAKË
TIRANA 1
TIRANA 2
KAMËZ
AGJENCIA EMIGRES
VORË
RING CENTER

RAJONI 2

TIRANA 3
TIRANA 10
TIRANA 12
TIRANA 14
KOMBINAT
AGJENCIA HIPOTEKË

108
PUNONJËS

45
PUNONJËS

RAJONI 3

TIRANA 5
TIRANA 6
TIRANA 7
TIRANA 8
TIRANA 9


RAJONI 4

TIRANA 4
TIRANA 11
TIRANA 13
TIRANA 15
TIRANA 16
AGJENCIA QKR


45
PUNONJËS

48
PUNONJËS

RAJONI DURRËS



RAJONI VERI




RAJONI JUG



RAJONI JUGLINDJE



RAJONI JUGPERËNDIM





PASQYRAT FINANCIARE PËR PERIUDHËN DERI MË 31 DHJETOR 2016

(ME RAPORTIN E AUDITUESVE TË PAVARUR)

PËRMBAJTJA

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

PASQYRA E KONSOLIDUAR E FITIM HUMBJES	1
PASQYRA E KONSOLIDUAR E TË ARDHURAVE GJITHPËRFSHIRËSE	2
PASQYRA E KONSOLIDUAR E POZICIONIT FINANCIAR	3
PASQYRA E KONSOLIDUAR E NDRYSHIMIT TË KAPITALIT	4
PASQYRA E KONSOLIDUAR E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	5
1 INFORMACION I PËRGJITHSHËM	6
2 POLITIKAT KONTABËL	6
2.1 BAZAT E PËRGATITJES	6
2.2 BAZAT E KONSOLIDIMIT	6
2.3 PËRDORIMI I VLERËSIMEVE DHE GJYKIMEVE	8
2.4 NDRYSHIMET NË POLITIKAT KONTABËL DHE INFORMACIONET SHPJEGUESE	9
2.5 PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL	13
3 TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET NGA INTERESAT	23
4 TË ARDHURA DHE SHPENZIME NGA TARIFAT DHE KOMISIONET	23
5 TË ARDHURA DHE SHPENZIME TË TJERA	24
6 SHPENZIME PERSONELI	24
7 SHPENZIME ADMINISTRATIVE	24
8 SHPENZIMI I TATIMIT MBI FITIMIN	24
9 MJETE MONETARE DHE EKUIVALENTE ME TO	25
10 SHUMA TË KUSHTËZUARA ME BANKËN QËNDRORE	25
11 HUA DHE PARADHËNIE BANKAVE DHE INSTITUCIONEVE TË TJERA FINANCIARE	26
12 HUA DHE PARADHËNIE PËR KLIENTËT	26
13 QIRA FINANCIARE	28
14 LETRA ME VLERË TË VLEFSHME PËR SHITJE	28
15 INVESTIME TË MBAJTURA DERI NË MATURIM	30
16 AKTIVE AFATGJATA MATERIALE	31
17 AKTIVE JO-MATERIALE	32
18 AKTIVE TATIMORE TË SHTYRA	32
19 PRONA TË RIPOSEDUARA	32
20 KOMBINIMI I BIZNESIT DHE INTERESAVE JO-KONTROLLUES	33
20.1 BLERJE E CREDINS INVEST SH.A	33
20.2 BLERJA E ALREG SH.A	34
21 AKTIVE TË TJERA	34
22 DETYRIMET NDAJ BANKAVE DHE INSTITUCIONEVE TË TJERA FINANCIARE	34
23 HUAMARRJE	34
24 DETYRIME NDAJ KLIENTËVE	35
25 BORXHI I VARUR	36
26 DETYRIME TË TJERA	36
27 PROVIGJONET	37
28 PRIMI I KAPITALIT	37
29 KAPITALI AKSIONAR	37
29.1 KAPITALI AKSIONAR I BANKA CREDINS SH.A	37
29.2 PËRTHITHJA ME CREDINS LEASING SH.A	38
30 REZERVA E PËRGJITHSHME	38
31 ANALIZË MATURIMI PËR AKTIVET DHE DETYRIMET	39
32 ANGAZHIME DHE DETYRIMET E KUSHTËZUARA	40
33 SHËNIME PËR PALËT E LIDHURA	41
34 NGJARJET PAS DATËS SË BILANCIT	42
35 ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR	42
35.1 NJË VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM	42
35.2 RREZIKU I KREDISË	43
35.3 RREZIKU I LIKUIDITETIT	51
35.4 RREZIKU I TREGUT	55
35.5 RREZIKU OPERACIONAL	59
35.6 MENAXHIMI I KAPITALIT	59
35.7 SHËNIME SHPJEGUESE PËR VLERËN E DREJTË	60

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Aksionarëve të Banka Credins sh.a.

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të konsoliduara të Banka Credins sh.a. (më poshtë "Banka" os "Grupi Credins"), që përfshijnë pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2016 dhe pasqyrat e konsoliduara të të ardhurave gjithpërfshirëse, ndryshimeve në kapital dhe flukseve të parasë për vitin që mbyllet më këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare të konsoliduara, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të konsoliduara paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Grupit Credins më 31 dhjetor 2016, të rezultatit të tij financiar dhe të fluksit të mjeteve monetare për vitin e mbyllur në atë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF"-të).

Baza për opinionin

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ("SNA"-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në paragrafin *Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare të konsoliduara* të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Grupi Credins në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (Kodi i "BSNEPK") së bashku me kërkesat etike që janë të përshtatshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe të Kodit BSNEPK. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e drejtimit dhe të personave të ngarkuar me qeverisjen në lidhje me pasqyrat financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare të konsoliduara në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme, që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Grupit Credins për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Grupin Credins ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Grupit Credins.

Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare të konsoliduara

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare të konsoliduara në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare të konsoliduara (vazhdim)

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare të konsoliduara.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- ▶ Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale të pasqyrave financiare të konsoliduara, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidenca auditimi që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.
- ▶ Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm, që ka të bëjë me auditimin me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionit mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Grupit Credins.
- ▶ Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- ▶ Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Grupit Credins për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare të konsoliduara, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Grupi Credins të ndërpresë veprimtarinë.
- ▶ Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare të konsoliduara, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare të konsoliduara paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen e Banka Credins sh.a, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Ernst & Young - Ekspertë Kontabël të Autorizuar
Dega në Shqipëri

Ernst & Young Certified Accountants

31 maj 2017
Tiranë, Shqipëri

Mario Vangjel
Ekspert Kontabël i Regjistruar



Pasqyra e konsoliduar e fitim humbjes

për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016¹

	Shënime	Viti i mbyllur 31 dhjetor 2016 '000 Lekë	Viti i mbyllur 31 dhjetor 2015 '000 Lekë
Të ardhura nga interesat	3	9,202,233	8,869,801
Shpenzime për interesat	3	(2,163,067)	(2,692,260)
Të ardhura neto nga interesat	3	7,039,166	6,177,541
Të ardhura nga komisionet	4	657,647	535,950
Shpenzime për komisionet	4	(111,388)	(59,492)
Të ardhura neto nga komisionet	4	546,259	476,458
Shpenzime të tjera	5	(169,600)	(38,763)
Të ardhura të tjera	5	202,064	147,439
Fitimi nga kurset e këmbimit		274,635	664,716
Të ardhura të tjera bankare		307,099	773,392
Humbje nga zhvlerësimi i huave	12	(3,080,226)	(3,978,006)
Humbje nga huatë e pambledhshme	12	(1,060,129)	(333,057)
Amortizimi i aktiveve afatgjata jomateriale	17	(44,973)	(41,184)
Amortizimi i aktiveve afatgjata materiale	16	(189,009)	(123,270)
Shpenzime personeli	6	(1,077,732)	(910,094)
Shpenzime administrative	7	(2,024,039)	(1,906,634)
		(7,476,108)	(7,292,245)
Fitimi para tatimit		416,416	135,146
Shpenzime tatim fitimi	8	(169,587)	(77,412)
Tatim fitimi i shtyrë	8	7,800	68,360
Fitimi neto i vitit		254,629	126,094
Për:			
Aksionarët e Mëmës		256,941	127,405
Interesa jo-kontrollues		(2,312)	(1,311)
		254,629	126,094

¹ Shënimet 1 deri 35 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara

Pasqyra e konsoliduar e të ardhurave gjithpërfshirëse

për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016¹

Shënime	Viti i mbyllur 31 dhjetor 2016 '000 Lekë	Viti i mbyllur 31 dhjetor 2015 '000 Lekë
Fitimi neto i periudhës	254,629	126,094
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse		
<i>Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse për tu riklasifikuar në fitim ose humbje në periudhat e mëvonshme:</i>		
Rivlerësimi i aktiveve financiare të vlefshme për shitje	14 (98,984)	107,494
Efekti i tatim fitimit	14,847	(16,124)
	(84,137)	91,370
<i>Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse neto për t'u riklasifikuar në fitim ose humbje në periudhat pasardhëse:</i>	(84,137)	91,370
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse për vitin, pas tatim fitimit	(84,137)	91,370
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse pas tatimit mbi fitimin	170,492	217,464
Për:		
Aksionarët e Mëmës	172,284	218,775
Interesi jo-kontrollues	(1,792)	(1,311)
	170,492	217,464

Këto pasqyra financiare të konsoliduara janë miratuar nga Bordi Drejtues i Banka Credins sh.a më 11 maj 2017 dhe janë nënshkruar në emër të tij nga:

Maltin Korkuti
Drejtör i Përgjithshëm




Valentina Prodani
Drejtör i Departamentit Financë Kontabiliteti



¹ Shënimet 1 deri 35 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara

Pasqyra e konsoliduar e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2016¹

	Shënime	31 dhjetor 2016 '000 Lekë	31 dhjetor 2015 '000 Lekë
Aktivët			
Mjete monetare dhe ekuivalentë me to	9	29,040,607	18,889,094
Shuma të kushtëzuara me Bankën Qëndrore	10	11,520,723	11,060,066
Hua dhe paradhënie bankave dhe institucioneve të tjera financiare	11	1,535,146	1,779,820
Letra me vlerë të vlefshme për shitje	14	21,308,475	19,077,358
Qira financiare	13	945,775	965,241
Hua dhe paradhënie për klientët	12	93,473,577	85,250,623
Letra me vlerë të mbajtura deri në maturim	15	-	17,289
Parapagim tatim fitimi		64,441	134,533
Aktive të tjera	21	1,279,087	1,199,566
Prona të riposeduara	19	3,608,181	3,699,881
Aktive afatgjata materiale	16	2,465,056	929,412
Aktive afatgjata jomateriale	17	122,994	138,593
Emri i mirë	20	43,371	43,371
Aktive tatimore të shtyra	18	75,673	53,026
Totali i aktiveve		165,483,106	143,237,873
Detyrimet			
Detyrimet ndaj bankave dhe institucioneve të tjera financiare	22	2,492,665	1,744,813
Detyrime ndaj klientëve	24	143,805,272	123,519,697
Huamarrje	23	199,861	1,102,042
Detyrime të tjera	26	111,109	109,978
Provigjone	27	2,275	1,525
Borxhi i varur	25	5,410,219	4,854,857
Totali i detyrimeve		152,021,401	131,332,912
Kapitali			
Kapitali aksionar	28,29	7,307,701	6,382,916
Primi i aksioneve	28	2,892,166	2,369,595
Rezerva e përgjithshme	30	1,446,025	1,446,025
Rezerva e rivlerësimit të letrave me vlerë	14	7,920	92,577
Fitime të pashpërndara		1,798,314	1,606,530
Kapitali total i atribueshëm tek aksionarët e mëmës		13,452,126	11,897,643
Interesa jo-kontrolluese		9,579	7,318
Totali i kapitalit aksionar		13,461,705	11,904,961
Totali detyrimeve dhe kapitalit aksionar		165,483,106	143,237,873

¹ Shënimet 1 deri 35 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara

Banka Credins sh.a.

Pasqyra e konsoliduar e ndryshimit të kapitalit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016¹

	Kapitali aksionar	Primi i aksioneve	Rezerva e përgjithshme	Rezerva rivlerësimi	Fitimi i pashpërndarë	Kapitali total i atribueshëm tek aksionarët e mëmës	Interesi jo-kontrollues	Totali i kapitalit aksionar
'000 Lekë	'000 Lekë	'000 Lekë	'000 Lekë	'000 Lekë	'000 Lekë	'000 Lekë	'000 Lekë	'000 Lekë
Gjendja më 1 janar 2015	5,438,330	1,838,990	1,437,615	1,207	1,458,248	10,174,390	-	10,174,390
Fitimi i vitit	-	-	-	-	127,405	127,405	(1,311)	126,094
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse	-	-	-	91,370	-	91,370	-	91,370
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse	-	-	-	91,370	127,405	218,775	(1,311)	217,464
Përvetësimi i fitimit të pashpërndarë (shënimi 28.1)	36,767	-	-	-	(36,767)	-	-	-
Efekt i bashkimit me përthithje me Credins Leasing (shënimi 28.2)	612,590	311,934	8,410	-	57,644	990,578	-	990,578
Emetim i aksioneve të reja	295,229	218,671	-	-	-	513,900	-	513,900
Interesi jo-kontrollues si rezultat i kombinimit të biznesit	-	-	-	-	-	-	8,629	8,629
Gjendja më 31 dhjetor 2015	6,382,916	2,369,595	1,446,025	92,577	1,606,530	11,897,643	7,318	11,904,961
Fitimi i vitit	-	-	-	-	256,941	256,941	(2,312)	254,629
Humbje të tjera gjithpërfshirëse	-	-	-	(84,657)	-	(84,657)	520	(84,137)
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse	-	-	-	(84,657)	256,941	172,284	(1,792)	170,492
Përvetësimi i fitimit të pashpërndarë (shënimi 28.1)	65,157	-	-	-	(65,157)	-	-	-
Emetimi aksioneve të reja	859,628	522,571	-	-	-	1,382,199	-	1,382,199
Interesi jo-kontrollues si rezultat i kombinimit të biznesit	-	-	-	-	-	-	4,053	4,053
Gjendja më 31 dhjetor 2016	7,307,701	2,892,166	1,446,025	7,920	1,798,314	13,452,126	9,579	13,461,705

¹ Shënimet 1 deri 35 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara

Pasqyra e konsoliduar e fluksit të mjeteve monetare

për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016¹

Shënime	Viti i mbyllur 31 dhjetor 2016	Viti i mbyllur 31 dhjetor 2015
	'000 Lekë	'000 Lekë
Aktivitetet operative		
Fitimi para tatimit	416,416	135,146
<i>Rregullimet për:</i>		
Amortizimin dhe zhvlerësimin	15,16 233,982	164,454
Aktivitet afatgjatë të nxjerra jashtë përdorimi	15,16 18,802	-
Zhvlerësimi i huave dhe paradhënie për klientët dhe qirasë financiare	12,13 3,080,226	3,978,006
Humbje të tjera nga huatë e pambledhshme	12 1,060,129	333,057
Zhvlerësimi i pronave të riposeduara	17 52,000	42,343
Të ardhurat neto nga interesat	3 (7,039,166)	(6,177,541)
Efekti i kursit të këmbimit në borxhin e varur	24 (274,659)	(5,441)
Flukse monetare nga aktivitetet operative përpara ndryshimeve në kapital	(2,452,270)	(1,529,976)
Ndryshimi në hua dhe paradhënie bankave dhe institucioneve të tjera financiare	11 248,742	(1,039,525)
Ndryshimi në hua dhe paradhënie për klientët	12 (12,341,421)	(9,737,602)
Ndryshimi në qiranë financiare	13 19,466	(868,905)
Ndryshimi në shumat e kushtëzuara me Bankën Qendrore	10 (461,480)	(741,376)
Ndryshimi në pronat e riposeduara	18 39,700	(2,030)
Ndryshimi në aktive të tjera	20 (76,704)	(520,575)
Ndryshim në detyrimet ndaj bankave dhe institucioneve të tjera financiare	21 737,276	(88,050)
Ndryshimi në detyrimet ndaj klientëve	23 20,098,315	11,276,119
Ndryshimi në detyrime të tjera	25,26 4,597	(146,465)
Ndryshimi në aktivet operuese nga përthithja	-	1,506,971
Ndryshimi në detyrimet operuese nga përthithja	-	(371,885)
Interesi i arkëtuar	9,364,532	8,587,155
Interesi i paguar	(1,976,054)	(2,838,594)
Tatim fitimi i paguar	(101,299)	(274,421)
Flukset monetare neto nga aktivitetet operative	13,103,400	3,210,841
Flukset monetare nga aktivitetet investuese		
Blerje e letrave me vlerë	14 (18,687,077)	(18,450,643)
Shitje e letrave me vlerë	14 1,116,975	705,000
Letra me vlerë të maturuara	14 15,288,126	14,383,814
Blerje e aktiveve afatgjatë materiale	15 (1,744,778)	(436,629)
Të hyra nga shitja e aktiveve afatgjatë materiale	1,301	6,910
Blerja e aktiveve afatgjatë jo-materiale	16 (29,375)	(43,631)
Flukset monetare neto përdorur në aktivitetet investuese	(4,054,828)	(3,835,179)
Flukset monetare nga aktivitetet financuese		
Flukse hyrëse nga borxhi i varur	24 983,945	1,093,940
Flukse dalëse të borxhit të varur	24 (371,429)	(411,840)
Pagesa të financimeve të reja	22 (891,774)	(215,721)
Emetim i kapitalit	1,382,199	513,900
Flukset monetare neto nga aktivitetet financuese	1,102,941	980,279
Rritje në aktive monetare dhe ekuivalente me to	10,151,513	355,940
Aktive monetare dhe ekuivalente me to më 1 janar	18,889,094	18,531,018
Aktive monetare dhe ekuivalente me to nga përthithja	-	2,136
Aktive monetare dhe ekuivalente me to më 31 dhjetor	29,040,607	18,889,094

¹ Shënimet 1 deri 35 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara

Banka Credins sh.a.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(shuma në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

1 Informacion i Përgjithshëm

Banka Credins sh.a. (këtej e tutje “Grupi Credins” ose “Grupi”) është një institucion financiar Shqiptar i themeluar më 1 prill 2003 në bazë të ligjit tregtar në Shqipëri dhe është licencuar nga Banka e Shqipërisë më datë 31 mars 2003 për të ushtruar aktivitetin e saj si bankë në të gjitha fushat e aktivitetit bankar në Shqipëri në përputhje me Ligjin nr. 8365 “Për Bankat në Republikën e Shqipërisë”, miratuar në korrik 1998. Grupi është gjithashtu subjekt i Ligjit nr. 8269, miratuar në dhjetor 1997, “Mbi Bankën e Shqipërisë” (këtej e tutje referuar si “Banka Qendrore”).

Më 31 dhjetor 2016, Grupi ushtronte aktivitetin e saj nëpërmjet drejtorisë së përgjithshme të saj në Tiranë, 49 degëve në Tiranë, Durrës, Fier, Lezhë, Elbasan, Vlorë, Shkodër, Korçë, Shijak, Shkozë, Kavajë, Lushnjë, Fushë Krujë, Kukës, Burrel, Ballsh, Berat, dhe Peshkopi si dhe 8 agjencive në Tiranë, Shkodër dhe Durrës (31 dhjetor 2015: 48 degë dhe 8 agjenci).

Aksionarët e Grupit kanë rënë dakord që Grupi do blinte 76% të aksioneve me të drejtë vote të “Shoqërisë Administruese të Fondit të Pensionit “SiCRED” sh.a.” që zotëronte “SiCRED sh.a.”, nëpërmjet marrëveshjes së blerjes së aksioneve firmosur më 22 dhjetor 2014, për një shumë prej 60,206 mijë Lekë. Aprovimi për ndryshimin e strukturës së aksionarëve dhe ndryshimi i kontrollit të “Shoqërisë Administruese të Fondit të Pensionit “SiCRED” sh.a.” është dhënë nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare më 28 prill 2015. Ky ndryshim është regjistruar në Qendrën Kombëtare e Biznesit më 28 prill 2015. Ndryshimi është regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) më 10 qershor 2015, që është dhe data kur kontrolli mbi shoqërinë është bërë efektiv. Grupi ka konsoliduar Shoqërinë duke filluar nga data 30 qershor 2015

Gjatë vitit 2015 dhe 2016, Grupi ka emetuar kapital të ri prej 11,400 mijë Lekë dhe 9,220 mijë Lekë respektivisht, nëpërmjet emetimit të aksioneve të reja që e rrisin investimin kapital të Grupit në 76.98%.

Aksionarët e Grupit kanë vendosur të blejnë 95% të aksioneve të “Rregjistri Shqiptar i Titujve “ALREG” sh.a” për vlerën 3,325 mijë Lekë. Ky veprim është regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit më 16 mars 2016. Aktiviteti i ALREG konsiston në menaxhimin e rregjistrit titullar, në përputhje me licensën e marrë nga Bordi i Mbikqyrjes Financiare e Shqipërisë.

Më 31 dhjetor 2016 Grupi kishte 807 punonjës (31 dhjetor 2015: 746 punonjës). Adresa e zyrave qendrore të bankës dhe vendit kryesor të ushtrimit të aktivitetit është: Rr. Vaso Pasha Nr. 8, Tiranë, Shqipëri.

2 Politikat Kontabël

2.1 Bazat e përgatitjes

Pasqyrat financiare të konsoliduara janë përgatitur mbi bazën e kostos historike, përveç investimeve financiare të vlerfshme për shitje të cilat janë matur me vlerë të drejtë dhe promave të riposeduara të cilat janë matur me më të voglën ndërmjet kostos dhe vlerës neto të realizueshme.

Pasqyrat financiare të konsoliduara paraqiten në Lekë, e cila është monedha funksionale e Grupit. Përveç rasteve kur shprehet ndryshe, informacioni financiar i prezantuar është në Lekë, i rrumbullakosur në mijëshen më të afërt.

(i) Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare të konsoliduara të Grupit janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) publikuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (“BSNK”).

(ii) Paraqitja e pasqyrave financiare të konsoliduara

Grupi e paraqet pasqyrën e pozicionit financiar kryesisht sipas rendit të likuiditetit. Një analizë lidhur me arkëtimin ose shlyerjen brenda 12 muajve pas datës së raportimit (korrente), dhe më vonë se 12 muaj nga data e pasqyrave financiare (jo korrente) paraqitet në shënimin 31.

Aktivet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe vlera neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar kur dhe vetëm kur Grupi gëzon të drejtën ligjore për të bërë kompensimin e shumave dhe vlerave, dhe ka si qëllim likuidimin mbi bazën neto ose likuidimin e aktivitetit dhe shlyerjen e detyrimit njëkohësisht. Te ardhurat dhe shpenzimet paraqiten neto vetëm nëse lejohen nga standardet e kontabilitetit ose interpretimet, dhe siç shpjegohet në mënyrë specifike në politikat kontabël të Grupit.

2.2 Bazat e konsolidimit

Pasqyrat financiare të konsoliduara përfshijnë pasqyrat financiare të Grupit dhe filialeve të tij më 31 dhjetor 2016.

Banka Credins sh.a.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(shuma në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

2 Politikat Kontabël (vazhdim)

2.2 Bazat e konsolidimit (vazhdim)

Kontrolli arrihet kur Mëma ekspozohet, ose i lind e drejta të përfitojë nga përfshirja e tij në filial, të ardhura të cilat mund të jenë të variushme, si dhe nëse ka aftësinë të afektojë këto rezultate nëpërmjet ndikimit të tij mbi filialin.

Specifikisht, Mëma kontrollon një filial, nëse dhe vetëm nëse, Mëma ka:

- Ndikim mbi filialin (p.sh: të drejta ekzistuese që i japin mundësinë të drejtojnë aktivitetet kryesore të filialit)
- Ekspozim ose i lind e drejta e përfuturit të rezultateve si rrjedhojë e përfshirjes së saj në filial
- Aftësinë për të ushtruar ndikimin e saj mbi filialin, për të ndikuar mbi rezultatet e ardhshme, që përfshijnë:

Përgjithësisht, prezumohet që kush ka shumicën e të drejtave të votës, ushtron kontrollin. Për të mbështetur këtë supozim, si dhe në rastet kur Mëma nuk ka shumicën e të drejtës së votës mbi një filial, Mëma konsideron të gjithë faktorët dhe rrethanat për të vlerësuar nëse ka ndikim mbi filialin, të tillë si:

- Marrëveshjet kontraktuale me të tjerë aksionere që kanë të drejta vote në filial
- Të drejta të cilat vijnë nga marrëveshje të tjera kontraktuale
- Të drejtat e votës së Grupit si dhe të tjera të drejta vote të mundshme

Mëma rivlerëson fakin nëse ajo kontrollon ose jo një filial, në bazë të fakteve dhe rrethanave të cilat diktojnë që mund të ketë ndryshime në një ose më shumë elemente të kontrollit. Konsolidimi i filialeve fillon kur Mëma merr kontrollin dhe mbaron kur Mëma e humbet këtë kontroll mbi filialin.

Aktivet, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet e filialit të blerë ose të shitur gjatë vitit përfshihen në pasqyrat financiare të konsoliduara nga data që Mëma merr kontrollin deri në datën kur ajo e humbet atë.

Fitimi ose humbja dhe çdo element i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse i përkasin aksionerëve të mëmës si dhe interesave jo-kontrollues, edhe në rastin kur kjo sjell si pasojë një interes jo-kontrollues negativ. Në rastet që gjykohej e nevojshme, bëhen rregullime në pasqyrat financiare të filialeve për të sjellë politikat e tyre kontabël në linjë me politikat kontabël të përdorura nga Grupi. Të gjitha të drejtat dhe detyrimet, dhe aktivet, kapitali, të ardhurat dhe shpenzimet dhe flukset e parasë të lidhura me transaksione të ndodhura ndërmjet shoqërive të Grupit eliminohen plotësisht në konsolidim. Një ndryshim në interesin e zotëruar në një filial, që nuk sjell si pasojë humbjen e kontrollit, kontabilizohet si një transaksion me kapitalin.

Nëse Mëma humbet kontrollin mbi filialin, ai rregjistron të gjitha aktivet (duke përfshirë edhe emrin e mirë), detyrimet, interesin jo-kontrollues si dhe elementë të tjerë të kapitalit, duke njohur në fitim ose humbje cdo rezultat nga rregjistrimi. Çdo investim i mbajtur njihet me vlerë të drejtë.

a) Kombinimi i bizneseve dhe emri i mirë

Kombinimi i bizneseve kontabilizohet duke përdorur metodën e blerjes. Kostoja e blerjes matet si shuma e të gjithë vlerës së transferuar, e cila matet me vlerën e drejtë në datën e blerjes si dhe me vlerën e çdo interesi jo-kontrollues në shoqërinë e blerë. Për cdo kombinim biznesi, Grupi zgjedh nëse do ta masë interesin jo-kontrollues me vlerë të drejtë ose me pjesën proporcionale të tij në aktivet neto të identifikueshme të shoqërisë së blerë. Kostot e lidhura me blerjen përfshihen në shpenzimet e periudhës kur ndodhin dhe konkretisht në zërin shpenzime administrative.

Kur Grupi blen një biznes, ai vlerëson aktivet financiare dhe detyrimet financiare të marra, për klasifikimin e përshtatshëm si dhe alokimin në përputhje me termat kontraktuale, rrethanat ekonomike dhe kushtet specifike në datën e blerjes. Çdo konsideratë e mundshme që do duhet të transferohet nga shoqëria blerëse, do të matet me vlerën e drejtë në datën e blerjes. Konsiderata e mundshme që klasifikohet si aktiv ose detyrim si instrument financiar, dhe sipas qëllimit të SNK 39 Instrumentat financiarë: Njohja dhe matja, matet me vlerë të drejtë, dhe ndryshimet në vlerën e drejtë njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes.

Emri i mirë matet fillimisht me kosto (që rezulton nga tejkalimi i konsideratës së dhënë dhe vlerës së njohur për interesin jo-kontrollues) si dhe ndonjë interes tjetër mbi aktivet neto të identifikueshme dhe detyrimet e marra. Nëse vlera e drejtë e aktiveve neto të blera tejkalon shumën totale të konsideratës së transferuar, Mëma ri-vlerëson nëse i ka identifikuar saktë të gjitha aktivet e blera dhe të gjitha detyrimet e marra, si dhe rishikon procedurat e përdorura për të vlerësuar shumat për tu njohur në datën e blerjes. Nëse rivlerësimi rezulton sërish në tejkalim të konsideratës së transferuar, atëherë fitimi njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes.

Banka Credins sh.a.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(shuma në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

2 Politikat Kontabël (vazhdim)

2.2 Bazat e konsolidimit (vazhdim)

a) Kombinimi i bizneseve dhe emri i mire (vazhdim)

Pas njohjes fillestare, emri i mirë matet me kosto duke i zbritur çdo zhvlerësim të akumuluar.

Për qëllim të testimit të rënies së vlerës, emri i mirë i përfshirë nga kombinimi i biznesit, i alokohet çdo njësie gjeneruese të parasë së Grupit, që priten të përftojnë nga kombinimi, pavarësisht nëse aktive dhe detyrime të tjera të shoqërisë së blerë i janë alokuar atyre.

2.3 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Gjatë procesit të aplikimit të politikave kontabël të Grupit, drejtimi ka ushtruar gjykim dhe vlerësim në përcaktimin e shumave të njohura në pasqyrat financiare të konsoliduara. Përdorimet më të rëndësishme të gjykimeve dhe vlerësimeve janë si vijon:

(I) Parimi i vijimësisë

Grupi kryen rregullisht “stress test-e”, për të testuar ndikimin e mundshëm të indikatorëve makroekonomikë në pozicionin financiar, performancën dhe përputhshmërinë rregullatore. Këto “stress test-e” janë fokusuar kryesisht në impaktin që disa skenarë makro dhe mikroekonomikë mund të kenë në portofolin e kredisë, duke qenë burimi kryesor i të ardhurave të Grupit, pozicionit financiar duke përfshirë rrezikun e tregut. Gjatë këtij testimi përdoren modele zyrtare parashikuese të Bankës së Shqipërisë dhe vlerësime të brendshme të Grupit. Testet janë dinamike dhe kryhen për të vlerësuar efektin e mundshëm të ndikimit të panikut të klientit tek zërat e ndryshëm të bilancit, të ardhurave dhe shpenzimeve, për një periudhë të caktuar kohore. Drejtimi i Grupit ka kryer një vlerësim të aftësisë së Grupit për të vazhduar aktivitetin në vijimësi dhe është i kënaqur që Grupi ka burime për të vazhduar biznesin dhe aktivitetin në të ardhmen. Gjithashtu, drejtimi nuk është në dijeni të ndonjë pasigurie materiale që mund të sjellë dyshime të konsiderueshme mbi mundësinë e Grupit për të vazhduar në vijimësi. Rrjedhimisht, pasqyrat financiare të konsoliduara vazhdojnë të përgatiten në bazë të parimit të vijimësisë. Për më shumë detaje për mjaftueshmërinë e kapitalit, referohuni shënimit numër 35.6.

(II) Humbjet nga zhvlerësimi i huave dhe paradhënieve

Grupi rishikon portofolet e tij të kredisë në baza mujore për të vlerësuar zhvlerësimin. Në përcaktimin nëse një humbje nga zhvlerësimi duhet të regjistrohet në fitim ose humbje, Grupi bën gjykime për të parë nëse ka ndonjë të dhënë të vërtetueshme që tregon se ka një rënie të matshme në flukset monetare të ardhshme të pritshme nga një portofol kredish para se rënia të mund të identifikohet me një kredi individuale në këtë portofol.

Kjo evidencë mund të përfshijë të dhënat e vërtetueshme që tregojnë se ka pasur një ndryshim negativ në statusin e pagesave të huamarrësve në një bankë, ose kushtet kombëtare ose lokale ekonomike që lidhen me mosshlyerjen e huave nga huamarrësit.

Huatë të zhvlerësuara individualisht janë ato për të cilat ekziston një evidence objektive zhvlerësimi si:

- Huatë me më shumë se 45 ditëvonesa;
- Huatë e ristrukturuara (duke përjashtuar huatë e ristrukturuara në kategorinë standarde dhe në ndjekje);
- Huatë e biznesit me vlerësim B- dhe me poshtë;
- Huatë hipotekare me pike krediti 7 ose pa pikë;
- Huatë që kanë kolaterale të përbashkëta me huatë të zhvlerësuara individualisht;
- Aktiviteti i huamarrësit ka falimentuar.

Në llogaritjen e zhvlerësimit individual të huave merren në konsideratë faktorët e mëposhtëm: Shuma e kredive sipas standardeve IFRS; koha e ekzekutimit; norma e interesit; kolaterale të garantojnë huatë; kostoja e ekzekutimit të kolateraleve. Huatë që nuk janë të zhvlerësuara individualisht dhe huatë që gjatë vlerësimit nuk rezultojnë të kenë evidencë për zhvlerësim, vlerësohen në grup. Huatë të zhvlerësuara në grup janë ato hua që nuk kanë të dhëna objektive që do të ulen në vlerësim, dhe ato të vlerësuara individualisht por që nuk zhvlerësohen individualisht. Në zhvlerësimin në grup përfshihen dhe huatë mikro dhe konsumatore për individët, të cilat zhvlerësohen nëpërmjet matricave tranzitore.

Zhvlerësimi në grup llogaritet në bazë të probabilitetit të humbjes për çdo sektor ekonomik. Probabiliteti i humbjes rishikohet çdo vit. Për çdo degë të industrisë koeficienti i humbjes së pritshme llogaritet shuma totale e vlerave të aprovuar historike për secilën degë të industrisë ndaj shumave të ekspozimit të humbur dhe kredive të fshira.

Banka Credins sh.a.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(shuma në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

2 Politikat Kontabël (vazhdim)

2.3 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve (vazhdim)

(III) Zhvlerësimi i investimeve në letra me vlerë të vlefshme për shitje

Grupi shqyrton letrat e saj të borxhit të klasifikuara si investime në letra me vlerë të vlefshme për shitje në çdo datë të pasqyrave financiare për të vlerësuar nëse ato janë zhvlerësuar. Kjo kërkon gjykim të ngjashëm si ai i përdorur për vlerësimin individual të huave dhe paradhënieve.

Grupi regjistron humbje nga zhvlerësimi i instrumentave të kapitalit të vlefshme për shitje kur ka pasur një rënie të konsiderueshme ose të zgjatur të vlerës së tyre të drejtë nën kosto. Përcaktimi i asaj që është "i rëndësishëm" apo "i zgjatur" kërkon gjykim. Në marrjen e këtij vendimi, Grupi vlerëson, përveç faktorëve të tjerë, lëvizjet historike në çmimin e aksionit dhe kohëzgjatjen, si dhe masën në të cilën vlera e drejtë e një investim është më e ulët se kostoja e tij.

2.4 Ndryshimet në politikat kontabël dhe informacionet shpjeguese

2.4.1 Standarde dhe interpretime e ndryshuara dhe të reja

Grupi ka aplikuar për herë të parë disa standarde dhe ndryshime, të cilat janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2016. Grupi nuk ka aplikuar më herët ndonjë standart, interpretim apo ndryshim që është i publikuar por jo efektiv.

Natyra dhe efektet e këtyre ndryshimeve janë përshkruar më poshtë. Pavarësisht se këto standarde aplikohen për herë të parë në 2016, nuk kane pasur efekte në pasqyrat financiare të Grupit për këtë periudhë. Natyra dhe ndikimi i secilit standart përshkruhet më poshtë:

- **SNRF 14 – Llogaritë e shtyra për arsye rregullatore**

SNRF 14 është një standard opsional që lejon një entitet, aktivitetet e të cilit janë subjekt i rregullimit të normës, që të vazhdojë të aplikojë pjesën dërrmuese të politikave kontabël të tij për llogaritë e shtyra për arsye rregullatore në adoptimin për herë të parë të tij të SNRF-ve. Entitetet që adoptojnë SNRF 14 duhet të paraqesin llogaritë e shtyra për arsye rregullatore si zë më vete në pasqyrën e pozicionit financiar dhe të paraqesin lëvizjet në këto llogari si zë më vete në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve apo pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse. Standardi kërkon shpalosje të natyrës dhe të rrisqeve të lidhura me rregullimin e normës së entitetit dhe efektin e këtij rregullimi në pasqyrat financiare të tij. Duke qenë se Grupi nuk aplikon SNRF-në për herë të parë, dhe nuk është e angazhuar në aktivitete të rregulluara të qeverisë, ky standart nuk është i aplikueshëm.

- **Ndryshime të SNRF 11 – Marrëveshjet e përbashkëta: Kontabilizimi i blerjes së interesave**

Ndryshimi në SNRF 11 kërkon që një operator i përbashkët që kërkon të kontabilizojë blerjen e interesit në një sipërmarrje të përbashkët në të cilin aktiviteti i operacionit të përbashkët përbën një biznes për kontabilizimin e kombinimit të biznesit duhet të aplikojë parimet e SNRF 3 – *Kombinimi i Bizneseve*. Ndryshimi sqaron gjithashtu se një interes i mëparshëm në një operacion të përbashkët nuk ri-matet në blerjen e një interesi të ri në të njëjtin operacion të përbashkët nëse mbahet kontrolli i përbashkët. Si vazhdim, një përjashtim nga qëllimi i shtohet SNRF 11 për të sqaruar që ndryshimet nuk aplikohen kur palët ndajnë kontroll të përbashkët, duke përfshirë dhe Shoqërinë raportuese, janë nën kontrollin përfundimtar të të njëjtës Shoqërie kontrolluese. Ndryshimet aplikohen si për blerjen fillestare të një interesi në një pjesmarrje të përbashkët, si edhe për çdo blerje të mëvonshme interesi, si dhe aplikohen në mënyrë prospektive. Këto ndryshime nuk kanë ndonjë ndikim për Grupin pasi nuk është i përfshirë në ndonjë operacion të përbashkët gjatë kësaj periudhe.

- **Ndryshimet në SNK 16 dhe SNK 38: Qartësimi i metodave të pranueshme të zhvlerësimit**

Ky ndryshim sqaron parimin e SNK 16 *Aktive Afatgjata Materiale* dhe SNK 38 *Aktivitet Jo-materiale*, ku të ardhurat pasqyrojnë një model të përfitimeve ekonomike që janë të gjeneruara nga veprimtaria e një biznesi (ku aktivi bën pjesë) në vend të përfitimeve ekonomike që konsumohen përmes përdorimit të aktivitetit. Si rezultat, raporti i të ardhurave i krijuar mbi të ardhurat e përgjithshme të pritshme për t'u gjeneruar nuk mund të përdoret për të zhvlerësuar aktivitet afatgjatë materiale, por mund të përdoret vetëm në raste shumë të rralla për të amortizuar aktivitet jo-materiale. Ndryshimi aplikohet në mënyrë prospektive. Grupi nuk përdor normat e të ardhurave për qëllime të amortizimit dhe ka vlerësuar se adoptimi i këtij amendimi nuk do të ketë ndikim në pasqyrat e tij financiare.

Banka Credins sh.a.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(shuma në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

2 Politikat Kontabël (vazhdim)

2.4 Ndryshimet në politikat kontabël dhe infomacionet shpjguese (vazhdim)

2.4.1 Standarde dhe interpretime e ndryshuara dhe të reja (vazhdim)

- **Ndryshime në SNRF 27: Metoda e kapitalit në pasqyrat financiare individuale**

Këto ndryshime lejojnë entitetin të përdorë metodën e kapitalit për të kontabilizuar investimet në filiale, pjesëmarrje të përbashkëta dhe pjesëmarrjet në pasqyrat financiare individuale. Entitetet që aplikojnë momentalisht SNRF-në dhe kërkojnë të ndryshojnë në metodën e kapitalit në pasqyrat e tyre individuale duhet ta aplikojnë këtë ndryshim në mënyrë retrospektive. Këto ndryshime nuk kanë ndonjë ndikim në pasqyrat financiare të Grupit, pasi ai aplikon momentalisht metodën e kapitalit.

Përmirësime vjetore të SNRF-ve, Cikli 2012-2014

Këto përmirësime përfshijnë:

- **SNRF 5 – Aktivët afatgjatë të mbajtura për shitje dhe operacionet jo të vijeshme**

Aktivët (ose Shoqëritë për t'u nxjerrë në shitje) përgjithësisht nxirren nga librat kontabël ose nëpërmjet shitjes së tyre ose shpërndarjes së tyre tek pronarët. Ndryshimi sqaron se kalimi nga një plan nxjerrje jashtë tek tjetri nuk konsiderohet një plan i ri nxjerrje jashtë librave kontabël, por një vazhdim i planit ekzistues. Në këtë kuptim nuk ka ndërprerje të aplikimit të kërkesave të SNRF 5. Ky ndryshim aplikohet në mënyrë prospektive.

- **SNRF 7 – Instrumentat financiarë: Shënimet shpjguese**

(i) *Kontratat e shërbimit*

Ky ndryshim sqaron se kontratat e shërbimit që përfshijnë tarifa mund të përfaqësojnë përfshirje të vazhdueshme në një aktiv financiar. Entiteti duhet të vlerësojë natyrën e tarifës dhe angazhimit, përkundërt orientimit të përfshirjes së vazhdueshme në SNRF 7 me qëllim që të vlerësohet nëse janë të nevojshme shënimet shpjguese. Vlerësimi për të cilin kontrata e shërbimit përfaqëson një përfshirje të vazhdueshme duhet të bëhet në mënyrë retrospektive. Sidoqoftë, shënimet shpjguese nuk është e nevojshme të jepen për periudhat të cilat fillojnë përpara vitit në të cilin entiteti aplikon për herë të parë ndryshimet.

(ii) *Aplikueshmeria e ndryshimeve të SNRF 7 për pasqyrat financiare të ndërmjetme të përmbledhura*

Ndryshimi sqaron se kërkesat për shënimet shpjguese për netimin, nuk aplikohen për pasqyrat financiare të ndërmjetme të përmbledhura, përveç rasteve kur shënimet shpjguese japin një informacion të rëndësishëm në lidhje me informacionin e raportuar në raportin më të fundit vjetor. Ky ndryshim aplikohet në mënyrë retrospektive. Këto ndryshime nuk kanë ndonjë ndikim në pasqyrat financiare të Grupit

- **SNK 19 – Përfitimet e punonjësve**

Ndryshimi sqaron që thellësia e tregut e obligacioneve të korporatave me cilesi të lartë vlerësohet bazuar në monedhën në të cilën është obligacioni, më shumë sesa nga shteti ku ndodhet ky obligacion. Kur nuk ka një treg aktiv për obligacione të korporatave me cilësi të lartë në atë monedhë, duhet të përdoren obligacionet qeveritare. Ky ndryshim aplikohet në mënyrë prospektive.

- **SNK 34 – Raportimi financiar i ndërmjetëm**

Ndryshimi sqaron se shënimet shpjguese të ndërmjetme duhet ose të jenë në pasqyrat financiare të ndërmjetme ose të përfshihen nëpërmjet kryqëzimit të informacionit ndërmjet pasqyrave financiare të ndërmjetme dhe cdo vendi tjetër në të cilën ato janë përfshirë në raportin financiar të ndërmjetëm (p.sh., në raportin e riskut apo raportin e manaxhimit). Informacioni tjetër në raportin financiar të ndërmjetëm duhet të jetë në dispozicion të përdoruesve me të njëjtat kushte si dhe pasqyrat financiare të ndërmjetme si dhe në të njëjtën kohë. Ky ndryshim aplikohet në mënyrë retrospektive. Këto ndryshime nuk kanë ndikim për Grupin.

- **Ndryshimet në SNK 1 – Paraqitja e shënimeve shpjguese**

Ndryshimet në SNK 1 sqarojnë sesa ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme kërkesat ekzistuese të SNK 1. Ndryshimet qartësojnë:

- materialitetin sipas kërkesave të SNK 1
- rreshtat specifik në të cilat mund të ndahet pasqyra e fitim, humbjeve dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse dhe pasqyrën e pozicionit financiar

Banka Credins sh.a.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(shuma në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

2 Politikat Kontabël (vazhdim)

2.4 Ndryshimet në politikat kontabël dhe infomacionet shpjguese (vazhdim)

2.4.1. Standarde dhe interpretime e ndryshuara dhe të reja (vazhdim)

Përmirësime vjetore të SNRF-ve, Cikli 2012-2014 (vazhdim)

- **Ndryshimet në SNK 1 – Paraqitja e shënimeve shpjguese (vazhdim)**

- se subjektet kanë fleksibilitet për sa i përket rendit në të cilën ata paraqesin shënime për pasqyrat financiare
- se pjesa e të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse të pjesëmarrjeve dhe sipërmarrjeve të përbashkëta të kontabilizuar duke përdorur metodën e kapitalit neto duhet të paraqiten si një zë në total, dhe të klasifikuar mes atyre artikujve që do apo nuk do të jenë më pas të riklasifikuar në fitim ose humbje

Për më tepër, ndryshimet qartësojnë kërkesat që zbatohen kur nëntotale shtesë janë paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar dhe deklaratën / deklaratat e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera. Këto ndryshime janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2016, me miratimin e hershme të lejuar. Këto ndryshime nuk pritet të ketë ndonjë ndikim për Grupin.

- **Ndryshime ne SNRF 10, SNRF 12 dhe SNK 28 Entitetet Investuese: Aplikimi per shmangie nga konsolidimi**

Ndryshimet adresojnë çështje të cilat janë ngritur në aplikimin e shmangies së Shoqërive investuese sipas SNRF 10 *Pasqyrat Financiare të Konsoliduara*. Ndryshimet në SNRF 10 sqarojnë se shmangia nga prezantimi i pasqyrave financiare të konsoliduara është i aplikueshëm për një Shoqëri Mëmë e cila është filial i një entiteti investues, kur entiteti investues mat të gjithë filialet e saj me vlerë të drejtë.

Për më tepër, ndryshimi në SNRF 10 sqaron se vetëm një filial i një entiteti investues që nuk është në vetvete një entitet investues dhe që jep shërbime mbështetese entitetit investues konsolidohet. Të gjithë filialet e tjerë të entitetit investues maten me vlerë të drejtë. Ndryshimet në SNK 28 *Investimet në Pjesëmarrje dhe Sipërmarrjet e Përbashkëta* lejojnë investitorin, kur aplikohet metoda e kapitalit, të mbajë vlerën e drejtë të aplikuar nga entiteti investues për interesin e tij në filiale. Këto ndryshime aplikohen në mënyrë retrospective dhe nuk kanë ndikim për Grupin pasi Grupi nuk përdor shmangien nga konsolidimi.

2.4.2 Standarde dhe interpretime të publikuara, që nuk janë akoma në fuqi dhe as të aplikuara

Standartet dhe interpretimet që janë publikuar, por që nuk janë ende në fuqi, në datën e publikimit të pasqyrave financiare të Grupit jepen si me poshtë. Grupi ka si qëllim aplikimin e tyre, nëse është e mundur, kur ato të jenë efektive.

- **SNRF 9 – Instrumentat financiare**

Në korrik 2014 BSNK nxori versionin përfundimtar të SNRF 9 *Instrumentat financiare* që zëvendëson SNK 39 *Instrumentet financiare: Njohja dhe Matja* dhe të gjithë versionet e mëparshme të SNRF 9. Standardi prezanton kërkesa të reja për klasifikimin dhe matjen, zhvlerësimin dhe kontabilitetin. Standardi aplikohet për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2018, por lejohet adoptimi i hershëm. Përveç kontabilitetit mbrojtës, aplikimi retrospektiv është i nevojshëm përveç kur informacioni krahasues nuk është i domosdoshëm. Për kontabilitetin mbrojtës, kërkesat aplikohen në mënyrë prospective, me disa përjashtime të kufizuara. Grupi planifikon të adoptojë standartin e ri në datën kur ky bëhet efektiv. Gjatë vitit 2017 Grupi do të vlerësojë impaktin e aplikimit të këtij standarti në pasqyrat financiare.

(a) Klasifikimi dhe matja

Grupi nuk pret ndonjë ndikim të rëndësishëm në bilancin kontabël të tij ose në kapital për përdorimin e kërkesave të SNRF 9 për klasifikimin dhe matjen. Grupi pret të vazhdojë të përdorë matjen me vlerën e drejtë të të gjitha aktiveve financiare të cilat mbahen momentalisht me vlerë të drejtë. Rezerva e letrave me vlerë të vlefshme për shitje e cila paraqitet aktualisht si Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse të akumuluar do të riklasifikohet në balancën e celjes së fitimit të pashpërndarë. Detyrimet në letra me vlerë priten të maten me vlerën e drejtë në të ardhurat gjithëpërfshirëse nën SNRF 9, sepse Grupi pret që jo vetëm të mbajë aktivet për të mbledhur flukset monetare kontraktuale, por gjithashtu të shesë një sasi të konsiderueshme shpesh. Kapitali i mbajtur në kompani jo të listuara do të vazhdojnë të mbahen në të ardhmen e afërt.

Banka Credins sh.a.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(shuma në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

2 Politikat Kontabël (vazhdim)

2.4 Ndryshimet në politikat kontabël dhe shpjegimet (vazhdim)

2.4.2 Standarde dhe interpretime të publikuara, që nuk janë akoma në fuqi dhe as të aplikuara (vazhdim)

- **SNRF 9 – Instrumentat financiare (vazhdim)**

- (a) **Klasifikimi dhe matja (vazhdim)**

Grupi pret të aplikojë mundësinë të prezantojë ndryshimet në vlerë të drejtë të të ardhurave gjithëpërfshirëse, dhe për këtë arsye mendon se aplikimi i SNRF 9 nuk do të ketë ndikim të rëndësishëm. Nëse Grupi nuk do të aplikonte këtë mundësi, kapitali do të mbahej në vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit dhe humbjes, që do të rriste ndryshueshmërinë e humbjes apo fitimit të regjistruar.

Huatë dhe llogaritë e arkëtueshme mbahen për të mbledhur mjete monetare të kontraktuara dhe pritet të japin mjete monetare që përfaqësojnë vetëm pagesa principali dhe interesi. Grupi pret që këto do vazhdojnë të maten me kosto të amortizuar sipas SNRF 9. Megjithatë Grupi do vazhdojë të masë efektin dhe karakteristikat e këtyre instrumentave sipas SNRF 9 në më shumë detaje përpara se të vendosë nëse të gjithë këto instrumenta plotësojnë kriteret për matje me kosto të amortizuar.

- (b) **Rënia në vlerë**

SNRF 9 kërkon që Grupi të regjistrojë humbjet e pritshme në të gjitha investimet e saj, huatë dhe llogaritë e arkëtueshme, ose për 12 muaj ose për gjatë gjithë jetëgjatësisë. Grupi pret të përdorë mënyrën e thjeshtuar dhe të regjistrojë humbjet e pritshme për gjithë jetëgjatësinë e llogarive të arkëtueshme. Grupi pret një ndikim më të rëndësishëm në kapitalin e saj përse i përket huave dhe llogarive të arkëtueshme për shkak të natyrës së pasiguruar të tyre, por duhet të bëjë një analizë më të hollësishme që do konsiderojë të gjithë informacionin e mundshëm dhe mbështetës, duke përfshirë elemente të ardhshëm për të përcaktuar madhësinë e ndikimit.

- (c) **Kontabiliteti mbrojtës**

Grupi beson se të gjitha marrëdhëniet e kontabilitetit mbrojtës të cilat përdoren për kontabilitet mbrojtës do të vazhdojnë të konsiderohen për kontabilitet mbrojtës edhe nën SNRF 9. SNRF 9 nuk ndryshon parimet e përgjithshme sipas të cilave një entitet kontabilizon mbrojtjen efektive. Grupi nuk pret të ketë ndonjë ndikim të rëndësishëm si rezultat i përdorimit të SNRF 9. Grupi do të vlerësojë të gjitha ndryshimet e mundshme për kontabilizimin e vlerës së derivativave, ose shtrirjes së bazës së monedhës së përdorur.

- **SNRF 15 - Të ardhurat nga Kontratat me Klientët**

Në maj 2014, BSNK nxori SNK 15 – Të ardhurat nga kontratat me klientët. Standardi është efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2018 dhe aplikimi më i hershëm i tij është i lejuar. SNRF 15 përcakton parimet për të njohur të ardhurat dhe do jetë i aplikueshëm për të gjitha kontratat me klientët. Megjithatë, interesi dhe e ardhura nga tarifat e lidhur me instrumentat financiare dhe qiratë nuk do të jenë subjekt i këtij standardi dhe do rregullohen nga standarte të tjera të aplikueshëm (p.sh. SNRF 9, dhe SNRF 16 Qiratë).

Të ardhurat sipas SNRF 15 do të njihen në kohën që transferohen mallrat dhe shërbimet, deri në masën që transferuesi mbart rreziqet për mallrat dhe shërbimet. Dhënia e gjerë e informacioneve shpjeguese do të jetë e nevojshme, përfshirë ndarjen e të ardhurave totale, informacionin rreth detyrimeve të performancës, ndryshimet në ekuilibrat e llogaritjeve të aktiveve dhe detyrimeve të kontratës ndërmjet periudhave, gjykimeve dhe preventivave kryesore.

Grupi nuk synon të aplikojë këtë standard përpara hyrjes së tij në fuqi dhe po vlerëson impaktin e tij.

- **SNRF 16 - Qiratë**

BSNK publikoi standardin e ri për kontabilizimin e qirave - SNRF 16 Qiratë në janar 2016. Standardi i ri nuk ndryshon shumë kontabilizimin e qirave nga qiradhënësit. Megjithatë, kërkon që qiramarrësit të njohin në bilancin e tyre kontabël të gjitha qiratë si detyrime për aktivet korresponduese me të drejta përdorimi. Qiramarrësit duhet të përdorin një model të vetëm për njohjen e të gjitha qirave, por do të kenë opsionin të mos njohin qiratë afatshkurtra ose qiratë për aktive me vlera të vogla. Në përgjithësi, modeli i njohjes do jete i ngjashëm me atë që përdoret aktualisht për kontabilizimin e qirave financiare, me interesin dhe shpenzimin e amortizimit të njohur në zëra të vecantë të pasqyres së fitimit ose humbjes.

Banka Credins sh.a.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(shuma në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

2 Politikat Kontabël (vazhdim)

2.4 Ndryshimet në politikat kontabël dhe shpjegimet (vazhdim)

2.4.2 Standarde dhe interpretime të publikuara, që nuk janë akoma në fuqi dhe as të aplikuara (vazhdim)

- **SNRF 16 – Qiratë (vazhdim)**

SNRF 16 hyn në fuqi për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janar 2019. Aplikimi më heret është i lejuar nëse standardi i ri i të ardhurave, SNRF 15 aplikohet në të njëjtën datë. Qiramarrësit duhet të adoptojnë SNRF 16 duke përdorur ose metodën e plotë retrospektive ose metodën e modifikuar retrospektive.

Grupi nuk synon të aplikojë këtë standard përpara hyrjes së tij në fuqi dhe po vlerëson ndikimin e tij.

- **SNK 7 – Iniciativa për shënimet shpjeguese (ndryshimet)**

Në janar 2016 BSNK publikoi ndryshime në SNK 7 Pasqyren e fluksit të mjeteve monetare me qëllimin e përmirësimit të shënimeve shpjeguese për aktivitetet financiare dhe të ndihmojë përdoruesit për të kuptuar më mirë pozicionin likuiditetit të entitetit raportues. Sipas kërkesave të reja, entitetet do të duhet të paraqesin shënime shpjeguese për ndryshimet në detyrimet financiare si rrjedhojë e aktiviteteve financiare të tilla si ndryshimet në zërat monetare dhe jo-monetare (p.sh. humbjet dhe fitimet nga levizja e kurseve të këmbimit). Ndryshimi hyn në fuqi më 1 janar 2017.

Grupi po vlerëson ndikimin e këtij standarti.

2.5 Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël

Gjatë hartimit të pasqyrave financiare të konsoliduara, transaksionet në monedha të ndryshme nga monedha funksionale e Grupit, janë njohur duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit.

(1) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj përkthehen në monedhën funksionale të veprimtarisë me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Në çdo datë raportimi, aktivet dhe detyrimet monetare të shprehura në monedhë të huaj rivekëtohen në Lek me kursin në datën e raportimit. Fitimi ose humbja nga ndryshimi i kurseve të këmbimit është diferenca midis kostos së amortizuar në monedhën funksionale në fillim të periudhës të rregulluara me interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës, dhe kostos së amortizuar në monedhë të huaj të kthyer në monedhën funksionale me kursin e fundvitit. Aktivet dhe detyrimet jo monetare maten në kosto historike të monedhave të huaja dhe këmben me kursin e këmbimit në datën e transaksionit.

Kurset e këmbimit të aplikueshme (Lek ndaj një njësie të monedhës së huaj) për monedhat kryesore më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
USD	128.17	125.79
EUR	135.23	137.28
GBP	157.56	186.59
CHF	126.05	126.74
CAD	95.09	90.53
XAU	4,778.96	4,294.71

(2) Instrumentat financiarë – njohja fillestare dhe matja vijuese

(i) Data e njohjes

Të gjitha aktivet dhe detyrimet financiare janë njohur fillimisht në datën kur Grupi bëhet palë e dispozitave kontraktuale të instrumentit.

(ii) Matja fillestare e instrumentave financiarë

Grupi fillimisht njeh huatë dhe paradhëniet, depozitat, letrat me vlerë të borxhit të emetuar dhe detyrimet e varura në datën kur ato janë krijuar. Blerjet dhe shitjet e rregullta të aktiveve financiare njihen në datën e tregtimit kur Grupi angazhohet për blerjen ose shitjen e aktivitetit. Të gjitha aktivet dhe detyrimet e tjera financiare (përfshirë aktivet dhe detyrimet që maten me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes) njihen fillimisht në datën e tregtimit në të cilën Grupi bëhet palë për respektimin e dispozitave kontraktuale të instrumentit.

Banka Credins sh.a.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(shuma në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

2 Politikat Kontabël (vazhdim)

2.5 Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(2) Instrumentat financiarë – njohja fillestare dhe matja vijuese (vazhdim)

(ii) Matja fillestare e instrumentave financiarë (vazhdim)

Një aktiv ose detyrim financiar matet fillimisht me vlerën e drejtë. Kostot e transaksionit të cilat i atribuohen direkt blerjes së tij ose emetimit të aktiveve apo detyrimeve financiare (për një zë i cili nuk matet me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes) i shtohen ose zbriten vlerës së drejtë të aktiveve apo detyrimeve financiare, sipas rastit, në njohjen fillestare. Kostot e transaksionit që i atribuohen në mënyrë direkte blerjes së aktiveve apo detyrimeve financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes njihen menjëherë në fitim ose humbje.

(iii) Klasifikimi i aktiveve financiare

Aktivët financiarë klasifikohen në kategoritë e mëposhtme të specifikuara:

- Mjetet monetare dhe ekuivalente me to
- Hua dhe paradhënie për klientët dhe për bankat
- Investimet e letrave me vlerë

Klasifikimi varet nga natyra dhe qëllimi i aktiveve financiare dhe përcaktohet gjatë njohjes fillestare. Të gjitha blerjet në mënyrë të rregullt ose shitjet e aktiveve financiare njihen dhe çregjistrohen mbi bazën e datës së tregtimit. Blerjet ose shitjet e rregullta janë blerjet ose shitjet e aktiveve financiare që kërkojnë shpërndarjen e aktiveve brenda afateve kohore të përcaktuara në rregulloret ose konventat në treg.

(iv) Klasifikimi i detyrimeve financiare dhe kapitalit

Klasifikimi si borxh ose kapital

Instrumentat e borxhit dhe kapitalit të emetuar nga Grupi janë klasifikuar ose si detyrime financiare ose si kapital i vetë në përputhje me thelbin e marrëveshjeve kontraktuale dhe përkufizimeve të detyrimit financiar dhe instrumentave të kapitalit.

Instrumentat e kapitalit

Një instrument kapitali është çdo kontratë që evidenton një interes të mbetur në aktivet e Grupit pas zbritjes së të gjitha detyrimeve të saj. Instrumentat e kapitalit neto të emetuara nga Grupi janë të njohura për shumën e arkëtuar, neto nga kostot direkte të emetimit.

(v) Hua dhe paradhënie klientëve dhe bankave

Hua dhe paradhënie për klientët dhe për bankat përfshijnë aktive financiare jo-derivative me pagesa fikse ose të përcaktueshme që nuk janë të kuotuar në një treg aktiv, dhe që Grupi nuk ka ndërmend t'i shesë menjëherë ose në të ardhmen e afërt, përveç:

- Atyre që Grupi ka për qëllim t'i shesë menjëherë ose në të ardhmen e afërt dhe atyre që Grupi gjatë njohjes fillestare i përcakton si me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes;
- Atyre që Grupi, gjatë njohjes fillestare, i përcakton si të vlefshme për shitje.

Kur Grupi është qiradhënës në një marrëveshje qiraje që transferon te qiramarrësit të gjitha rreziqet dhe shpërblimet që lidhen me pronësisë e një aktivi, marrëveshja paraqitet brenda huave dhe paradhënieve.

Kur Grupi blen një aktiv financiar dhe njëkohësisht hyn në një marrëveshje për të rishitur aktivin (ose një pasuri tërësisht e ngjashme) me një çmim të fiksuar në një datë të ardhshme ("marrëveshje riblerje të anasjellta ose huamarrje letrash me vlerë"), marrëveshja është kontabilizuar si marrëveshje e anasjelltë riblerjeje (letra me vlerë kolateralizuara) dhe aktivet e lidhura me to nuk njihen në pasqyrat financiare të konsoliduara të Grupit. Pas matjes fillestare me vlerën e drejtë, shumat e huave dhe paradhënieve për klientët dhe bankat janë matur më pas me koston e amortizuar duke përdorur metodën e normës efektive të interesit.

(vi) Investime në letra me vlerë

Investime në letra me vlerë kontabilizohen në varësi të klasifikimit të tyre, ose si të mbajtura deri në maturim, me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes, ose të vlefshme për shitje.

Banka Credins sh.a.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(shuma në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

2 Politikat Kontabël (vazhdim)

2.5 Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(vi) Letrat me vlerë të investimit (vazhdim)

(a) Instrumenta financiarë të mbajtur deri në maturim

Investimet e mbajtura deri në maturim janë aktive jo-derivative me pagesa fikse ose të përcaktuara dhe maturitet fiks të cilat Grupi ka qëllimin dhe mundësinë t'i mbajë deri në maturim dhe të cilat nuk janë dizenuar me vlerë të drejtë në fitim ose humbje ose të vlefshme për shitje. Pas njohjes fillestare, investimet e mbajtura deri në maturim mbarten me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv minus ndonjë zhvlerësim të mundshëm. Nëse Grupi do të shesë ose riklasifikojë para maturimit një shumë të rëndësishme të letrave me vlerë të mbajtura deri në maturim (përveçse në rrethana të caktuara specifike), e tërë kategoria do të "njolloset" dhe do të duhet të riklasifikohet si e vlefshme për shitje. Për më tepër, Grupi do ta kishte të ndaluar klasifikimin e ndonjë aktivi financiar si të mbajtur deri në maturim gjatë dy viteve në vijim.

(b) Instrumentat financiarë të vlefshëm për shitje

Investimet e vlefshme për shitje janë investime jo-derivative që nuk dizenuohen si një kategori tjetër e aktiveve financiare. Investimet e kapitalit të pakuotuar, vlera e drejtë e të cilave nuk mund të matet në mënyrë të besueshme, mbarten me kosto. Të gjitha investimet e vlefshme për shitje mbarten me vlerë të drejtë.

Të ardhurat nga interesi njihen në fitim ose humbje duke përdorur metodën e interesit efektiv. Fitimet ose humbjet nga kursi i këmbimit në investimet në letra me vlerë të vlefshme për shitje, njihen direkt në humbje ose fitim. Ndryshime të tjera të vlerës së drejtë njihen në të ardhurat e tjera gjithpërfshirëse deri kur investimi të jetë shitur ose zhvlerësuar dhe fitimi ose humbja e akumuluar të njihet në fitim ose humbje.

(vii) Borxhi i emetuar dhe fonde të tjera të marra borxh

Instrumentat financiarë të emetuar nga Grupi, që nuk janë përcaktuar me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, janë klasifikuar si "borxhi i varur", ku substanca e marrëveshjes kontraktuale rezulton në atë që Grupi ka një detyrim për t'i shlyer mbajtësit, nëpërmjet mjeteve monetare ose aktiveve të tjera financiare, ose të përmbushë detyrimin nëpërmjet një mënyre tjetër përveçse duke këmbyer një shumë të caktuar parash ose aktive të tjera financiare për një numër fiks aksionesh në kapitalin e vet.

Pas matjes fillestare, borxhi i emetuar dhe huamarrjet e tjera maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e normës efektive të interesit. Një analizë e borxhit të emetuar të Grupit është paraqitur në Shënimin 25.

(3) Mosnjohja (ç'regjistrimi) e aktiveve dhe detyrimeve financiare

(i) Aktivet financiare

Grupi nuk e njeht më një aktiv financiar (e ç'regjistron) nëse të drejtat kontraktuale për përfitimin e parave nga aktivi janë shuar, ose nëse transferohen të drejtat për të marrë përfitimin kontraktual nga aktivi financiar në një transaksion nëpërmjet të cilit transferohen te një njësi tjetër të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë mbi aktivin financiar. Çdo interes në aktivet financiare të transferuara që krijohet ose mbahet nga Grupi njihet si një aktiv ose detyrim më vete. Grupi kryen transaksione nëpërmjet të cilëve transferon aktivet e njohura në pasqyrën e pozicionit financiar, por mban të gjitha ose një pjesë të rreziqeve ose shpërblimeve të aktiveve të transferuara. Në rast se Grupi mbart të gjitha ose në thelb të gjitha rreziqet dhe shpërblimet aktuale ose të mëvonshme, atëherë aktivet e transferuara vazhdojnë të njihen në pasqyrën e pozicionit financiar. Transferimi i aktiveve, ndërkohë që mbahen të gjitha ose në thelb të gjitha rreziqet dhe shpërblimet aktuale ose të mëvonshme, përfshijnë për shembull huadhënien e letrave me vlerë dhe transaksionet e marrëveshjeve të riblerjes.

Kur aktivet i shiten një pale të tretë me një normë totale kthimi "swap" për aktivet e transferuara, transaksioni kontabilizohet si një transaksion financimi i sigurt i njëjtë me transaksionet e riblerjes. Për transaksionet ku Grupi as nuk mban dhe as nuk transferon në mënyrë thelbësore të gjitha rreziqet dhe shpërblimet aktuale ose të mëvonshme që rrjedhin nga pronësia mbi aktivin financiar, ajo nuk e njeht (ç'regjistron) aktivin në rast se nuk ka kontroll mbi të. Të drejtat dhe detyrimet që mbahen gjatë transferimit njihen më vete si aktive dhe detyrime, sipas rasti. Në ato transferime ku ruhet kontrolli mbi aktivin, Grupi vazhdon të njohë aktivin për aq kohë sa ky aktiv rezulton i përfshirë, gjë e cila përcaktohet nga niveli i ekspozimit ndaj ndryshimeve në vlerën e aktivit të transferuar.

Në transaksione të caktuara Grupi mban të drejtat e shërbimit ndaj një aktivi financiar të transferuar kundrejt një tarife. Aktivi i transferuar çregjistrohet tërësisht nëse plotëson kriteret e mosnjohjes.

Banka Credins sh.a.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(shuma në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

2 Politikat Kontabël (vazhdim)

2.5 Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(3) Mosnjohja (ç'regjistrimi) e aktiveve dhe detyrimeve financiare (vazhdim)

(ii) Detyrimet financiare

Grupi çregjistron detyrimet financiare kur, dhe vetëm kur, detyrimet e Grupit janë shkarkuar, anuluar ose kanë skaduar. Diferenca midis vlerës kontabël neto të detyrimit financiar të çregjistruar dhe shumës së paguar dhe të pagueshme njihet në fitim ose humbje.

Një aktiv ose detyrim njihet për të drejtat e shërbimit, në qoftë se tarifa e shërbimit është më e lartë se shpenzimet e shërbimit (aktiv) ose është më pak se e përshtatshme për të kryer shërbimin (detyrim).

(4) Përcaktimi i vlerës së drejtë

Vlera e drejtë është shuma për të cilën një aktiv mund të këmbehet ose një detyrim të shlyhet midis palëve të palidhura me njëra-tjetrën, të mirëinformuara që kryejnë një transaksion në mënyrë të vullnetshme në datën e matjes.

Kur është e mundur, Grupi e mat vlerën e drejtë të një instrumenti duke përdorur çmimet e kuotuar të një tregu aktiv për atë instrument. Një treg konsiderohet aktiv nëse çmimet e kuotuar janë lehtësisht dhe rregullisht të disponueshme dhe paraqesin transaksione të tregut aktual që kryhen në mënyrë të rregullt dhe ne kushte të barabarta. Një teknikë vlerësimi e përdorur nga Grupi për të identifikuar nëse për një instrument financiar ekziston një treg aktiv është ekzistenca e çmimeve të kuotuar për aktive dhe/ose detyrime të ngjashme, të cilat Grupi mund t'i aksesojë në datën e raportimit. Nëse tregu për një instrument financiar nuk është aktiv, Grupi kryen matjen me vlerën e drejtë duke përdorur teknika vlerësimi.

Teknikat e vlerësimit përfshijnë përdorimin e transaksioneve më të fundit të kryera në mënyrë të vullnetshme midis palëve të mire-informuara të palidhura me njëra-tjetrën (nëse është e disponueshme), lidhur me vlerën e drejtë aktuale të instrumentave të tjerë që janë kryesisht të njëjtë, flukset monetare të skontuara dhe modelet e vlerësimit të opsioneve. Teknika e zgjedhur e vlerësimit bazohet maksimalisht te të dhënat e tregut, mbështetet sa më pak të jetë e mundur në llogaritjet specifike të Grupit, bashkon të gjithë faktorët që pjesëmarrësit në treg konsiderojnë në vendosjen e çmimit dhe është në përputhje me metodologjitë ekonomike të pranura për vendosjen e çmimit për instrumentat financiare. Të dhënat për teknikat e vlerësimit paraqesin pritshmërinë e tregut dhe matjet e faktorëve të rreziqeve të trashëguara në instrumentat financiarë.

Grupi kalibron metodat e vlerësimit dhe i teston ato për vlefshmëri duke përdorur çmime të vëzhguara në transaksionet aktuale të tregut në instrumenta të njëjtë ose në të dhëna të tjera të vëzhgueshme në treg. Evidencë më e mirë për vlerën e drejtë të një instrumenti financiar në matjen fillestare është çmimi i transaksionit, p.sh. vlera e drejtë e dhënë ose e marrë, vetëm nëse vlera e drejtë e atij instrumenti është evidentuar nga krahasimi me transaksione aktuale të tregut për instrumenta të njëjtë (p.sh., pa modifikime ose ripaketim) ose e bazuar në metodat e vlerësimit në të cilat variablat përfshijnë vetëm të dhëna të vëzhgueshme në tregje. Kur çmimet e transaksioneve paraqesin evidencën më të mirë të vlerës së drejtë në njohjen fillestare, instrumenti financiar matet fillimisht me çmimin e transaksionit dhe çdo diferencë midis këtij çmimi dhe vlerës fillestare të përfutur nga një model vlerësimi është njohur më pas në fitim ose humbje në një bazë të përshtatshme mbi jetën e instrumentit por jo më vonë se vlerësimi të mbështetet tërësisht nga të dhëna të vëzhgueshme në treg ose transaksioni të mbyllet.

Aktivet dhe pozicionimet afatgjata maten me çmimin e ofruar, detyrimet dhe pozicionimet afatshkurtra maten me çmimin e kërkuar. Kur Grupi ka një pozicionim me rreziqe që kompensojnë njëri tjetrin, çmime "mid-market" përdoren për të matur pozicionin e rreziqeve të kompensuar dhe një çmim i kërkuar ose ofertë rregullimi është aplikuar vetëm tek pozicionet e hapura neto. Vlera e drejtë reflekton rrezikun e kreditimit të instrumentave dhe përfshin rregullime të cilat marrin parasysh rrezikun e kreditimit të Grupit dhe të palës tjetër kur është e përshtatshme. Llogaritjet e vlerës së drejtë të përfutura nga modelet rregullohen për faktorë të tjerë si rreziku i likuiditetit ose pasiguritë e modeleve, në atë masë që Grupi beson që një palë e tretë pjesëmarrëse në treg do i merrte ato në konsideratë për vendosjen e çmimit të një transaksioni.

Grupi e mat vlerën e drejtë duke përdorur hierarkinë e mëposhtme që reflekton rëndësinë e input-eve të përdorura gjatë matjeve:

- Niveli 1: çmimet e kuotuar (te pakorrigjuara) të një tregu aktiv për një instrument identik.
- Niveli 2: Teknika vlerësimi bazuar në input-e të vëzhgueshme, ose në mënyrë direkte (si p.sh çmimet), ose në mënyrë indirekte (që rrjedh nga çmimet).

Banka Credins sh.a.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(shuma në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

2 Politikat Kontabël (vazhdim)

2.5 Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(4) Përcaktimi i vlerës së drejtë (vazhdim)

- Niveli 2 (vazhdim): Kjo kategori përfshin instrumenta të vlerësuar duke përdorur: çmime të kuotuar në tregje aktivë për instrumenta identikë ose të ngjashëm, çmime të kuotuar për instrumenta identikë ose të ngjashëm në tregje që konsiderohen jo aq aktivë; ose teknika të tjera vlerësimi ku gjithë input-et kryesore mund të vëzhgohen në mënyrë direkte ose indirekte nga të dhënat e tregut.
- Niveli 3: Teknika vlerësimi duke përdorur input-e të rëndësishme jo të vëzhgueshme. Kjo kategori përfshin të gjithë instrumentat ku teknika e vlerësimit përfshin input-e që nuk bazohen në të dhëna të vëzhgueshme dhe input-et jo të vëzhgueshme kanë një ndikim të rëndësishëm në vlerësimin e instrumentit. Kjo kategori përfshin instrumenta që vlerësohen mbi bazën e çmimeve të kuotuar për instrumenta të ngjashëm ku kërkohen korrigjime të rëndësishme jo të vëzhgueshme ose supozime për të reflektuar diferencat mes instrumentave.

(5) Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Në çdo datë bilanci Grupi vlerëson nëse ka evidencë objektive që aktivet financiare të ndryshëm nga mjetet monetare dhe ekuivalentët me to, janë zhvlerësuar. Aktivet financiare konsiderohen të zhvlerësuara kur ka evidence që një ngjarje që sjell humbje ka ndodhur pas njohjes fillestare të aktivit, dhe kjo ka një ndikim në flukset e ardhshme të parasë së aktivit, të cilat mund të maten me besueshmëri.

Grupi konsideron mundësinë e zhvlerësimit në nivel individual dhe kolektiv. Të gjithë aktivet financiare individualisht të rëndësishme vlerësohen për zhvlerësim specifik. Të gjithë aktivet e rëndësishme të cilat nuk zhvlerësohen specifikisht vlerësohen kolektivisht për çdo vlerësim që ka lindur por nuk është identifikuar akoma. Aktivet të cilat nuk janë individualisht të rëndësishme vlerësohen duke grupuar bashkë aktivet financiare (të mbartura me kosto të amortizuar) me karakteristika të njëjta rreziku.

Evidencë objektive që aktivet financiare të zhvlerësuara mund të përfshijnë mospagimin ose shkeljet nga huamarrësi, ristrukturimin e kredisë ose paradhëniet nga Grupi me kusht që Grupi nuk do të konsiderojë të dhënat që një huamarrës ose emetues do të falimentojnë, zhdukjen e një tregu aktiv për instrumentat financiarë, ose të dhëna të tjera të vëzhgueshme që lidhen me një grup aktivesh të tilla si ndryshimet negative në statusin e pagesave të huamarrësit ose emetuesve në grup, ose kushte ekonomike që lidhen me dështimin në grup.

Për trajtimin e zhvlerësimit në grup Grupi përdor modelimin statistikor të trendeve historike të probabilitetit të mospagimit, kohës së rikuperimit dhe vlerën e humbjes së ndodhur, përshtatur me gjykimin e drejtimit nëse kushtet aktuale ekonomike dhe të kreditit janë të tilla që humbjet aktuale të jenë më të mëdha ose më të vogla se ato të përcaktuara nga modelimet historike. Probabiliteti i mospagimit, normat e humbjes dhe përcaktimi i kohës së rikuperimit krahasohen me rezultatet aktuale për të siguruar që ato të mbeten të duhurat.

(i) Aktivet financiare me kosto të amortizuar

Humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve të mbajtura me koston e amortizuar maten si diferencë midis vlerës kontabël të aktiveve financiare dhe vlerës aktuale të flukseve të pritshme skontuar me normën fillestare efektive të interesit të aktiveve. Humbjet njihen në fitim ose humbje dhe pasqyrohen në një llogari provigjoni kundrejt huave dhe paradhënies. Interesi mbi aktivet e zhvlerësuara vazhdon të njihet përmes rikthimit të zbritjes. Kur një ngjarje e mëvonshme bën që shumën e humbjes nga zhvlerësimi të ulet, humbja nga zhvlerësimi kthehet (njihet) nëpërmjet fitimit ose humbjes.

(ii) Instrumentat financiarë të vlefshëm për shitje

Për instrumentat financiarë të vlefshëm për shitje, Grupi vlerëson në çdo datë të pasqyrave financiare nëse ka evidencë objektive që një investim është zhvlerësuar.

Humbjet nga zhvlerësimi i letrave me vlerë të vlefshme për shitje njihen duke transferuar përmes një riklasifikimi, humbjen kumulative që është njohur në të ardhurat e tjera përmbledhëse, në fitim ose humbje. Humbja kumulative që është riklasifikuar nga të ardhura të tjera, në fitim ose humbje, është diferenca midis kostos së blerjes, neto nga çdo shlyerje principali dhe amortizimi, dhe vlerës së drejtë aktuale, minus ndonjë humbje nga zhvlerësimi e njohur më parë në fitim ose humbje. Ndryshimet në provigjonet për zhvlerësim që i atribuohen vlerës në kohë janë pasqyruar si një komponent i të ardhurave nga interesi.

Banka Credins sh.a.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(shuma në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

2 Politikat Kontabël (vazhdim)

2.5 Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(5) Zhvlerësimi i aktiveve financiare (vazhdim)

(ii) Instrumentat financiarë të vlefshëm për shitje (vazhdim)

Nëse në një periudhë të mëvonshme vlera e drejtë e një letre me vlerë të vlefshme për shitje që është zhvlerësuar rritet, dhe rritja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje që ka ndodhur pasi humbja nga zhvlerësimi është njohur në fitim ose humbje, humbja nga zhvlerësimi kthehet (rimerret), dhe shuma e kthimit njihet në fitim ose humbje. Megjithatë, çdo rritje e mëvonshme në vlerën e drejtë të një letre me vlerë të zhvlerësuar të kapitalit njihet në të ardhura të tjera përmbledhëse.

(iii) Kreditë e rinegociuara

Kur është e mundur, Grupi kërkon të ristrukturojë kreditë në vend që të marrë në zotërim kolateralet. Kjo mund të përfshijë shtrirjen e afatit të pagesave dhe rënien dakord për kushte të reja të kredisë. Pasi kushtet janë rinegociuar, ndonjë zhvlerësim i mundshëm matet duke përdorur normën fillestare efektive të interesit, të llogaritur para modifikimit të termave dhe kredia nuk konsiderohet më me vonesë. Drejtimi vazhdimisht rishikon kreditë e rinegociuara për t'u siguruar që të gjitha kriteret janë përmbushur dhe se pagesat e ardhshme ka të ngjarë të ndodhin. Kreditë vazhdojnë të jenë subjekt i një vlerësimi individual apo kolektiv nga zhvlerësimi, i llogaritur duke përdorur normën fillestare efektive të interesit të kredisë.

(6) Kompensimi i instrumentave financiarë

Aktivët dhe detyrimet financiare kompensohen me njëra-tjetrën dhe shuma neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar atëherë, dhe vetëm atëherë, kur Grupi ka të drejtën ligjore për të kompensuar këto shuma dhe ka si qëllim ose t'i shlyejë neto, ose të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht.

Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten në bazë neto vetëm atëherë kur lejohet nga standardet kontabël, ose për fitimet dhe humbjet e krijuara nga një grup transaksionesh të ngjashme si ato në aktivitetin tregtar të Grupit.

(7) Matja me kosto të amortizuar e instrumentave financiarë

Kostoja e amortizuar e një aktivi ose detyrimi financiar është vlera me të cilën aktivi ose detyrimi njihet në momentin fillestar duke i zbritur pagesat e principalit, plus ose minus amortizimin e akumuluar duke përdorur metodën e interesit efektiv për çdo diferencë ndërmjet vlerës fillestare të njohur dhe vlerës në maturitet, minus çdo zbritje për efekt zhvlerësimi.

(8) Qiratë financiare

Përcaktimi nëse një marrëveshje është qira, ose ajo përmban një qira, bazohet në thelbin e marrëveshjes dhe kërkon një vlerësim nëse përmbushja e marrëveshjes varet nga përdorimi i një aktivi ose aktiveve specifike dhe marrëveshja mbart të drejtën për të përdorur aktivin.

Grupi si një qiramarrës

Qiratë që nuk transferojnë te Grupi në mënyrë thelbësore të gjitha rreziqet dhe përfitimet e lidhura me pronësinë e sendeve me qira janë qira operationale. Pagesat e qirasë operationale njihen si shpenzime në pasqyrën e të ardhurave mbi një bazë lineare gjatë afatit të qirasë ("leasing"). Qiratë e pagueshme njihen si një shpenzim në periudhën në të cilën ato ndodhin.

Grupi si një qiradhënës

Qiratë ku Grupi transferon rrezikun dhe përfitimet e pronësisë së aktivit klasifikohen si qira financiare. Në pasqyrën e gjendjes financiare, Grupi paraqet në pasqyrën e pozicionit financiar shumën e arkëtueshme të barabartë me vlerën neto të investimit. Njohja e të ardhurave financiare do të bazohet në një model që pasqyron një normë konstante periodike të kthimit të investimit neto të qiradhënësit mbi qiranë financiare. Pagesat e qirasë që lidhen me periudhën, me përjashtim të shpenzimeve për shërbime, i janë zbritur investimit bruto në qira për të reduktuar si principalin (kryegjënë), ashtu edhe të ardhurat financiare të pafituara.

Të ardhurat nga shitja të njohura nga prodhuesi ose tregtari qiradhënës në fillim të afatit të qerasë financiare janë vlera e drejtë e aktivit, ose, nëse më e ulët, vlera aktuale e pagesave minimale të qerasë financiare që i takojnë qiradhënësit, llogaritur me normën e interesit të tregut.

Banka Credins sh.a.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(shuma në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

2 Politikat Kontabël (vazhdim)

2.5 Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(9) Njohja e të ardhurave dhe shpenzimeve

Të ardhurat njihen në atë masë që është e mundur që përfitimet ekonomike do të rrjedhin te Grupi dhe të ardhurat mund të maten me besueshmëri. Kriteret e mëposhtme specifike të njohjes gjithashtu duhet të plotësohen para se të ardhurat njihen.

(i) Të ardhurat dhe shpenzimet e interesit

Të ardhurat dhe shpenzimet për interesa njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv. Norma e interesit efektiv është norma që skanton pagesat dhe arkëtimet e ardhshme monetare gjatë jetës së mjetit ose detyrimit financiar (ose kur është e përshtatshme për një periudhë më të shkurtër) për t'i barazuar me vlerën kontabël të mjetit ose detyrimit financiar. Norma efektive e interesit vendoset duke marrë parasysh njohjen fillestare të aktiveve ose detyrimeve financiare dhe nuk rishikohet më vonë.

Llogaritja e normës efektive të interesit përfshin të gjitha shumat e paguara ose të marra në avancë, kostot e transaksionit, zbritjet dhe primet të cilat janë pjesë integrale e normës efektive të interesit. Kostot e transaksioneve janë kosto shtesë të lidhura drejtpërdrejt me blerjen, ose emetimin apo nxjerrjen jashtë përdorimi të një mjeti apo detyrimi financiar. Të ardhurat dhe shpenzimet për interesat të paraqitura si fitim ose humbje përfshin interesin e aktiveve dhe detyrimeve financiare me kosto të amortizuar me normë interesi efektive.

(ii) Të ardhurat dhe shpenzimet për komisione dhe tarifa

Të ardhurat dhe shpenzimet për tarifat dhe komisionet të cilat janë pjesë integrale e normës së interesit efektiv në një mjet ose detyrim financiar, përfshihen në matjen e normës së interesit efektiv.

Tarifa dhe komisione të tjera që përfshijnë tarifa për shërbimin e llogarive, tarifa për administrimin e investimeve, komisione shitjesh, tarifatat e vendosjes dhe përfaqësimit njihen kur shërbimi i lidhur kryhet.

Shpenzime të tjera për tarifatat dhe komisionet që lidhen kryesisht me tarifa transaksionesh dhe shërbimi shpenzohen në momentin që ofrohen shërbimet.

(10) Mjetet monetare dhe ekuivalentët me to

Aktivitet monetare dhe ekuivalentet me to përfshijnë kartëmonedha dhe monedha, shuma të pakushtëzuara me Bankën Qendrore dhe investimet me likuiditet të lartë të cilat kanë maturim tre mujor ose më të vogël, të cilat janë subjekt i rreziqeve të parëndësishme të ndryshimit të vlerës së drejtë dhe përdoren nga Grupi në menaxhimin e angazhimeve afatshkurtra. Aktivitet monetare dhe ekuivalentet me to mbarten me koston e amortizimit në pasqyrën e pozicionit financiar.

(11) Letrat me vlerë të investimit

Letrat me vlerë të investimeve fillimisht maten me vlerën e drejtë plus kosto direkte transaksioni dhe më pas mbarten në varësi të klasifikimit të tyre, si të mbajtura deri në maturim, me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, ose të vlefshme për shitje.

(12) Aktive afatgjata materiale

(i) Njohja dhe matja

Aktivitet afatgjata materiale maten me koston e blerjes minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi. Kostot përfshijnë shpenzime të cilat i atribuohen direkt blerjes së aktivitet. Kostot e aktiveve të ndërtuara vetë përfshijnë kostot e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër që lidhet me vënien e aktivitet në punë për qëllimin e përcaktuar dhe kostot e çmontimit dhe lëvizjes dhe ristrukturimit në vendin në të cilin ato ndodhen. Programi kompjuterik i blerës, i cili është një pjesë integrale e funksionimit të pajisjes kontabilizohet si pjesë e pajisjes. Kur pjesët e një zëri të ndërtesës dhe pajisjeve kanë jetë përdorimi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndarë (komponentët kryesorë) të aktiveve afatgjata materiale.

(ii) Kostot vijuese

Kostoja e pjesëve të zëvendësueshme të tokës, ndërtesës dhe pajisjeve njihet me vlerën e mbartur nëse është e mundshme që në të ardhmen Grupi do të ketë përfitime ekonomike nga këto pjesë dhe kostot e tyre mund të njihen në mënyrë të besueshme. Kostot e mirëmbajtjes së përditshme njihen në fitim ose humbje në momentin kur lindin.

Banka Credins sh.a.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(shuma në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

2 Politikat Kontabël (vazhdim)

2.5 Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(12) Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

(iii) Amortizimi

Amortizimi njihet në të ardhura dhe shpenzimeve me anën e metodës zbritëse mbi jetën e dobishme të vlerësuar të aktivitetit përveçse për aktivet që zhvlerësohen me metodën lineare. Aktivet e marra me qira zhvlerësohen për më të shkurtrën midis kohës së qirasë dhe jetëgjatësisë së aktivitetit. Toka nuk zhvlerësohet. Metodatat e zhvlerësimit, jeta e dobishme dhe vlerat e mbetura rivlerësohen në datën e raportimit.

Normat e amortizimit për periudhën aktuale dhe krahasuese janë si më poshtë:

Kategoria e aktiveve afatgjata	% e amortizimit
Ndërtesa	5%
Pajisje elektronike	25%
Automjete	20%
Mobilie dhe pajisje zyre	20%
Përmirësimet e ambienteve të marra me qira	5%

(13) Aktivitetet jomateriale

(i) Programe kompjuterike

Programet kompjuterike të blera nga Grupi njihen me koston historike zvogëluar me amortizimin dhe humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë. Shpenzimet e mëvonshme mbi programet kompjuterike kapitalizohen vetëm kur këto shpenzime lidhen me rritjen e përfitimit të ardhshëm ekonomik prej këtij mjeti. Të gjitha shpenzimet e tjera njihen në periudhën që ndodhin. Amortizimi njihet në fitim ose humbje me normën 25% mbi vlerën e mbetur prej datës në të cilën ky program është i gatshëm për përdorim.

(ii) Liçencat

Liçencat dhe të drejtat e përdorimit blerë nga Grupi janë të paraqitura me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi nëse ka. Shpenzimet e mëvonshme kapitalizohen vetëm atëherë kur ato rrisin përfitimet ekonomike të ardhshme të trupëzuara në aktivin me të cilin lidhen. Të gjitha shpenzimet e tjera njihen kur ndodhin tek pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve. Amortizimi njihet në fitim ose humbje në bazë lineare mbi jetën e dobishme të liçencës që nga data që është e vlefshme për përdorim.

(14) Zhvlerësimi i aktiveve jofinanciare

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të Grupit, përveç aktiveve për tatime të shtyra rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka evidenca për zhvlerësim. Nëse ka evidenca të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit.

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabël e aktivitetit tejkalon vlerën e rikuperueshme. Njësia gjeneruese e aktiveve monetare është grupi me i vogël i identifikueshëm i aktiveve që gjeneron flukse monetare në mënyrë të pavarur nga aktivet dhe grupet e tjera. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në fitim ose humbje.

Vlera e rikuperueshme e një aktivi ose e njësive gjeneruese të mjeteve monetare është më e madhja ndërmjet çmimit neto të shitjes dhe vlerës së tij në përdorim. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e çmuara të ardhshme të aktiveve monetare janë skontuar në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para taksave që reflekton vlerësimin aktual të tregjeve për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike për aktivin.

(15) Garancitë Financiare

Garancitë financiare janë kontrata që e detyrojnë Bankën që të bëjë pagesa specifike për të rimbursuar mbajtësin për një humbje që lind kur një debitor specifik nuk paguan në afat sipas termave të një instrumenti huadhënës.

Detyrimet për garancitë financiare fillimisht njihen në vlerën e drejtë dhe vlera fillestare amortizohet mbi jetën e garancisë financiare. Detyrimi për garancinë mbahet me vlerën më të lartë midis vlerës me kosto të amortizuar dhe vlerës aktuale të pagesave të pritshme (kur pagesa nën një garanci është bërë e mundshme). Garancitë financiare përfshihen tek detyrimet e tjera.

Banka Credins sh.a.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(shuma në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

2 Politikat Kontabël (vazhdim)

2.5 Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(16) Përfitimet e punonjësve

(i) Sigurimet shoqërore të detyrueshme

Grupi pagan vetëm kontribute për sigurimet shoqërore të detyrueshme për përfitimet e punonjësve që dalin në pension. Autoritetet e Sigurimeve Shoqërore janë përgjegjëse për përcaktimin e limitit minimal ligjor të vendosur për pensionet në Shqipëri sipas një plani kontributesh të përcaktuar për pensione. Kontributet për planin e pensionit njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzime kur ato ndodhin.

(ii) Leja vjetore e paguar

Grupi njih si detyrim shumë të përlogarit të kostos për lejet vjetore që pritët të paguhet në këmbim të shërbimeve të punëmarrësit për periudhën.

(iii) Sigurimet shëndetësore të punonjësve

Grupi gjithashtu pagan kontribute të përcaktuara për sigurimin shëndetësor të punonjësve. Kontributi është i pagueshëm ndaj një kompanie sigurimi në raport me shërbimet e kryera në bankë nga ana e punonjësve dhe është regjistruar si një shpenzim nën 'shpenzime të personelit'. Kontributet e papaguara janë të regjistruara si detyrime.

(iv) Kontribut vullnetar i pensionit për punonjësit

Grupi ka krijuar një Plan Pensioni Profesional për punonjësit e vetë. Bank merr përsipër të paguajë kontribute për çdo punonjës që ka firmosur një kontratë individuale për "Planin Profesional të Pensionit." Shpenzimi vjetor përfaqëson kontributin vjetor të paguar nga Grupi, dhe regjistrohet në zërin "Shpenzime Personeli," duke prekur pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve të Grupit, dhe pa ndikuar në detyrimet e mëvonshme të Grupit, duke qënë se plani administrohet prej shoqërisë "Sicred sh.a."

(17) Provigjone për detyrime të kushtëzuara dhe angazhime

Një provigjon është njohur nëse, si rezultat i një ngjarjeje të kaluar, Grupi ka një detyrim ligjor ose konstruktiv që mund të matet me besueshmëri, dhe është e mundur që një dalje e përfitimëve ekonomike do të kërkohej për të shlyer detyrimin. Provigjonet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme monetare të ardhshme me një normë para tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe, aty ku është e përshtatshme, rreziqet specifike që lidhen me detyrimin.

Një provigjon për ristrukturimin njihet kur Grupi ka miratuar një plan të detajuar dhe formal ristrukturimi, dhe ristrukturimi ose ka filluar ose është shpallur publikisht. Shpenzimet operative të ardhshme nuk janë provigjonus.

Një provigjon për kontratat e dyshimta njihet kur përfitimet që priten të rrjedhin te Grupi nga një kontratë janë më të ulëta se sa kostoja e pashmangshme e përmbushjes së detyrimeve sipas kontratës. Provigjoni matet me më të ultën mes vlerës aktuale të kostos së pritshme nga ndërprerja e kontratës dhe kostos së pritshme neto të vazhdimit me kontratën. Para se të njihet provigjoni, Grupi njih çdo humbje nga zhvlerësimi mbi aktivet e lidhura me atë kontratë.

(18) Tatimet

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin aktual dhe tatimin e shtyrë.

(i) Tatimi aktual mbi fitimin

Tatimi aktual është tatimi që pritët të paguhet mbi fitimin e tatueshëm vjetor. Fitimi i tatueshëm ndryshon nga fitimi i raportuar në Pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse për shkak të zërave të të ardhurave dhe shpenzimeve që janë të tatueshëm ose të zbritshëm në periudhat e ardhshme dhe zërat që nuk taten apo njihen si të zbritshëm asnjëherë.

Shpenzimet e tatimit mbi fitimin njihen në fitim ose humbje, përveç në masën që lidhet me zërat e njohur direkt në kapital ose në të ardhura të tjera përmbledhëse.

Tatimi aktual është tatimi që pritët të paguhet mbi të ardhurat e tatueshme për vitin, duke përdorur normat tatimore në fuqi në datën e raportimit, dhe çdo rregullim i tatimit të pagueshëm në lidhje me vitet e mëparshme në përputhje me legjislacionin tatimor Shqiptar. Të ardhurat e tatueshme llogariten duke rregulluar fitimin para tatimit për shumën e të ardhurave dhe shpenzimeve të caktuara, siç kërkohej nga ligji Shqiptar.

Banka Credins sh.a.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(shuma në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

2 Politikat Kontabël (vazhdim)

2.5 Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(18) Tatimet (vazhdim)

(ii) Tatimi i shtyrë mbi fitimin

Tatimi i shtyrë njihet në përputhje me diferencat e përkohshme midis vlerës kontabël të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi dhe vlerës kontabël të përdorura për qëllim fiskale. Detyrimet tatimore të shtyra njihen në përgjithësi për të gjitha diferencat e përkohshme të tatueshme.

Aktivitet tatimore të shtyra njihen në përgjithësi për të gjitha diferencat e përkohshme të tatueshme në atë masë që është e mundur që fitime të ardhshme të tatueshme do të jenë të disponueshme, ndaj të cilave ato mund të shfrytëzohen. Vlera kontabël neto e aktiveve tatimore të shtyra rishikohet në fund të çdo periudhe raportimi dhe zvogëlohet në atë masë që nuk është e mundur që të ketë fitime të tatueshme të mjaftueshme në dispozicion për të lejuar që e gjitha ose një pjesë e aktivitet të mund të rikuperohet.

Detyrimet dhe aktivitet e shtyra tatimore maten me normat e tatimit të cilat pritet të aplikohen në periudhën kur detyrimi do të shlyhet ose aktivitet realizohet, bazuar në normat fiskale dhe ligjet fiskale të cilat janë miratuar ose priten të miratohen në datën e raportimit. Matja e detyrimeve dhe aktiveve tatimore të shtyra pasqyron rrjedhojat tatimore që do të vijojnë nga mënyra në të cilën Grupi pret, që në fund të periudhës raportuese, të rimarrë ose shlyejë vlerën kontabël të aktiveve dhe detyrimeve të saj.

(iii) Tatimi aktual dhe i shtyrë për vitin

Tatimi aktual dhe tatimi i shtyrë njihen në fitim ose humbje, përveç kur lidhen me zërat që janë njohur në të ardhurat e tjera përmbledhëse, ose direkt në kapital, rast në të cilin tatimi aktual dhe tatimi i shtyrë njihen edhe në të ardhurat e tjera përmbledhëse ose drejtpërdrejt në kapital, përkatësisht.

(19) Prona të riposeduara

Politika e Grupit është të përcaktojë nëse një aktiv i riposeduar do të perdoret për përdorim të brendshëm nga Grupi apo do të shitet. Aktivitet e përcaktuara si të dobishme për aktivitetet e brendshme të Grupit transferohen në klasën perkatese të aktiveve me vlerën me të ulet mes vlerës së riposedimit dhe vlerës kontabel të aktivitet fillestar të siguruar.

Grupi zoteron disa prona të riposeduara të cilat i ka marrë nga ekzekutimi i kolateraleve të huave dhe parandënies ndaj klientëve. Grupi i mat keto aktive të riposeduara fillimisht me kosto (çmim blerje). Në fund të çdo periudhe raportuese keto aktive maten me të voglen mes koston dhe vlerës neto të realizueshme. Fitimet dhe humbjet që rrjedhin nga çdo ndryshim në vlerën neto të realizueshme të pronave të riposeduara njihen në pasqyrën e të ardhurave në periudhën në të cilën linden. Keto aktive çregjistrohen kur nxirren jashtë përdorimit ose kur nuk priten përfitime ekonomike të ardhshme nga ky pakësim (nxjerrje jashtë përdorimit). Çdo fitim ose humbje që rrjedh nga mosnjohja e pronës (llogaritur si diferencë midis të ardhurave nga shitja dhe vlerës kontabël neto të aktivitet) përfshihet në fitim ose humbje në periudhën në të cilën prona është çregjistruar.

(20) Depozitat dhe borxhi i varur

Depozitat, letrat me vlerë të borxhit dhe borxhi i varur janë burimet kryesore të financimit të Grupit. Kur Grupi shet një aktiv financiar dhe hyn në një "marrëveshje riblerjeje" për ta blerë këtë aktiv (ose një aktiv të ngjashëm) me një çmim fiks në të ardhmen, marrëveshja kontabilizohet si një depozitë, dhe aktivitet vazhdon të njihet në Pasqyrat financiare të konsoliduara të Grupit.

Depozitat, letra me vlerë të borxhit dhe borxhi i varur maten fillimisht me vlerën e drejtë duke i shtuar kostot e transaksionit dhe në vijim maten me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv përveçse në rastet kur Grupi zgjedh që t'i mbajë detyrimet me vlerën e drejtë në fitim ose humbje. Metoda e interesit efektiv është një metodë e llogaritjes së koston të amortizuar të një detyrimi financiar dhe i alokimit të shpenzimit të interesit gjatë periudhës përkatëse. Norma e interesit efektiv është norma që skanton deri në vlerën kontabël neto në njohjen fillestare, pagesat monetare të ardhshme të vlerësuar (përfshirë të gjitha taksat dhe shumatat e paguara ose të marra që formojnë një pjesë përbërëse të normës efektive të interesit, kostot e transaksionit dhe primet e tjera ose zbritjet) përgjatë jetës së pritshme të detyrimit financiar, ose (sipas rastit) përgjatë një periudhe më të shkurtër.

(21) Dividendët

Dividendët e aksioneve të zakonshme janë njohur si një detyrim dhe janë zbritur nga kapitali në momentin kur ata janë miratuar nga aksionarët e Grupit. Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016, nuk ka patur dividendë të deklaruar nga Grupi për të paguar aksionarëve.

Banka Credins sh.a.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(shuma në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

2 Politikat Kontabël (vazhdim)

2.5 Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(22) Rezervat e kapitalit

Rezervat e regjistruara në kapital (të ardhurat e tjera përmbledhëse) në pasqyrën e pozicionit financiar përfshijnë:

"Rezervën e përgjithshme" që përfshin ndryshimet e bëra për rezervën ligjore siç përcaktohet në Ligjin e Grupit Qendror dhe Ligjin Tregtar të zbatueshëm në Shqipëri.

"Rezerva e rivlerësimit" e cila është përdorur për të regjistruar ndryshimet e këmbimit që rrjedhin nga rivlerësimi i letrave me vlerë të investimit.

3 Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2016	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2015
Të ardhurat nga interesat		
Hua dhe paradhënie për klientët	8,028,614	7,805,370
Letra me vlerë të investimit	870,518	741,253
Shuma të kushtëzuara me Bankën Qëndrore	63,665	86,180
Hua dhënë bankave dhe institucioneve të tjera financiare	38,611	81,706
Aktive monetare dhe ekuivalentë me to	15,663	6,952
Të ardhura nga interesat e përlogaritura mbi aktivet financiare të zhvlerësuar:		
Hua dhe paradhënie për klientët (të zhvlerësuar individualisht)	141,429	131,661
Hua dhe paradhënie për klientët (të zhvlerësuar në grup)	43,733	16,679
Totali i të ardhurave nga interesat	9,202,233	8,869,801
Shpenzimet për interesa		
Detyrime ndaj klientëve	(1,628,406)	(2,117,336)
Borxhi i varur	(418,970)	(385,627)
Detyrime ndaj bankave dhe institucioneve të tjera financiare	(111,821)	(189,297)
Marrëvjeshe të anasjellta të riblerjes	(3,870)	-
Totali i shpenzimeve për interesa	(2,163,067)	(2,692,260)
Të ardhurat neto nga interesat	7,039,166	6,177,541

4 Të ardhura dhe shpenzime nga tarifat dhe komisionet

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2016	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2015
Të ardhura nga tarifat dhe komisionet		
Komisione nga shërbimet bankare	638,515	531,385
Tarifa dhe komisione nga shërbimet e huadhënies	19,132	4,565
Totali i të ardhurave nga tarifat dhe komisionet	657,647	535,950
Shpenzime për tarifat dhe komisionet		
Veprime me thesarin	(49,461)	(31,059)
Tarifa për veprime ndërbankare	(48,074)	(21,616)
Të tjera	(13,853)	(6,817)
Totali i shpenzimeve për tarifat dhe komisionet	(111,388)	(59,492)
Të ardhura neto nga tarifat dhe komisionet	546,259	476,458

Banka Credins sh.a.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(shuma në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

5 Të ardhura dhe shpenzime të tjera

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2016	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2015
Të ardhura të tjera		
Të ardhura të tjera	202,064	147,439
Totali i të ardhurave të tjera	202,064	147,439
Shpenzime të tjera		
Shpenzime të tjera të lidhura me aktivitetet bankare	(169,556)	(38,763)
Shpenzime të tjera	(44)	-
Totali i shpenzimeve të tjera	(169,600)	(38,763)
Të ardhura/(Shpenzime) të tjera, neto	32,464	108,676

Shpenzime të tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 përfshijnë shpenzime që lidhen me aktivitetet bankare, me rënien në vlerë të pronave të riposeduara, shpenzim i cili më 31 dhjetor 2016 është në shumën 52,000 mijë Lekë (31 dhjetor 2015: 43,843 mijë Lekë) (shënimi 19).

6 Shpenzime personeli

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2016	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2015
Pagat e punonjësve	766,980	652,439
Bonus dhe shpërblime	106,292	61,302
Sigurime shoqërore	100,195	85,877
Primi i sigurimit të jetës	19,539	10,000
Të tjera	84,726	100,476
Totali	1,077,732	910,094

7 Shpenzime administrative

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2016	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2015
Sigurime dhe mbikëqyrje	519,056	437,962
Qira	499,617	481,829
Marketing dhe abonime	327,279	432,571
Tarifa për palë të treta	320,721	340,235
Mirëmbajtje	139,508	60,326
Paisje	54,143	40,984
Ujë, energji	49,640	42,625
Të tjera	47,638	29,221
Taksa lokale dhe të tjera	34,608	17,322
Transport dhe udhëtime	31,829	23,417
Zhvlerësimi i debitorëve	-	142
Totali	2,024,039	1,906,634

Sigurimi dhe mbikqyrja si dhe shpenzimet për qeratë janë rritur si rezultat i kalimit në zyrat e reja të administrates. Tarifa me palë të treta lidhet me mirëmbajtjen e POS-ëve, ATM-ve, dhe pajisjeve të tjera elektronike, si dhe tarifa të tjera konsulence.

8 Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2016	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2015
Tatimi aktual	169,587	77,412
Tatim fitimi i shtyrë (shënimi 18)	(7,800)	(68,360)
Shpenzimi tatim fitimit	161,787	9,052

Fondet për zhvlerësimet regjistruar si shpenzim nga Grupi në përputhje me SNRF-të do të konsiderohen si shpenzime të zbritshme për efekt tatimi, me kusht që ato të jenë certifikuar nga një auditues i jashtëm.

Banka Credins sh.a.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(shuma në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

8 Shpenzimi i tatimit mbi fitimin (vazhdim)

Në përputhje me legjislacionin tatimor në Shqipëri, norma e aplikueshme e tatimit mbi fitimin për 2016 është 15% dhe 2015 është 15%. Tatim fitimi i shtyrë është llogaritur mbi vlerën e pronave të riposeduara (shënimi 18).

Rakordimi i normës efektive të tatimit mbi fitimin është përmbledhur si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2016	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2015
Fitimi para tatimit	416,416	135,146
Tatim fitim i llogaritur si 15% (2015: 15%) e fitimit kontabël	62,463	20,272
Sistemi i tatimi fitimit nga humbjet e filialeve	1,548	819
Shpenzime të pazbritshme	105,576	56,321
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	169,587	77,412

Deklaratat tatimore dorëzohen çdo vit tek Autoritetet Tatimore por fitimet ose humbjet e deklaruar për qëllime fiskale konsiderohen provizore derisa deklaratat tatimore dhe llogaritjet e tatimit të inspektohen nga autoritetet tatimore dhe një vlerësim final të lëshohet. Legjislacioni shqiptar mbi tatimin është subjekt i interpretimeve nga autoritetet tatimore. Shpenzimet e panjohura përfshijnë humbje nga kreditë e pambledhshme, rënie vlere të pronave të riposeduara, provigjonet e krijuara, shpenzimin e amortizimit për përmiresimet e ambjenteve me qera të cilat nuk njihen për efekte fiskale, dhe shpenzime të tjera të panjohura sipas legjislacionit fiskal në fuqi.

9 Mjete monetare dhe ekuivalente me to

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Vendosjet në tregun e parasë	14,387,231	3,410,282
Llogaritë rrjedhëse të pakushtëzuara me Bankën Qëndrore	5,770,777	3,561,200
Aktive monetare në arkë	5,183,424	3,019,556
Llogaritë rrjedhëse me bankat	4,819,702	9,757,990
Në tranzit	(1,120,527)	(859,934)
Totali	29,040,607	18,889,094

Vendosjet në tregun e parasë përfshijnë vendosjet me bankat rezidente dhe jo-rezidente, me maturitet afatshkurtër, deri në 3 muaj.

Mjetet monetare në tranzit përfaqësojnë pagesa ndaj Autoriteteve Tatimore të kryera nga klientë të Grupit, për të cilat Banka vepron si agjent për mbledhjen e tyre. Këto transaksione janë kryer brenda datës 31 dhjetor 2016, dhe mbyllen me transferimin e vlerave tek llogaria rrjedhëse e Grupit me Bankën Qëndrore në ditët e para të vitit 2017.

10 Shuma të kushtëzuara me Bankën Qëndrore

Në përputhje me kërkesat e Bankës së Shqipërisë në lidhje me rezervën e depozitave, Grupi mban në Bankën e Shqipërisë një rezervë në masën 10% të depozitave të klientëve si rezervë të detyrueshme. Bazuar në vendimin nr. 29, të datës 16.05.2012, të Këshillit Mbikqyrës të Bankës së Shqipërisë, Grupi mund të përdorë rezervën në Lekë, me kusht që mesatarja e gjendjes së llogarisë rezervë ditën e fundit të periudhës së mbajtjes të mos jetë nën nivelin e rezervës së detyruar. Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015, Banka nuk e ka përdorur rezervën.

Maturiteti i rezervës ligjore krijohet çdo muaj dhe norma e interesit të aplikuar të rezerva e konvertuar në Lekë është 70% i normës së marrëveshjes së riblerjes një-javore (norma bazë) në Shqipëri, e cila më 31 dhjetor 2016 ishte 1.25% (31 dhjetor 2015: 1.75%). Rezerva e vendosur në monedhën Euro mbart një interes prej -0.4% e deklaruar nga Banka Qendrore Europiane (31 dhjetor 2015: 0%). Rezerva në dollar amerikan nuk mbart interes.

Më 31 dhjetor 2016 gjendja e reserves ligjore ishte: 11,520,723 mijë Lekë (31 dhjetor 2015: 11,060,066 mijë Lekë).

Banka Credins sh.a.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(shuma në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

11 Hua dhe paradhënie bankave dhe institucioneve të tjera financiare

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Bankat dhe institucionet e tjera financiare jo- rezidente		
Në monedhë të huaj	1,351,174	1,617,471
Bankat dhe institucione e tjera financiare -rezidente		
Në Lekë	153,636	162,349
Në monedhë të huaj	30,336	-
Totali	1,535,146	1,779,820

12 Hua dhe paradhënie për klientët

Huatë dhe paradhëniet për klientët përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Hua dhe paradhënie për klientët, me kosto të amortizuar	108,238,985	97,584,210
Fondi për humbje nga zhvlerësimi i huave	(14,765,408)	(12,333,587)
	93,473,577	85,250,623

Ndarja e huave dhe paradhënieve për klientët sipas sektorit, janë detajuar si më poshtë:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Hua për korporatat	63,078,602	72,074,213
Hua hipotekare	6,370,228	5,197,505
Hua për individë	5,341,347	4,791,279
Hua të tjera të siguruara	33,448,808	15,521,213
	108,238,985	97,584,210
Fondi për humbje nga zhvlerësimi i huave	(14,765,408)	(12,333,587)
	93,473,577	85,250,623

Lëvizjet në fondin për humbje nga huatë janë detajuar si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2016	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2015
Gjëndja më 1 janar	12,333,587	10,716,317
Humbje nga zhvlerësimi i huave	9,936,217	10,799,045
Rimarrje nga huatë	(6,847,575)	(7,194,163)
Fshirje kredish	(618,741)	(2,056,457)
Efekt i kurseve të këmbimit	(38,080)	68,845
Gjëndja më 31 dhjetor	14,765,408	12,333,587

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016, Grupi konsideroi si të parikuperueshme dhe fshiu një shumë prej 1,060,129 mijë Lekë (31 dhjetor 2015: 333,057 mijë Lekë).

Banka Credins sh.a.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
(shuma në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

12 Hua dhe paradhënie klientëve (vazhdim)

	Hua për korporatat	Hua për individët	Hua hipotekare	Huadhënie të tjera të mbuluara	Totali
Gjendja më 1 janar 2015	7,990,540	532,455	647,996	1,545,326	10,716,317
Humbje nga zhvlerësimi i huave	8,402,875	(856,956)	(989,728)	4,242,854	10,799,045
Rimarrje	(5,597,870)	570,891	659,342	(2,826,526)	(7,194,163)
Fshirje kredish	(1,600,156)	163,190	188,474	(807,965)	(2,056,457)
Efekti i kurseve të këmbimit	53,568	(5,463)	(6,310)	27,050	68,845
Gjendja më 31 dhjetor 2015	9,248,957	404,117	499,774	2,180,739	12,333,587
Humbje nga zhvlerësimi i huave	7,015,418	328,681	428,893	2,163,225	9,936,217
Rimarrje	(5,430,283)	(315,211)	(383,276)	(718,805)	(6,847,575)
Fshirje kredish	(387,387)	(108,022)	(63,448)	(59,884)	(618,741)
Efekti i kurseve të këmbimit	(28,556)	(1,249)	(1,542)	(6,733)	(38,080)
Gjendja më 31 dhjetor 2016	10,418,149	308,316	480,401	3,558,542	14,765,408
Më 31 dhjetor 2015					
Zhvlerësimet individuale	6,853,302	-	216,609	1,322,969	8,392,880
Zhvlerësimet në grup	2,395,655	404,117	283,165	857,770	3,940,707
	9,248,957	404,117	499,774	2,180,739	12,333,587
Më 31 dhjetor 2016					
Zhvlerësimet individuale	7,533,776	-	218,252	2,336,605	10,088,633
Zhvlerësimet në grup	2,884,373	308,316	262,149	1,221,937	4,676,775
	10,418,149	308,316	480,401	3,558,542	14,765,408
Shuma bruto e huave të përcaktuara individualisht për zhvlerësim, para zbritjes se provigjionit individual të zhvlerësimit	12,457,829	-	670,674	4,640,941	17,769,444

Banka Credins sh.a.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(shuma në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

13 Qira financiare

Detajet për qiranë financiare ndaj klientëve jepen si më poshtë:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Totali i investimit në qira financiare, e arkëtueshme, bruto		
- Më pak se 1 vit	425,701	468,804
- Më shumë se 1 vit dhe më pak se 5 vjet	602,190	722,097
	1,027,891	1,190,901
Zbritet: Interesi i pafitur	(11,372)	(145,494)
Investimi në qiranë financiare, neto	1,016,519	1,045,407
Fondi i zhvlerësimit	(70,744)	(80,166)
Totali	945,775	965,241

Lëvizjet në fondin për humbje nga qiratë financiare janë detajuar si më poshtë

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2016	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2015
Gjëndja më 1 janar	80,166	4,826
Humbje nga zhvlerësimi i huave	42,452	503,077
Rimarrje	(50,869)	(335,143)
Fshirje kredish	-	(95,801)
Efekti i kurseve të këmbimit	(1,005)	3,207
Gjëndja më 31 dhjetor	70,744	80,166
	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2016	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2015
Zhvlerësim individual	-	15,495
Zhvlerësim kolektiv	70,744	64,671
	70,744	80,166
Shuma bruto e qirasë financiare të përcaktuar individualisht për zhvlerësim, para zbritjes së provigjonit individual të zhvlerësimit	-	41,477

14 Letra me vlerë të vlefshme për shitje

Letrat me vlerë të vlefshme për shitje më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 janë të përbëra si më poshtë:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Bono thesari	6,535,987	12,552,817
Obligacione qeveritare	14,772,488	6,524,541
Totali	21,308,475	19,077,358

Bono Thesari

Normat e interesit për bonot e thesarit të vlefshme për shitje gjatë vitit të mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe vitit të mbyllur më 31 dhjetor 2015, vlera kontabël dhe vlera e tyre e drejtë në datën e raportimit bazuar në maturitetin kontraktual, sipas llojit janë paraqitur më poshtë:

		31 dhjetor 2016						
		<i>Norma e interesit</i>	<i>Vlera</i>	<i>Zbritja e</i>	<i>Interesi i</i>	<i>Vlera e</i>	<i>Diferenca e</i>	<i>Vlera e</i>
		<i>Min.</i>	<i>Maks.</i>	<i>nominale</i>	<i>shtyrë</i>	<i>përlllogaritur</i>	<i>amortizuar</i>	<i>rivlerësimit</i>
3 muaj	1.30%	1.85%	150,000	(485)	352	149,867	-	149,867
12 muaj	1.26%	3.11%	6,437,840	(108,281)	62,004	6,391,563	(5,443)	6,386,120
			6,587,840	(108,766)	62,356	6,541,430	(5,443)	6,535,987

Banka Credins sh.a.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(shuma në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

14 Letra me vlerë të vlefshme për shitje (vazhdim)

Bono Thesari (vazhdim)

31 dhjetor 2015							
	Norma e interesit		Vlera	Zbritja e	Interesi i	Vlera e	Diferenca e
	Min.	Maks.	nominale	shtyrë	përlllogaritur	amortizuar	rivlerësimit
							Vlera e drejtë
6 muaj	2.37%	2.56%	400,000	(5,634)	3,067	397,433	296
12 muaj	1.75%	2.56%	12,277,710	(397,829)	235,313	12,115,194	39,894
			12,677,710	(403,463)	238,380	12,512,627	40,190
							12,552,817

Obligacione qeveritare

Më datë 31 dhjetor 2016, Grupi ka një portofol me obligacione qeveritare të vlefshme për shitje 2-vjecare, 3-vjecare, 5-vjecare, 7-vjecare dhe 10-vjecare në Lekë. Interesi (kuponi) arkëtohet cdo 6-muaj. Obligacionet prej 5 vitesh kanë normë kuponi të ndryshueshme. Detaje të obligacioneve qeveritare më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 mbi vlerën kontabël dhe vlerën e tyre drejtë në datën e raportimit sipas maturitetit të tyre kontraktual, të klasifikuar sipas llojit janë paraqitur më poshtë:

31 dhjetor 2016							
	Norma e interesit		Vlera	Primi	Interesi i	Vlera e	Diferenca e
	Min.	Maks.	Nominale	për tu	përlllogaritur	amortizuar	rivlerësimit
				amortizuar			Vlera e drejtë
24 muaj	1.50%	5.05%	3,200,350	72	21,290	3,221,712	4,808
36 muaj	5.00%	5.80%	1,099,500	417	23,563	1,123,480	30,910
60 muaj	3.83%	9.53%	2,751,300	15,137	40,264	2,806,701	69,709
84 muaj	4.09%	10.85%	4,173,800	209,931	48,410	4,432,141	(76,346)
120 muaj	4.45%	9.25%	2,729,300	371,459	72,323	3,173,082	(13,709)
			13,954,250	597,016	205,850	14,757,116	15,372
							14,772,488

31 dhjetor 2015							
	Norma e interesit		Vlera	Primi	Interesi i	Vlera e	Diferenca e
	Min.	Maks.	Nominale	për tu	përlllogaritur	amortizuar	rivlerësimit
				amortizuar			Vlera e drejtë
24 muaj	4.59%	5.05%	2,766,500	-	26,398	2,792,898	7,569
36 muaj	5.68%	5.80%	1,300,000	-	29,806	1,329,806	21,459
60 muaj	4.94%	5.53%	806,000	-	12,628	818,628	4,636
84 muaj	6.19%	6.79%	906,000	-	9,245	915,245	19,273
120 muaj	5.94%	6.74%	585,000	2,368	11,873	599,241	15,786
			6,363,500	2,368	89,950	6,455,818	68,723
							6,524,541

Tabela më poshtë tregon lëvizjet në gjendjet e investimeve të vlefshme për shitje më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015, përfshirë këtu shtesat, maturimet dhe shitjet e investimeve gjatë këtyre viteve:

Lëvizjet në të vlefshmet për shitje		
	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Gjendja më 1 janar	19,077,358	15,454,143
Shtesa	18,609,000	18,603,355
Riklasifikimi nga letra me vlerë të mbajtura në maturim (shënimi 15)	17,289	-
Shitje	(1,116,975)	(705,000)
Maturime	(15,288,126)	(14,383,814)
Luhatje në vlerën e drejtë	9,929	108,674
Gjendja më 31 dhjetor	21,308,475	19,077,358

Banka Credins sh.a.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(shuma në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

15 Investime të mbajtura deri në maturim

Investimet e mbajtura deri në maturim më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Obligacion qeveritar 10 Vjecar	-	17,000
Prim	-	10
Interesa të përlogaritura nga kuponi	-	279
Totali	-	17,289

Më 23 tetor 2015 CREDINS INVEST sh.a. - Shoqëria Administruese e Fondit të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive” (më parë “Shoqëria Administruese e Fondit të Pensionit “SiCRED” sh.a.”) investoi në një obligacion qeveritar 10 vjecar, me interes vjetor kuponi prej 8.8% dhe normë interesi efektiv 8.81%.

Bazuar në rregulloren “Për llogaritjen e vlerës dhe formës së Kapitalit të Kompanive të Menaxhimit të Sipërmarrjeve Investuese Kolektive” nr. 96, i dates 25 qershor 2014, i amenduar nga vendimi i Bordit të Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare të Shqipërisë, nr. 121, i datës 24 gusht 2016, neni 5,” forma e kapitalit”, kapitali i Shoqërisë së Menaxhimit duhet të mbahet në llogari bankare rrjedhëse, depozitë bankare, investime financiare që mund të konvertohen lehtësisht në para-cash, dhe nuk duhet të investohen në instrumenta financiarë spekulativë (instrumenta financiarë me rrezik të lartë), ky instrument do rriklasifikohet si instrument i gatshëm për tu shitur (shënimi 14).

Banka Credins sh.a.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
(shuma në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

16 Aktive afatgjata materiale

	Ndërtesa	Pajisje elektronike dhe zyre	Automjete, mobilie dhe pajisje të tjera	Investime në ambiente me qira	Punime në proces	Totali
Kosto						
Gjendja më 1 janar 2015	303,863	826,943	197,103	286,612	-	1,614,521
Shtesat	-	114,176	21,279	22,621	277,323	435,399
Shtesat si pasojë e konsolidimit (shënimi 20)	-	2,614	-	-	-	2,614
Shtesat si pasojë e përthithjes me Credins Leasing (shënimi 29.2)	-	13,078 (506)	1,554 (7,513)	- (1,193)	-	14,632 (9,212)
Nxjerrja jashtë përdorimi	-	-	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2015	303,863	956,305	212,423	308,040	277,323	2,057,954
Shtesat	1,167,686	156,571	167,765	161,488	91,268	1,744,778
Transferimet	-	-	17,986	258,206	(276,192)	-
Nxjerrja jashtë përdorimi	-	(28,578)	(21,848)	-	-	(50,426)
Gjendja më 31 dhjetor 2016	1,471,549	1,084,298	376,326	727,734	92,399	3,752,306
Amortizimi						
Gjendja më 1 janar 2015	(140,482)	(538,892)	(122,247)	(192,177)	-	(993,798)
Amortizimi i periudhës	(15,193)	(67,551)	(13,101)	(27,425)	-	(123,270)
Shtesat si pasojë e konsolidimit (shënimi 20)	-	(1,387)	-	-	-	(1,387)
Shtesat si pasojë e përthithjes me Credins Leasing (shënimi 29.2)	-	(11,849)	(541)	-	-	(12,390)
Nxjerrja jashtë përdorimi	-	938	1,365	-	-	2,303
Gjendja më 31 dhjetor 2015	(155,675)	(618,741)	(134,524)	(219,602)	-	(1,128,542)
Amortizimi i periudhës	(31,348)	(84,199)	(32,240)	(41,222)	-	(189,009)
Riklasifikim	-	488	(488)	-	-	-
Nxjerrja jashtë përdorimi	-	16,366	13,935	-	-	30,301
Gjendja më 31 dhjetor 2016	(187,023)	(686,086)	(153,317)	(260,824)	-	(1,287,250)
Vlera kontabël e mbartur						
Gjendja më 1 janar 2015	163,381	288,051	74,856	94,435	-	620,723
Gjendja më 31 dhjetor 2015	148,188	337,564	77,899	88,438	277,323	929,412
Gjendja më 31 dhjetor 2016	1,284,526	398,212	223,009	466,910	92,399	2,465,056

Banka Credins sh.a.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(shuma në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

17 Aktive jo-materiale

	Programe kompjuterike	Patenta dhe Licenca	Totali
Kosto			
Gjendja më 1 janar 2015	229,774	61,524	291,298
Shtesat	28,713	10,863	39,576
Shtesat si pasojë e konsolidimit (shënimi 20)	5,559	-	5,559
Shtesat si pasojë e përthithjes me Credins Leasing (shënimi 29.2)	13,695	-	13,695
Gjendja më 31 dhjetor 2015	277,741	72,387	350,128
Shtesa	29,170	204	29,374
Gjendja më 31 dhjetor 2016	306,911	72,591	379,502
Amortizimi			
Gjendja më 1 janar 2015	(136,424)	(23,594)	(160,018)
Amortizimi i periudhës	(32,568)	(8,616)	(41,184)
Shtesat si pasojë e konsolidimit (shënimi 20)	(1,506)	-	(1,506)
Shtesat si pasojë e përthithjes me Credins Leasing (shënimi 29.2)	(8,827)	-	(8,827)
Gjendja më 31 dhjetor 2015	(179,325)	(32,210)	(211,535)
Amortizimi i periudhës	(36,305)	(8,668)	(44,973)
Gjendja më 31 dhjetor 2016	(215,630)	(40,878)	(256,508)
Vlera kontabël e mbartur			
Gjendja më 1 janar 2015	93,350	37,930	131,280
Gjendja më 31 dhjetor 2015	98,416	40,177	138,593
Gjendja më 31 dhjetor 2016	91,281	31,713	122,994

18 Aktive tatimore të shtyra

Aktivitet dhe detyrimet tatimore të shtyra përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2016			31 dhjetor 2015		
	Aktive	Detyrime	Neto	Aktive	Detyrime	Neto
Prona të riposeduara	76,160	-	76,160	68,360	-	68,360
Letra me vlerë të vlefshme për shitje	-	(487)	(487)	-	(15,334)	(15,334)
Tatimi i shtyrë aktiv neto	76,160	(487)	75,673	68,360	(15,334)	53,026

Aktive tatimore të shtyra është regjistruar neto nga detyrimi tatimor i shtyrë meqënëse shumat janë si rrjedhojë e të njëjtit autoritet tatimor dhe parashikohen të mbyllen në baza neto. Detyrimi apo aktivi i shtyrë tatimor buron nga rivlerësimi i instrumenteve të vlefshme për shitje, për të cilët luhatjet në vlerën e drejtë regjistrohen në rezervën e rivlerësimit në kapitalin neto, duke kaluar nga pasqyra e të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse si dhe nga zhvlerësimi i pronave të riposeduara e cila kalon nga pasqyra e të ardhurave dhe fitimit.

19 Prona të riposeduara

Drejtimi i Grupit i klasifikon këto pasuri të marra nga ekzekutimi i kolateraleve si rezultati i mospagimit të huave klientëve si prona të riposeduara. Vlera kontabël e tyre është vlera e drejtë e pasurisë përcaktuar sipas vlerësimeve nga vlerësuesi i pavarur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015.

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Toka	1,895,020	3,207,540
Ndërtesa rezidenciale	1,475,095	375,357
Ndërtesa biznesi	236,066	109,722
Mjete	2,000	7,262
Totali	3,608,181	3,699,881

Banka Credins sh.a.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(shuma në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

19 Prona të riposeduara (vazhdim)

Lëvizjet e pronave të riposeduara më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 është si më poshtë:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Gjendja më 1 janar	3,699,881	3,741,694
Shtesa	3,236,852	2,943
Shtesa si pasoje e perthithjes me Credins Leasing (shënimi 29.2)	-	12,617
Nxjerrja jashtë përdorimit	(3,276,552)	(13,530)
Fitimi neto nga rregullimi i vlerës së drejtë	(52,000)	(43,843)
Gjendja më 31 dhjetor	3,608,181	3,699,881

Pronat e riposeduara maten me më të voglën nga vlera e ankandit dhe vlerës së drejtë dhe zbritje të nevojshme nga ndryshimet në vlerën neto të realizueshme. Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016, pronat e riposeduara përfshijnë tokë, ndërtesa, prona rezidenciale dhe komerciale. Është në qëllimin e Grupit të shesë pronat e riposeduara sa më shpejt që është e mundur. Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 Grupi ka shitur 3,276,552 mijë lekë aktive nga portofoli i pronave të riposeduara, prej të cilave Grupi njohu rreth 16,238 mijë lekë si humbje nga shitja e tyre.

20 Kombinimi i biznesit dhe interesave jo-kontrollues

20.1 Blerje e CREDINS INVEST sh.a

Aksionarët e Grupit kanë rënë dakord që Grupi të blinte 76% të aksioneve të “CREDINS INVEST sh.a. - Shoqëri Administruese e Fondit të Pensionit dhe Sipermarreve të Investimeve Kolektive” (më pare “Shoqëria Administruese e Fondit të Pensionit “SiCRED” sh.a.”) nga “SiCRED sh.a.”, nëpërmjet marrëveshjes së blerjes së aksioneve firmosur më 22 dhjetor 2014, për një shumë prej 60,206 mijë Lekë.

Gjatë vitit 2015 dhe vitit 2016 Grupi ka shtuar një kapital të ri prej 11,400 mijë Lekë dhe 9,220 mijë Lekë respektivisht, nëpërmjet emitimit të aksioneve të reja, që e rrisin investimin e Grupit në 76.98%. Shtimi i kapitalit gjatë 2016, nuk është regjistruar ende në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Aktivët e blera dhe detyrimet e marra përsipër

Vlera e drejtë e aktiveve dhe detyrimeve të identifikueshme të “CREDINS INVEST sh.a. - Shoqëri administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipermarreve të Investimeve Kolektive” në datën e fitimit të kontrollit (30 qershor 2015) ishin:

	Vlera e drejtë e njohur në konsolidim (30 qershor 2015)
Aktivët	Lek '000
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	5,788
Hua dhe paradhënie bankave dhe institucioneve të tjera financiare	17,500
Aktive afatgjata materiale	1,212
Aktive afatgjata jomateriale	4,054
Të tjera aktive	819
Totali aktiveve	29,373
Detyrimet	
Detyrime të tjera	644
Totali detyrimeve	644
Totali i aktiveve neto të identifikueshme me vlerë të drejtë	28,729
Interesi jo-kontrollues (24% i aktiveve neto)	(6,895)
Emri i mirë nga blerja	43,371
Vlera e transferuar e blerjes	65,205

Emri i mirë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 është 43,371 mijë Lekë. Gjatë 2016 Credins Invest sh.a i shtoi një humbje prej 9,965 mijë Lekë fitimit përpara taksave nga vazhdimësia e aktiviteteve me Grupin. Grupi vendosi të masë interesat jo-kontrollues për të investuarin në masën proporcionale me përqindjen e aksioneve të Grupit në aktivet neto të identifikueshme të të investuarit. Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 nuk ka zhvlerësim për emrin e mirë.

Banka Credins sh.a.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(shuma në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

20 Kombinimi i biznesit dhe interesave jo-kontrollues (vazhdim)

20.2 Blerja e ALREG sh.a

Gjatë 2016, aksionarët e Grupit kanë rënë dakord të blejnë 95% të aksioneve të “Rregjistri Shqiptari Titujve “ALREG” sh.a” për vlerën 3,325 mijë Lekë. Ky veprim është regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit më 15 mars 2016. Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016, nuk ka emër të mirë të njohur.

21 Aktive të tjera

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Debitore	796,291	233,275
Shpenzime të parapaguara	186,208	99,124
TVSH e rimbursueshme	163,091	155,256
Shpenzime të shtyra	133,497	238,927
Të drejta ndaj kompanive të sigurimit	-	472,984
Totali	1,279,087	1,199,566

Shpenzimet e shtyra përfaqësojnë një parapagim që Grupi i ka bërë një kompanie konsulence të jashtme gjatë vitit 2013, për një afat 5 vjeçar. Gjatë vitit 2016 shuma e njohur si shpenzim për vitin është 85,488 mijë Lekë dhe është përfshirë në shpenzimet administrative si tarifa nga palët e treta (shënimi 7). Të drejta nga shoqëritë e sigurimit lidhen me një vlerë mjetesh monetare të humbura gjatë transportimit të tyre në fund të dhjetorit 2015. E gjitha shuma është e siguruar dhe është rimbursuar plotësisht gjatë 2016.

22 Detyrimet ndaj bankave dhe institucioneve të tjera financiare

Detyrime ndaj bankave dhe institucioneve të tjera financiare janë të detajuara si më poshtë:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Depozitat ndërbankare		
Rezidente	1,471,553	299,689
Jo-rezidente	-	1,431,553
Marrëveshje të anasjellta të riblerjes		
Rezidente	633,555	-
Llogari rrjedhëse		
Rezidente	387,557	13,571
Totali	2,492,665	1,744,813

23 Huamarrje

Huamarrje më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 janë si të detajuara si më poshtë:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes (Ish-METE)	172,738	170,593
Huamarrje të tjera	27,123	27,534
EBRD	-	628,618
IFC	-	275,297
Totali	199,861	1,102,042

Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes (ish-“METE”)

Gjatë vitit 2009 Grupi siguroi një hua (të butë) nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes si pjesë e “Programit për zhvillimin e sektorit privat shqiptar nëpërmjet një linje kredie për SME-të dhe asistencës teknike përkatëse” i Kooperimit Italo-Shqiptar për zhvillim (PRODAPS), i cili synon mbështetjen e zhvillimit të sektorit privat në Shqipëri duke lehtësuar aksesin e SME-ve vendase ndaj kredive. Norma e interest vjetor është 0.5% për hua në Euro, dhe 3.5% për hua në Lekë. Shlyerja ndaj METE-s bazohet në të njëjtat kushte të vendosura mbi shlyerjen ndaj përdoruesve përfundimtarë të kontratës së kredisë (huamarrës përfundimtarë). Më 31 dhjetor 2016 shuma e vlerësuar e huave është 172,738 mijë Lekë (31 dhjetor 2015: 170,593 mijë Lekë), dhe nuk ka patur detyrime të cilat nuk janë paguar në kohë për këtë hua të marrë, më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015.

Banka Credins sh.a.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(shuma në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

23 Huamarrje (vazhdim)

Korporata Financiare Ndërkombëtare ("IFC")

Më 7 mars 2013 Grupi nënshkroi një marrëveshje kredie me Korporatën Financiare Ndërkombëtare ("IFC") në cilësinë e Entit Zbatues të Programit të Ndryshimeve Klimatike në Kanada ("CCCCP"). Sipas kësaj marrëveshje kredie, IFC ra dakord t'i japë hua Grupit një shumë totale deri në 10 milion Euro, për energjinë e rinovueshme dhe investime që lidhen me efikasitetin e energjisë. Grupi nuk ka vendosur kolateral për këtë marrëveshje kredie. Më 31 dhjetor 2016 e ka paguar plotësisht këtë marrëveshje (2015: EUR 2 milion ose 275,297 mijë Lekë). Në kuadër të kushteve të kësaj marrëveshje kredie, Grupi nuk ka lëshuar nën-kredi të reja gjatë vitit 2016 (2015: 0 nën-kredi).

Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim ("EBRD")

Në 28 gusht 2013, Grupi ka nënshkruar një marrëveshje huaje me Bankën Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim ("EBRD"), në përputhje me Kuadrin Financiar të Ballkanit Perëndimor dhe Kroacisë. Si subjekt i kësaj marrëveshjeje huaje, EBRD ka rënë dakort t'i japë hua Grupit një shumë prej 8 milion Euro, me qëllim përdorimin e saj për të nxitur huadhënien për njesitë ekonomike të vogla dhe të mesme, në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe Kroacisë. Grupi nuk ka vendosur kolateral për këtë marrëveshje kredie. Më 31 dhjetor 2016, Grupi ka paguar plotësisht këtë detyrim ndaj EBRD (2015: 4,6 milion Euro ose 628,618 mijë Lekë). Në përputhje me termat e kësaj marrëveshje huaje, Banka nuk ka lëshuar nën-kredi të reja gjatë vitit 2016 (2015: 0 nën-kredi).

Huamarrje të tjera

Më 24 dhjetor 2015, Mëma përthithi shoqërinë Credins Leasing dhe të gjitha të drejtat dhe detyrimet e saj u transferuan tek Mëma. Vlera e huasë që Credins Leasing kishte nga një individ ishte në vlerën prej 27,534 mijë Lekë (200,000 Euro) e rinovueshme çdo vit (shënimi 29.2). Më 31 dhjetor 2016 balanca e mbetur për huamarrje nga individët është 27,123 mijë Lekë (31 dhjetor 2015: 27,534 mijë Lekë).

24 Detyrime ndaj klientëve

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Individë	112,027,268	98,921,098
Ente Qeveritare	15,132,903	12,655,815
Korporata	15,029,101	10,928,567
Klientë të tjerë	1,616,000	1,014,217
Totali	143,805,272	123,519,697

Detyrimet ndaj klientëve sipas monedhës detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Depozita me afat		
Në monedhë vendase	51,273,461	52,552,980
Në monedhë të huaj	41,801,491	38,828,342
Llogari rrjedhëse		
Në monedhë vendase	17,166,698	13,410,203
Në monedhë të huaj	13,803,039	7,361,353
Llogari kursimi	-	-
Në monedhë vendase	5,446,505	2,754,478
Në monedhë të huaj	7,982,451	4,309,632
Llogari të tjera klientesh		
Në monedhë vendase	2,477,711	-
Në monedhë të huaj	3,853,916	4,302,709
Totali	143,805,272	123,519,697

Banka Credins sh.a.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(shuma në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

25 Borxhi i varur

Borxhi i varura detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Instrumente të varura	5,224,500	4,284,888
SIFEM-AG (ish SECO)	185,719	569,969
Gjendja më 31 dhjetor	5,410,219	4,854,857

Më 12 dhjetor 2007 Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve aprovoi marrjen e borxhit të varur prej 2 milion Euro nga State Secretariat for Economic Affairs (SECO) i cili operon nëpërmjet Swiss Investment Fund for Emerging Markets (SIFEM). Më pas, më 31 dhjetor 2008, Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve aprovoi marrjen e një borxhi tjetër të varur prej 2,120 mijë Euro nga SIFEM. Këto borxhe do të paguheshin me kështu të barabarta prej 666 mijë Euro dhe 707 mijë Euro. Më 10 qershor 2014 Grupi dhe SIFEM nënshkruan dy amendime të kontratave të përmendura më sipër, ku ripagimi i borxhit të varur u shty më 30 qershor 2016, 31 dhjetor 2016 dhe 30 qershor 2017, me date efektive 31 dhjetor 2015. Më 30 qershor 2016 dhe 31 dhjetor 2016, dy pagesat e para i janë bërë SIFEM-it sipas marrëveshjes së nënshkruar. Pagesa finale do paguhet më 30 qershor 2017.

Më 31 tetor 2011, asambleja e përgjithshme e aksionarëve aprovoi emetimin e instrumentave të varur në Lek, Euro dhe dollar amerikan. Instrumentet janë detajuar më poshtë sipas monedhës dhe date të emetimit dhe maturimit:

	Nr. i Instrumenteve	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Lekë	2,295	2,333,426	2,106,665
Euro	1,655	2,277,605	1,645,162
Usd	475	613,469	533,061
Totali	4,425	5,224,500	4,284,888

Transhe	Data e emetimit	Data e maturimit	Nr. i Instrumentave	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
1	30.12.2011	30.12.2017	758	861,536	858,584
2	23.03.2012	23.03.2018	264	279,769	280,182
3	01.11.2012	01.01.2018	129	134,687	134,867
4	02.02.2013	02.02.2019	150	209,652	212,830
5	31.05.2013	31.05.2019	160	188,206	189,765
6	13.12.2013	13.12.2019	310	357,268	359,932
7	03.06.2014	03.06.2020	368	424,176	423,384
8	02.09.2014	02.09.2020	598	699,057	701,725
9	27.01.2015	27.01.2021	927	1,117,321	1,123,619
10	05.01.2016	05.01.2022	373	422,401	-
11	25.08.2016	25.08.2023	388	530,427	-
Totali			4,425	5,224,500	4,284,888

26 Detyrime të tjera

Detyrime të tjera përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Furnitorë dhe shpenzime të përlogaritura	111,109	109,706
Pagesa në tranzit	-	272
-Llogari pezull për transaksione në monedhë të huaj dhe zërat jashtë bilancit	-	272
Totali	111,109	109,978

Banka Credins sh.a.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(shuma në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

27 Provigjonet

Provigjonet më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Provigjone gjyqësore	2,275	1,525
Totali	2,275	1,525

Në tabelën e mëposhtme paraqiten lëvizjet në provigjone gjatë 2016 dhe 2015:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2016	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2015
1 janar	1,525	43,275
Shtesa	750	-
Pagesa	-	(10,250)
Kthime	-	(31,500)
Balanca më 31 dhjetor	2,275	1,525

Gjatë 2016, ka pasur 750 mijë Lekë shtesa të krijuara për një çështje gjyqësore, ku Grupi është pala mbrojtëse me një ish-punonjës.

Gjatë 2015, shuma prej 10,250 mijë lekë lidhet me një pagesë bërë për autoritetet tatimore sipas vendimit të gjykatës për penalitete për tatimin në burim të provigjonuar që në 2005. Shuma e rimarrë prej 31,500 mijë Lekë lidhet me raste gjyqësor të provigjonuara, në të cilat Grupi është i paditur dhe për të cilat gjykata u shpreh ne favor të Grupit.

Prej të cilave, vlera prej 30,000 mijë Lekë lidhet me një rast gjyqësor për penalitete tatimore për TVSH të vendosur nga autoritetet fiskale që në 2008, për të cilën gjykata vendosi në favor të Grupit. Rrjedhimisht provigjoni i lidhur me këtë çështje është rimarrë. Autoritetet fiskale e kanë apeluar vendimin, dhe në datën e ndërtimit të këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara çështja është ende në apel. Vlera prej 1,500 mijë Lekë lidhet me një çështje tjetër ligjore ku Grupi është i paditur nga një ish-punonjës i tij. Gjykata apelit u shpreh ne favor të Grupit, si rrjedhojë provigjoni u rimorr.

28 Primi i kapitalit

Gjatë vitit 2016 Banka ka emetuar aksione të reja duke gjeneruar një prim prej 522,571 mijë Lekë prej emetimit të kapitalit të ri, ndërsa gjatë 2015 Grupi ka emetuar aksione të reja që kanë gjeneruar një vlerë prej 530,605 mijë Lekë, nga të cilat 218,671 mijë Lekë të gjeneruara nga emetimi i aksioneve të reja, dhe 311,934 mijë Lekë nga nxjerrja e aksioneve të reja bashkimi me përthithje me Credins Leasing (shënimi 29.2).

29 Kapitali aksionar

29.1 Kapitali aksionar i Banka Credins sh.a

Kapitali aksionar është i përbërë nga "Klasa A" i aksioneve dhe aksione të zakonshme, të dyja me një vlerë nominale 1 Usd për cdo aksion. Kapitali aksionar i nënshkruar i vendosur nga aksionerët e Grupit është në valutat Usd, Euro dhe Lekë dhe është i raportuar në pasqyrat financiare të konsoliduara me koston historike të kursit të këmbimit. Më 31 dhjetor 2016 kapitali i nënshkruar është në shumën 16,392 mijë Usd, 23,060 mijë Euro dhe 2,235,234 mijë Lekë.

Aksionarët e Grupit dhe aksionet përkatëse të mbajtura prej tyre janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2016 (%)	31 dhjetor 2015 (%)
Kapitali Aksionar		
Renis Tërshana	25.363%	28.220%
Aleksandër Pilo	17.415%	19.380%
B.F.S.E Holding BV	15.118%	16.820%
Drejtuesit e Përgjithshëm të Grupit	7.051%	7.630%
Të tjerë (aksionarë që zotërojnë më pak se 5% të aksioneve)	35.053%	24.760%
Totali	100.000%	100.000%

Kapitali i paguar i Grupit për 31 dhjetor 2016 është 7,307,701 mijë Lekë i kthyer me kursin historik (31 dhjetor 2015: 6,382,916 mijë Lekë) me vlerë nominale të 1 USD për aksion.

Banka Credins sh.a.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(shuma në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

29 Kapitali aksionar (vazhdim)

29.1 Kapitali aksionar i Banka Credins sh.a (vazhdim)

Më 29 tetor 2014 Asambleja vendosi për emetimin e kapitalit të ri në shumën 7.2 milion Euro. Më 31 dhjetor 2015 përafërsisht gjysma e kapitalit (3.8 milion Euro) është nënshkruar dhe i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB).

Më 2015 Grupi emetoi aksione të reja për të kompensuar përthithjen e shoqërisë Credins Leasing për një vlerë prej 612,590 mijë Lekë.

Më 25 shkurt 2016 Asambleja e aksionerëve vendosi emetimin e kapitalit të ri aksionar në vlerën 10 milion Euro. Më 31 dhjetor 2016, e gjithë shuma e kapitalit (10 milion Euro) është nënshkruar dhe regjistruar pranë QKB.

Aksionet e Grupit kanë vlerë nominale dhe janë të pandashme. Çdo aksion i jep zotëruesit të tij të drejtën e një vote. Grupi ka "aksione të zakonshme" dhe aksione të "klasa A", ku secili nga këto aksione ka një vlerë nominale prej 1 Usd për aksion. Aksionet e "klasa A" i japin zotëruesit të tij të drejta dhe privilegje të caktuara, kryesisht në lidhje me transferimin e aksioneve, shitjen e aksioneve, konvertimin e aksioneve të "klasa A" në aksione të zakonshme, dhe të drejtën për të propozuar emërimin dhe shkarkimin e 2 anëtarëve të Këshillit Drejtues. Mbajtësit e aksioneve të "klasa A" të cilët veprojnë së bashku përmes përfaqësuesit të emëruar do të kenë të drejtat dhe privilegjet e aksioneve të "klasa A" përsa i takon "para-aprovimit" të disa ndryshimeve dhe vendimeve dhe disa "të drejtave të informimit".

Të gjitha aksionet e mbajtura nga B.F.S.E Holding BV ose S.E.C.O. do të jenë gjithnjë aksione "klasa A". Të gjithë aksionarët e tjerë të Grupit mbajnë aksione të zakonshme.

Një rakordim i kapitalit të paguar në fillim dhe në fund të periudhës është si më poshtë:

	Aksione të zakonshme		Aksione klasa A	
	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Më 1 janar	48,655,289	40,847,775	11,581,347	11,520,518
Rritja në numrin e aksioneve	7,282,517	7,807,514	101,998	60,829
Me 31 dhjetor	55,937,806	48,655,289	11,683,345	11,581,347

Më 25 qershor 2015 Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve vendosi shpërndarjen e fitimit të vitit 2015, prej të cilave 65,157 mijë Lekë u përdorën për rritjen e kapitalit.

29.2 Përthithja me Credins Leasing sh.a.

Më 28 shtator 2015 Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve të Grupit aprovoi projektin për përthithjen e shoqërisë Credins Leasing sh.a. Si rezultat i përthithjes u emetuan aksione të reja për të kompensuar aksionarët e shoqërisë së përthithur. U emetuan 4,878,471 aksione të reja me një vlerë prej 612,590 mijë Lekë. Bashkimi me përthithje përfundoi më 24 dhjetor 2015, ku të gjitha aktivet dhe detyrimet e shoqërisë së përthithur ju transferuan Grupit.

30 Rezerva e përgjithshme

Grupi ka krijuar dy rezerva duke përvetësuar fitimin e mbartur, të cilat paraqesin rezerva të përgjithshme, për aktivet me rrezik siç kërkohet nga Banka Qendrore dhe rezerva ligjore, siç kërkohet nga rregulloret e Grupit. Rezerva e përgjithshme është llogaritur si 1.25% e totalit të aktiveve të ponderuara me rrezikun ndërsa rezerva ligjore është llogaritur si 5% e fitimit vjetor. Këto rezerva nuk janë të vlefshme për tu shpërndarë.

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Rezerva e përgjithshme	1,256,860	1,256,860
Rezerva ligjore	189,165	189,165
Totali	1,446,025	1,446,025

Banka Credins sh.a.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(shuma në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

31 Analizë maturimi për aktivet dhe detyrimet

31 dhjetor 2016

Aktivët

Mjete monetare dhe ekuivalente me to
Shuma të kushtëzuara me Bankën Qëndrore
Hua dhe paradhënie bankave dhe institucioneve të tjera financiare
Letra me vlerë të vlefshme për shitje
Qira financiare
Hua dhe paradhënie për klientët
Parapagim tatim fitimi
Aktive të tjera
Prona të riposeduara
Aktive afatgjata materiale
Aktive afatgjata jo-materiale
Emri i mirë
Aktive tatimore të shtyra

Totali

Detyrime

Detyrime ndaj bankave dhe institucioneve të tjera financiare
Detyrime ndaj klientëve
Huamarrje
Detyrime të tjera
Provigjone
Borxhi i varur

Totali

Neto

	< 12 muaj	> 12 muaj	Totali
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	29,040,607	-	29,040,607
Shuma të kushtëzuara me Bankën Qëndrore	11,520,723	-	11,520,723
Hua dhe paradhënie bankave dhe institucioneve të tjera financiare	1,478,805	56,341	1,535,146
Letra me vlerë të vlefshme për shitje	8,697,259	12,611,216	21,308,475
Qira financiare	108,026	837,749	945,775
Hua dhe paradhënie për klientët	35,959,632	57,513,945	93,473,577
Parapagim tatim fitimi	64,441	-	64,441
Aktive të tjera	983,013	296,074	1,279,087
Prona të riposeduara	-	3,608,181	3,608,181
Aktive afatgjata materiale	-	2,465,056	2,465,056
Aktive afatgjata jo-materiale	-	122,994	122,994
Emri i mirë	-	43,371	43,371
Aktive tatimore të shtyra	-	75,673	75,673
Totali	87,852,506	77,630,600	165,483,106
Detyrime			
Detyrime ndaj bankave dhe institucioneve të tjera financiare	2,392,140	100,525	2,492,665
Detyrime ndaj klientëve	122,330,724	21,474,548	143,805,272
Huamarrje	35,169	164,692	199,861
Detyrime të tjera	111,109	-	111,109
Provigjone	-	2,275	2,275
Borxhi i varur	1,047,052	4,363,167	5,410,219
Totali	125,916,194	26,105,207	152,021,401
Neto	(38,063,688)	51,525,393	13,461,705

31 dhjetor 2015

Aktivët

Aktive monetare dhe ekuivalente me to
Shuma të kushtëzuara me Bankën Qëndrore
Hua dhe paradhënie bankave dhe institucioneve të tjera financiare
Letra me vlerë të vlefshme për shitje
Qira financiare
Hua dhe paradhënie për klientët
Letra me vlerë të mbajtshme deri në maturim
Parapagim tatim fitimi
Aktive të tjera
Prona të riposeduara
Aktive afatgjata materiale
Aktive afatgjata jo-materiale
Emri i mirë
Aktive tatimore të shtyra

Totali

Detyrime

Detyrime ndaj bankave dhe institucioneve të tjera financiare
Detyrime ndaj klientëve
Huamarrje
Detyrime të tjera
Provigjone
Borxhi i varur

Totali

Neto

	< 12 muaj	> 12 muaj	Totali
Aktive monetare dhe ekuivalente me to	18,889,094	-	18,889,094
Shuma të kushtëzuara me Bankën Qëndrore	9,868,652	1,191,414	11,060,066
Hua dhe paradhënie bankave dhe institucioneve të tjera financiare	1,724,423	55,397	1,779,820
Letra me vlerë të vlefshme për shitje	13,695,291	5,382,067	19,077,358
Qira financiare	345,747	619,494	965,241
Hua dhe paradhënie për klientët	36,298,898	48,951,725	85,250,623
Letra me vlerë të mbajtshme deri në maturim	-	17,289	17,289
Parapagim tatim fitimi	134,533	-	134,533
Aktive të tjera	1,181,653	17,913	1,199,566
Prona të riposeduara	-	3,699,881	3,699,881
Aktive afatgjata materiale	-	929,412	929,412
Aktive afatgjata jo-materiale	-	138,593	138,593
Emri i mirë	-	43,371	43,371
Aktive tatimore të shtyra	-	53,026	53,026
Totali	82,138,291	61,099,582	143,237,873
Detyrime			
Detyrime ndaj bankave dhe institucioneve të tjera financiare	1,719,504	25,309	1,744,813
Detyrime ndaj klientëve	108,619,981	14,899,716	123,519,697
Huamarrje	940,257	161,785	1,102,042
Detyrime të tjera	109,978	-	109,978
Provigjone	-	1,525	1,525
Borxhi i varur	569,969	4,284,888	4,854,857
Totali	111,959,689	19,373,223	131,332,912
Neto	(29,821,398)	41,726,359	11,904,961

Banka Credins sh.a.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(shuma në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

31 Analizë maturimi për aktivet dhe detyrimet (vazhdim)

Data e pritshme e maturimit nuk ndryshon nga data e kontratës, me përjashtim të:

- Depozitat e individëve, të cilat janë të përfshira në detyrimet ndaj klientëve, janë të ripagueshme sipas kërkesës ose me anë të një njoftimi në varësi të kontratës. Në praktikë, këto instrumenta formojnë një bazë të qëndrueshme për aktivitetet e Grupit dhe nevojat për likuiditet sepse përfshijnë një bazë të gjerë klientësh dhe janë të rinovueshme në përfundim të kontratës, dhe
- Overdraftet, të cilat janë të përfshira në “Hua dhe paradhënie për klientët”, të cilat janë zakonisht afatshkurtër me maturitet kontraktual deri në 12 muaj, por në praktikë rinovohen dhe maturiteti i tyre zgjatet edhe me një periudhë tjetër, zakonisht prej deri në 12 muaj.

32 Angazhime dhe detyrimet e kushtëzuara

Në mënyrë që të përmbushë nevojat financiare të klientëve të saj, Grupi hyn në angazhime të parevokueshme dhe detyrime të kushtëzuara. Ato konsistojnë nga garanci financiare, letra krediti dhe angazhime të tjera huadhënieje të padisbursuara. Edhe pse këto detyrime mund të mos njihen në pasqyrën e pozicionit financiar, ato mbartin rrezik krediti dhe rrjedhimisht edhe një pjesë të rrezikut të përgjithshëm të Grupit. Letër-kreditë dhe garancitë (duke përfshirë letër-kreditë e pambyllura) e angazhojnë Grupin që të kryejë pagesa për llogari të klientëve të saj nëse ndodh një ngjarje e caktuar, përgjithësisht e lidhur me importin dhe eksportin e mallrave. Garancitë dhe letër-kreditë mbartin një rrezik të ngjashëm krediti me kreditë. Angazhimet dhe detyrimet e kushtëzuara përfshijnë garancitë e dhëna klientëve dhe të marra nga institucionet e kreditit. Balancat janë të përbëra si më poshtë:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Garanci në favor të klientëve	4,551,182	3,830,769
Angazhime në favor të klientëve	5,477,370	3,635,960
Garanci të vendosura nga klientët kreditues	7,591,105	3,607,016
Garanci të marra nga klientë kreditues	266,209,001	308,062,551
Angazhime për letra me vlerë	313,361	548,261

Garanci dhe letër-kreditë

Garancitë e marra nga klientët përfshijnë kolaterale në formën e mjeteve monetare ose depozita, kolaterale hipotekore, inventar, dhe aktive të tjera të barrësura nga kredimarrësi në favor të Grupit. Grupi ka lëshuar garanci dhe letra-krediti për klientët e tij. Këto instrumenta mbartin një rrezik të ngjashëm krediti me kreditë. Bazuar në vlerësimin e menaxhimit, nuk ka humbje që lidhen me këto granaci dhe letra-krediti më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015.

Angazhime për qiratë operationale – Grupi si qiramarrës

Grupi ka marrë me qera zyra në Tiranë, Durrës, Fier, Vlorë, Lezhë, Elbasan, Shkodër, Korçë, Shijak, Kavaje, Kukës, Berat, Ballsh, Mat, Peshkopi dhe Vorë në përgjithësi me afat nën 10 vjet. Këto angazhime të ardhshme për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 detajohen si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2016	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2015
Jo më vonë se 1 vit	468,984	540,707
Më vonë se 1 vit dhe jo më vonë se 5 vite	1,506,175	1,755,221
Më vonë se 5 vite	3,405,450	4,335,030
Totali	5,380,609	6,630,958

Angazhime për qiratë – Grupi si qiradhënës

Si pjesë të portofolit të “Huave dhe paradhënieve për klientët” Grupi ka lëshuar qira financiare ndaj klientëve të vetë, në vlerën prej 945,775 mijë Lekë (31 dhjetor 2015: 965,241 mijë Lekë). Këto qera financiare kanë një jetë mesatare që varion ndaj 1 deri në 5 vjet, pa patur klauzolë në kontratë për rinovimin e tyre. Pagesat minimale të qerave të pritshme për tu marrë (principal dhe interes) deri më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 janë detajuar si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2016	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2015
Jo më vonë se 1 vit	487,900	468,804
Më vonë se 1 vit dhe jo më vonë se 5 vite	679,741	722,097
Më vonë se 5 vite	4,894	-
Totali	1,172,535	1,190,901

Banka Credins sh.a.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(shuma në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

32 Angazhime dhe detyrimet e kushtëzuar (vazhdim)

Pretendime dhe çështje gjyqësore

Grupi është subjekt i pretendimeve dhe proçeseve gjyqësore të tjera të cilat rrjedhin nga aktiviteti normal i biznesit. Drejtimi i Grupit është i mendimit se kostoja përfundimtare e zgjidhjes së këtyre çështjeve nuk do të ketë një efekt material në pozicionin financiar të Grupit, rezultatet e operacioneve apo në flukset monetare.

Çështje gjyqësore

Çështjet gjyqësore janë një ndodhi e zakonshme në industrinë bankare për shkak të natyrës së aktivitetit që kryen Grupi.

Grupi ka kontrole formale dhe politika për menaxhimin e këtyre çështjeve. Pasi merret këshilla profesionale dhe shuma e humbjes është përcaktuar, Grupi kryen korrigjimet e nevojshme për të marrë në konsideratë efektet e pafavorshme që këto çështje mund të kenë në pozicionin e saj financiar. Në fund të vitit, Grupi kishte disa çështje të pazgjidhura gjyqësore pa efekte të pafavorshme, rrjedhimisht, asnjë provigjon tjetër përveç atij të përfshirë në shënimin 27, nuk është paraqitur në pasqyrat në këto pasqyra financiare të konsoliduara.

33 Shënime për palët e lidhura

Në tabelat e mëposhtme, Grupi prezanton marrëdhëniet që ekzistojnë midis Grupit dhe palëve të lidhura me të, natyrën e transaksioneve, vlerat përkatëse, si dhe shpenzimet dhe të ardhurat deri më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015.

Drejtuesit e Grupit janë ata persona të cilët kanë autoritetin dhe përgjegjësinë për planifikimin, drejtimin dhe kontrollin e aktiviteteve të Grupit, në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose jo, përfshirë këtu edhe drejtues të lartë të Grupit, ekzekutivë ose jo. Palët e tjera të lidhura të Grupit, që mund të jenë individë të lidhur me Grupin ose pjesëtarë të ngushtë të familjes së këtyre individëve, që kanë kontroll të plotë ose të përbashkët nga individët e lidhur me Grupin apo pjesëtarë të ngushtë të familjes së tyre, apo që kanë influencë të konsiderueshme mbi një entitet, prezantohen si palë të tjera të lidhura të Grupit.

Transaksionet me palët e lidhura

Transaksionet	31 dhjetor 2016		31 dhjetor 2015	
	Drejtuesit e Grupit	Palë të tjera të lidhura	Drejtuesit e Grupit	Palë të tjera të lidhura
Shpenzime qiraje	-	33,583	-	34,745
Të ardhura	1,021	39,168	425	37,738
Shpenzime	58,204	23,630	53,770	34,200

Lloji i transaksionit	31 dhjetor 2016		31 dhjetor 2015	
	Drejtuesit e Grupit	Palë të tjera të lidhura	Drejtuesit e Grupit	Palë të tjera të lidhura
Linjë kredie	-	1,268,853	-	1,258,380
Overdrafte	56	32,344	-	137,593
Hua me afat	14,484	527,808	17,639	128,495
Qera Financiare	9,408	84,616	-	-
Garanci	-	12,361	-	20,288
Llogari rrjedhëse	(12,970)	(292,283)	(6,839)	(30,923)
Depozita me afat	(47,097)	(50,108)	(3,888)	(127,462)
Kolateral i vendosur në favor të Grupit	(36,425)	(5,700,492)	(45,671)	(3,741,041)

Banka Credins sh.a.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(shuma në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

33 Shënime për palët e lidhura (vazhdim)

Transaksionet me palët e lidhura (vazhdim)

	Norma e interesit (në %)	
	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Linjë kredie	5%-9.29%	5%-11%
Overdrafte	1.65%-20%	2.31%-20%
Hua me afat	0.5%-9.29%	2.13%-8.61%
Qira Financiare	5.8%	6.5%-10.5%
Llogari rrjedhëse	0%-0.022%	0%-0.3%
Depozita me afat	0%-4.5%	0.28%-4.5%

Për më tepër, pagat dhe shpërblimet për Drejtimin e Grupit ka qenë si më poshtë, pa vlera të tjera për tu deklaruar:

	Pagat	Bonuse
Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2016		
Shpërblimi i drejtimit të Grupit	57,396	-
Shpërblimi i Bordit të Drejtorëve	2,988	-
Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2015		
Shpërblimi i drejtimit të Grupit	55,736	-
Shpërblimi i Bordit të Drejtorëve	2,370	-

34 Ngjarjet pas datës së bilancit

Drejtimi i Grupit nuk është në dijeni të ndonjë ngjarjeje tjetër pas datës së raportimit, që do të kërkonte ndryshim ose dhënie informacionesh shtesë në këto pasqyra financiare të konsoliduara.

35 Administrimi i rrezikut financiar

35.1 Një vështrim i përgjithshëm

Përdorimi i instrumentave financiarë e ekspozon Grupin ndaj rreziqeve të mëposhtme:

- rreziku i kredisë
- rreziku i likuiditetit
- rreziku i tregut
- rreziku operacional.

Ky shënim paraqet informacion rreth ekspozimit të Grupit ndaj çdo rreziku të përmendur më lart, objektivat, politikat dhe proceset për vlerësimin dhe menaxhimin e rrezikut, dhe menaxhimin e kapitalit të Grupit.

Struktura e administrimit të rrezikut

Bordi Drejtues ka përgjegjësi për ndërtimin dhe vëzhgimin e strukturës së administrimit të rrezikut. Bordi ka themeluar Komitetin e Aktiveve dhe Detyrimeve (ALCO) dhe Komitetin e Kredisë së Grupit të cilët janë përgjegjës për zhvillimin dhe monitorimin e politikave të administrimit të rrezikut ne fushat e tyre specifike për të paravendosur limitet e ekspozimit.

Politikat e administrimit të rrezikut janë krijuar për të identifikuar dhe analizuar rreziqet e hasura nga Grupi, për të vendosur kufizime dhe kontrole, dhe për të monitoruar zbatimin e këtyre kontroleve. Grupi, nëpërmjet trajnimeve dhe standardeve dhe procedurave drejtuese, synon të zhvillojë një mjedis kontrolli të disiplinuar dhe konstruktiv, në të cilin çdo punonjës do kuptojë rolin dhe detyrimet përkatëse.

Komiteti i Kontrollit të Grupit është përgjegjës për monitorimin e përputhshmërisë me politikat dhe procedurat e administrimit të rrezikut dhe për të vlerësuar mjaftueshmërinë e strukturës së administrimit të rrezikut në lidhje me rreziqet e hasura nga Grupi. Komiteti i kontrollit mbështetet nga kontrolli i brendshëm i Grupit për të kryer funksionet e veta. Kontrolli i brendshëm vëzhgon në mënyrë të rregullt dhe 'ad-hoc' politikat dhe procedurat e administrimit të rrezikut, dhe raporton rezultatet e vëzhgimeve tek Komiteti i Kontrollit.

Banka Credins sh.a.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(shuma në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

35 Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

35.2 Rreziku i kredisë

Rreziku i kredisë është rreziku i humbjes financiare i Grupit nëse klienti apo pala tjetër në një instrument financiar nuk arrin të përmbushë detyrimet kontraktuale që rrjedhin nga instrumenti. Ky rrezik vjen kryesisht nga kreditë dhe paradhëniet për klientët, bankat dhe investimi në letra me vlerë. Për qëllime të administrimit të rrezikut të kredisë, Grupi konsideron të gjitha elementët e ekspozimit ndaj rrezikut të kredisë (si rreziku që rrjedh nga vetë klienti, pozicioni gjeografik dhe sektori). Rreziku që rrjedh nga tregtimi i letrave me vlerë mbahet në nivele të ulëta sepse përbëhet vetëm nga letra me vlerë shtetërore, Bono thesari dhe obligacione qeveritare që janë konsideruar si instrumenta pa rrezik.

Bordi i Drejtuesve ka deleguar përgjegjësinë për administrimin e rrezikut tek Komiteti i Kredisë së Grupit për ekspozimet e rrezikut më të mëdha sesa 5% i kapitalit rregullator. Bordi i Drejtorëve në bashkëpunim me Komitetin e Kredisë janë përgjegjës për mbikëqyrjen e rrezikut të kreditit të Grupit duke përfshirë: formulimin e politikave të kredisë duke u konsultuar me njësitë e biznesit, duke mbuluar kërkesat për kolateral, vlerësimin e kredive, vlerësimin dhe raportimin e rrezikut, përputhshmërinë me kërkesat rregulatore dhe ligjore, hartimin e strukturës autorizuese për aprovimin dhe rinovimin e kredive.

Limitet e aprovimit i janë shpërndarë respektivisht Komiteteve të Kredisë nëpër Degë dhe Drejtorëve të Departamentit të Korporatave, SME-ve dhe të Kredisë Individuale. Për shumën më të mëdha kërkohet aprovimi i Komitetit të Kredisë ose i Bordit të Drejtorëve, si të gjykohej më e përshtatshme. Komiteti i Kredisë vlerëson të gjitha ekspozimet ndaj rrezikut të kredisë të cilat e kalojnë kufirin e vendosur, para aprovimit përfundimtar të disbursimit. Rinovimet dhe rishikimet e faciliteteve janë subjekt i të njëjtit proces rishikimi.

Zhvillimi dhe përdormi i sistemit të vlerësimit të rrezikut të Grupit në mënyrë që të kategorizojë ekspozimin në bazë të shkallës së rrezikut të humbjeve financiare, dhe të fokusojë drejtimin në rreziqet aktuale të Grupit. Sistemi i kategorizimit të rrezikut përdoret për të përcaktuar se kur duhet të krijohen fonde për zhvlerësime të mundshme kundrejt ekspozimeve specifike ndaj rrezikut të kredisë. Sistemi aktual i kategorizimit të rrezikut konsiston prej pesë kategorish në përputhje me rregulloren e "Administrimit të Rrezikut të Kredisë" të Bankës së Shqipërisë të cilat reflektojnë shkallën e rrezikut të mospagimit dhe vlefshmërinë e kolateraleve, ose lehtësime të tjera të rrezikut të kredisë. Përgjegjësia për të caktuar nivelet e rrezikut i takon Komitetit të Kredisë dhe janë subjekt i monitorimit mujor. Monitorimi i zbatimit të kufijve të aprovuar të ekspozimit nga njësitë e biznesit, duke përfshirë dhe ato për industrinë e zgjedhura, rrezikut të shtetit dhe llojeve të produkteve. Për Komitetin e Kredive të Grupit përgatiten raporte periodike për cilësinë e portofolit të kredive dhe ndërmerren veprimeve korigjuese.

Dhënia e këshillave, udhëheqje dhe aftësi të specializuara për njësitë e biznesit për të promovuar praktikën më të mirë për të gjithë Grupin në menaxhimin e rrezikut të kredisë. Çdo njësi biznesi duhet të zbatojë politikat dhe procedurat e Grupit për administrimin e rrezikut të kredisë autorizuar nga Komiteti i Kredisë. Çdo njësi biznesi/degë ka një shef për rrezikun e kredisë i cili raporton për të gjitha çështjet lidhur me rrezikun e kredisë tek administrimi lokal i Grupit dhe tek Komiteti i Kredisë të Grupit. Çdo njësi biznesi/degë është përgjegjëse për cilësinë dhe performancën e portofolit të saj të kredive duke përfshirë edhe ato me aprovimin nga qendra. Kontrolli të rregullta të njësive të biznesit dhe të proceseve të kreditimit të Grupit ndërmerren nga Kontrolli i Brendshëm.

Banka Credins sh.a.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(shuma në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

35 Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

35.2 Rreziku i kredisë (vazhdim)

Bazuar në politikat e brendshme të vlerësimit, vlerësimi i portofolit më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 është si më poshtë:

Vlerësimi i kredisë	% mbi		% mbi	
	31 dhjetor 2016	Totalin Bruto	31 dhjetor 2015	Totalin Bruto
A+	38,330	0.04%	17,955	0.02%
A	3,636,098	3.33%	1,315,353	1.32%
A-	10,782,776	9.87%	8,372,744	8.49%
B+	11,136,304	10.17%	8,202,772	8.32%
B	39,841,274	36.47%	48,898,023	49.58%
B-	4,241,282	3.88%	4,990,092	5.06%
C+	-	0.00%	106,917	0.11%
C	153,110	0.14%	100,425	0.10%
C-	85,167	0.08%	92,485	0.09%
D+	2,534,135	2.32%	1,349,245	1.37%
D	7,914,076	7.24%	4,505,212	4.57%
E+	1,226,004	1.12%	1,240,228	1.26%
E	4,090,577	3.74%	2,376,003	2.41%
E-	2,818,980	2.58%	2,911,920	2.95%
Kredi me vlerësim	88,498,113	80.98%	84,479,374	85.65%
Kredi pa vlerësim	7,863,756	7.22%	3,198,963	3.25%
Kredi me pikezim	11,877,116	10.89%	9,905,873	10.04%
Totali Bruto i portofolit të kredive	108,238,985	99.09%	97,584,210	98.94%
Qira financiare pa vlerësim	1,016,519	0.91%	1,045,407	1.06%
Totali Bruto i portofolit të kredive	109,255,504	100.00%	98,629,617	100.00%

Tabela më poshtë paraqet cilësinë kreditore sipas klasës së huave dhe paradhëniet për klientët dhe qira financiare, duke u bazuar në sistemin e brendshëm të Grupit për renditjen kreditore. Vlerat e paraqitura më poshtë janë bruto, pa përfshirë vlerat përkatëse të zhvlerësimit.

Renditja e kreditit sipas Grupit	31 dhjetor 2016		31 dhjetor 2015	
	% e rasteve të dështimit	Total	% e rasteve të dështimit	Total
Gradë e lartë		17,906,274		12,487,531
Renditje rreziku klasa 1	4.20%	1,058,705	4.81%	750,142
Renditje rreziku klasa 2	5.72%	4,348,375	7.00%	2,031,384
Renditje rreziku klasa 3	12.98%	12,499,194	3.04%	9,706,005
Gradë standarte		56,734,957		61,772,332
Renditje rreziku klasa 4	10.45%	14,923,427	10.18%	11,209,523
Renditje rreziku klasa 5	8.19%	41,811,530	6.34%	50,562,809
Gradë nën-standarte		25,733,998		20,125,384
Renditje rreziku klasa 6 dhe më poshtë	25.65%	25,733,998	26.54%	20,125,384
Pa renditje	18.90%	7,863,756	29.38%	3,198,963
Qira financiare pa renditje	5.31%	1,016,519	5.77%	1,045,407
Totali		109,255,504		98,629,617

Klasifikimi i renditjes së kreditit sipas Grupit është në pajtim me procedurat e Grupit në lidhje me segmentet e ndryshme të klientit. Në klasifikimin sipas gradës së lartë përfshihet vlerësimi për klientët tregtarë (A+,A,A-) dhe vlerësimet për klientët individualë dhe mikro (klasat 1,2). Në klasifikimin sipas gradës standarte përfshihen vlerësimet për klientët tregtarë (B+,B) dhe vlerësimet për klientët individualë dhe mikro (klasat 3,4,5). Dhe në klasifikimin sipas gradës nën-standarte janë përfshirë vlerësimet për klientët tregtarë (B- dhe më pak) dhe vlerësimet për klientët individualë dhe mikro (klasat 6,7).

Banka Credins sh.a.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(shuma në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

35 Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

35.2 Rreziku i kredisë (vazhdim)

Ekspozimi ndaj rrezikut të kredisë

	Ekspozimi maksimal bruto	
	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Mjete monetare dhe ekuivalent me to (pa përfshirë aktive monetare në arkë)	23,857,183	15,869,538
Shuma të kushtëzuara me Bankën Qëndrore	11,520,723	11,060,066
Hua dhe paradhënie bankave dhe institucioneve të tjera financiare	1,535,146	1,779,820
Letra me vlerë të vlefshme për shitje	21,308,475	19,077,358
Qira financiare	945,775	965,241
Hua dhe paradhënie për klientët	93,473,577	85,250,623
Letra me vlerë të mbajtura deri në maturim	-	17,289
Aktive të tjera (Debitorë)	796,291	706,259
Totali	153,437,170	134,726,194
Angazhime kreditimi të padisbursuara	3,390,049	3,160,285
Letër-kredi	2,087,321	475,675
